



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E DREJTËSISË

**STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E
DREJTËSISË RAPORTI I MONITORIMIT
JANAR - DHJETOR 2023**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
I. INFORMACION PËRMBLEDHËS.....	13
1.1. Hyrje.....	13
1.2. Përmbledhje e arritjeve dhe sfidave kryesore	14
1.3. Metodologjia	17
II. VLERËSIMI I ARRITJES SË QËLLIMEVE TË POLITIKËS KUNDREJT MASAVE DHE TREGUESVE.....	22
2.1. Qëllimi i Parë i Politikës.....	22
<i>Objektivi Specifik 1.1.</i>	23
<i>Objektivi Specifik 1.2.</i>	25
<i>Objektivi Specifik 1.3.</i>	30
2.2. Qëllimi i Dytë i Politikës	34
<i>Objektivi Specifik 2.1.</i>	36
<i>Objektivi Specifik 2.2.</i>	40
<i>Objektivi Specifik 2.3.</i>	42
<i>Objektivi Specifik 2.4.</i>	46
<i>Objektivi Specifik 2.5.</i>	50
2.3. Qëllimi i Tretë i Politikës	34
<i>Objektivi Specifik 3.1.</i>	58
<i>Objektivi Specifik 3.2.</i>	61
<i>Objektivi Specifik 3.4.</i>	66
<i>Objektivi Specifik 3.5.</i>	72
2.4. Qëllimi i Katërt i Politikës	78
<i>Objektivi Specifik 4.1.</i>	79
<i>Objektivi Specifik 4.2.</i>	84
<i>Objektivi Specifik 4.3.</i>	87
<i>Objektivi Specifik 4.4.</i>	89
III. RISKU DHE HAPAT NË VIJIM	92
Pasqyrë e përgjithshme	92
Vlerësimi i riskut	92
Hapat vijues.....	95

LISTA E AKRONIMEVE

AT	<i>Asistencë Teknike</i>
BE	<i>Bashkimi Evropian</i>
BKH	<i>Byroja Kombëtare e Hetimit</i>
CAMS	<i>Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve të Shërbimit të Prokurorisë Shqiptare</i>
CCTP	<i>Profesionist i Çertifikuar për Traumata Klinike</i>
DNJF	<i>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas</i>
DPB	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</i>
DPKHL	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit</i>
DPSHP	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës</i>
DHASH	<i>Dhoma Kombëtare e Avokatisë e Shqipërisë</i>
DHKNt	<i>Dhoma Kombëtare e Noterëve</i>
DHKN	<i>Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësuesve</i>
DHKPGJP	<i>Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë</i>
GP	<i>Grup Pune</i>
GJEDNJ	<i>Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut</i>
GJK	<i>Gjykata Kushtetuese</i>
GJL	<i>Gjykata e Lartë</i>
IEVP	<i>Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale</i>
ILD	<i>Inspektori i Lartë i Drejtësisë</i>
IPA	<i>Instrumenti i Asistencës Para-Anëtarësimit</i>
IPSI	<i>Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar</i>
IT	<i>Teknologjia e Informacionit</i>
JFA	<i>Projekti "Justice for All"</i>
KE	<i>Këshilli i Evropës</i>
KEDNJ	<i>Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut</i>
KLJG	<i>Këshilli i Lartë Gjyqësor</i>
KLP	<i>Këshilli i Lartë i Prokurorisë</i>

KM	<i>Këshilli i Ministriave</i>
KPA	<i>Kolegji i Posaçëm i Apelit</i>
KPK	<i>Komisioni i Pavarur i Kualifikimit</i>
MD	<i>Ministria e Drejtësisë</i>
MFE	<i>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</i>
MShMS	<i>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>
OJF	<i>Organizata Joqeveritare</i>
OS	<i>Objektiv Specifik</i>
OSFA	<i>Fondacioni “Shoqëria e hapur për Shqipërinë”</i>
OZHQ	<i>Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm</i>
PKIE	<i>Plani Kombëtar për Integrimin Evropian</i>
PP	<i>Prokuroria e Përgjithshme</i>
PZ	<i>Periudha e Zbatimit</i>
PSDHS	<i>Plani Strategjik i të Dhënave Sistemike</i>
QP	<i>Qëllim Politik</i>
QTI	<i>Qendra e Teknologjisë dhe Informacionit</i>
SASPAC	<i>Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës</i>
SKZHI	<i>Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim</i>
SND	<i>Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë</i>
SPAK	<i>Struktura e Posaçme Antikorrupsion</i>
SHM	<i>Shkolla e Magjistraturës</i>
TF	<i>Task Forca</i>
TP	<i>Tabela e përputhshmërisë</i>
DPPP	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave</i>

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021–2025 (SND 2021-2025) dhe dokumentet e saj strategjike si Plani i Veprimit dhe Pasaporta e Treguesve u miratuan në vitin 2021, me VKM nr. 823, datë 24.12.2021 dhe zbatimi i saj nisi menjëherë, si një përgjigje e ushtrimit të përgjegjësiwe institucionale për jetësimin e Reformës në Drejtësi.

Raporti Vjetor i Monitorimit për vitin 2023, mbi zbatimin e SND 2021-2025, është raport i vjetor i tretë i monitorimit të zbatimit të SND 2021-2025. Ky raport është hartuar në një kohë që përkon me realizimin e gjysmës së afatit kohor 5 vjeçar, të zbatueshmërisë së SND 2021-2025, si dhe përkon me kohën në të cilën është kërkuar kryerja e një vlerësimi të ndërmjetëm të SND 2021-2025.

Raporti i Vlerësimi të Ndërmjetëm, i cili u hartua disa muaj përpara hartimit të Raportit Vjetor të Monitorimit për vitin 2023, përmban disa gjetje dhe rekomandime lidhur me *status-quo-në* e zbatimit të SND 2021-2025, cilësinë e administrimit dhe nivelin e zbatueshmërisë së masave dhe treguesve.

Në këtë raport analizohet ecuria e zbatimit të SND 2021-2025, për vitin 2023. Raporti përmbledh të dhëna dhe analiza nga 18 institucione në sektorin e drejtësisë. Të gjitha institucionet e pavarura të drejtësisë dhe disa institucione nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë kanë kontribuar në zbatimin e SND.

Tashmë, në vitin e tretë të zbatimit të saj, SND 2021-2025 ka shënuar arritje të rëndësishme dhe inkurajuese në drejtim të konsolidimit të pavarësisë së institucioneve të drejtësisë, efikasitetit, rritjes së transparencës, forcimit të besimit të publikut, si dhe përmirësimit të mëtejshëm të infrastrukturës, së të gjithë hallkave të sistemit të drejtësisë, nëpërmjet zbatimit të masave konkrete dhe arritjes së objektivave të parashikuara strategjikë. Këto arritje konfirmohen, gjithashtu, nga gjetjet e Progres Raportit të Komisionit Evropian, tetor 2023, ku theksohet se Shqipëria ka bërë një progres të mirë me zbatimin e Reformës në Drejtësi.

Nën dritën e rekomandimeve, në kuadër të procesit të negociatave të anëtarësimit ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, ky raport ka një rëndësi të vecantë për të reflektuar sfidat e agjendës 2030 dhe për të vendosur piketat e procesit të hartimit të Strategjisë së re Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030.


Gjatë pesë viteve të zbatimit të saj, SND 2021-2025 parashikon realizimin e 17 Objektivave Specifike dhe 184 masave, të ndara në katër objektiva politikë. Arritjet dhe sfidat kryesore në sektorin e drejtësisë maten përmes 32 treguesve, të përfshirë në Pasaportën e Treguesve. Në këtë raport janë marë në analizë:

- 16 OS (nga totali 17 OS), pasi OS që lidhet me Drejtësinë për të Mitur, gjen zbatim në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026
- 163 masa të zbatueshme në vitin 2023

Gjetjet dhe rekomandimet kryesore të këtij Raporti, paraqiten si më poshtë:

Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Parë Politik për “Funksionimin e plotë dhe profesional të institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet evropiane, duke garantuar pavarësinë, eficientën dhe llogaridhënien”, konstatohet se:

Vijueshmëria e procesit të verifikimit kalimtar të subjekteve të vlerësimit nga organet ekzistuese të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve po ecën me ritme të mira, si nga ana e KPK-së dhe KPA-së. Referuar treguesve për vitin 2023, ka gjasa që ky proces të finalizohet brenda afatit ligjor nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ndërkohë që, sa i takon Kolegjit të Posaçëm të



Apelimit, duke marrë në konsideratë numrin e subjekteve që janë për gjykim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, numrin potencial të ankimeve të prishme për raportet të cilat janë ende në vlerësim në KPK, si dhe numrin mesatar të raporteve përfundimtare të vlerësuara në një muaj nga ana e KPA-së për vitin 2023, ekziston një risk potencial lidhur me përfundimin e procesit brenda afatit ligjor (qershori i vitit 2026) nga ana e KPA-së. Bazuar në raportimin e KPA-së numri mesatar i çështjeve për 1 muaj është 5 çështje për vitin 2023. Kjo tregon një tendencë që mund të ndikojë afatin ligjor të mandatit të KPA-së.

Ndërmarrja nga ana e institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (KLGJ, KLP) e masave të cilat sigurojnë vijueshmërinë e standardeve të procesit të verifikimit kalimtar të subjekteve, edhe pas përfundimit të organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, mbetet një sfidë e cila duhet adresuar në të ardhmen. Zhvillimi i kapaciteteve të KLGJ dhe KLP, procedurat e emërimit, promovimit dhe transferimit të magistratëve duhet të kalojnë nëpërmjet sistemit të kontroleve të integritetit përpara hyrjes në karrierën e magistraturës si dhe gjatë karrierës, si dhe kontrollit të pasurisë. Standardet e larta të vendosura nga organet e vetting-ut lidhur me kontrollin e pasurisë dhe figurës, duhet tashmë të pranohen dhe zbatohen nga KLGJ dhe KLP.

Sa i takon përditësimit dhe përmirësimit të legjislacionit të Reformës në Drejtësi, konstatohet një progres i dukshëm në lidhje me plotësimin e kuadrit nënligjor, për të gjitha institucionet (shih treguesin e OS 1.2). Por, pavarësisht numrit të konsiderueshëm të akteve nënligjore të miratuara nga ana e KLGJ-së, përgjatë vitit 2023, mbetet problematikë mosaprovimi ende, edhe pas 5 viteve nga ngritja e institucionit, i rregullores së brendshme, gjë e cila ndikon në funksionimin e të gjithë strukturave të institucionit.

Po kështu, sa i përket kompletimit të paketës nënligjore, bazuar në komponentin e lidhur me KLP, edhe pse kemi një numër aktesh nënligjore të miratuara në fund të vitit 2023, ka ende

boshllëk nënligjor. Për sa më sipër, kërkohet një planifikim më i mirë i procesit të draftimit dhe miratimit të akteve, në mënyrë që ky process të marrë kohën e nevojshme dhe të mundësojë miratimin e akteve nënligjore me cilësi dhe në kohën e duhur. Cilësia e akteve nënligjore, e të gjitha organeve të drejtësisë, përfshirë këtu edhe gjykatat dhe institucionet e varësisë, mbetet një sfidë e së ardhmes e cila ndikon drejtpërdrejt në mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë dhe është një parakusht për funksionimin me efikasitet të këtyre institucioneve.


Përfundimi i procesit të trajtimit të ankesave të mbartura nga institucionet e mëparshme (backlog), nga ana e ILD-së evidentohet si një arritje e konsiderueshme përgjatë vitit 2023, e lidhur me arritjen e objektivave të Qëllimit I të Politikës.

Vakancat në numrin e inspektorëve magjistratë dhe jo-magjistratë në ILD mund të ndikojnë në numrin e inspektimeve të planifikuara dhe tematike, gjë që kërkon adresimin sa më të shpejtë të kësaj çështjeje dhe plotësimin e vakancave të inspektorëve magjistratë dhe jo-magjistratë, por veçanërisht plotësimi i pozicioneve të inspektorëve magjistratë në ILD. Për këtë problematikë duhen marrë në konsideratë disa aspekte me qëllim rekrutimin e jo vetëm kandidatëve magjistratë të cilët përmbushin kriteret ligjore, por gjithashtu sigurimin e një procesi rekrutimi që mundëson transferimin e magjistratëve me përvojë të cilët zotërojnë kapacitetin e duhur profesional dhe integritet të lartë për të hetuar organet gjyqësore dhe magjistratët në detyrë. Sigurisht, do të nevojiteshin edhe ndryshime ligjore për të garantuar këtë rezultat, pra ngritjen dhe forcimin e imazhit të inspektorëve të ILD-së si një model për të gjithë magjistratët dhe për të garantuar respektimin dhe vlerësimin e tyre nga kolegët e gjyqësorit.

Po kaq e rëndësishme është ndërmarrja nga ana e ILD-së, brenda vitit 2024 dhe 2025, në bashkëpunim me partnerët dhe me institucionet e tjera e masave lidhur me forcimin e kapaciteteve të inspektimit; promovimin e imazhit publik të inspektorëve; hapjen e thirrjeve me qëllim tërheqjen e inspektorëve të profilit të lartë dhe; rekrutimin e inspektorëve me inspektorë të profilit të lartë.

II. Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Dytë Politik “Forcimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me standardet kushtetuese, ligjore dhe evropiane”, konstatohet se:

Ka arritje në drejtim të plotësimin të vakancave dhe forcimit të kapaciteteve infrastrukturore në Gjykatën Kushtetuese, gjë e cila konsiderohet një premisë për funksionimin e plotë të kësaj Gjykate.



Gjithashtu, po vijon implementimi me sukses i hartës së re gjyqësore, me ngritjen e 13 gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Megjithatë, infrastruktura në zbatim të hartës së re gjyqësore nuk është e siguruar, pasi ka probleme me miratimin e shesheve të ndërtimit nga ana e bashkive për godinat e reja të gjykatave. Mungesa e një studimi të mirëfilltë fizibiliteti mbetet një shqetësim potencial në sigurimin e infrastrukturës ndërtimore.

Plotësimi i vakancave të magistratëve në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë të juridiksionit të përgjithshëm, mbetet një problematikë e cila vjen më së shumti si pasojë e procesit të vetting-ut. Në adresimin dhe plotësimin e vakancave është e rëndësishme që KLGJ të marrë në konsideratë masa për të mundësuar emërimet, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë të magistratëve, bazuar në vlerësime etike dhe profesionale të rregullta dhe në kohë. Momentalisht, vakancat në Gjykatën e Apelit për gjyqtarë dhe staf administrativ janë problematika më e madhe pasi ambientet për Gjykatën e Apelit nuk janë konceptuar për këtë numër gjyqtarësh dhe anëtarësh stafi.

Zhvillimi i standarteve të plota dhe të gjithanshme lidhur me treguesit e performancës së gjykatave përbën një risk për monitorimin e performancës së gjykatave, sipas standarteve më të mira. Pjesë e procesit të zhvillimit të standarteve duhet të konsiderohet ngritja e mekanizmave monitorues të zbatimit të tyre.

Fillimi i punës për hartimin e një strategjie të mirëfilltë dhe një plan veprimi me masa konkrete, për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, mund të konsiderohet si një hap pozitiv për krijimin e hapësirave për uljen e backlog-ut dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjeve gjyqësore.

Evidentohet një përpjekje e mirë në plotësimin e kuadrit nënligjor për funksionimin e gjykatave por nevojitet një mbështetje më e madhe për zbatimin e këtyre akteve si dhe për vlerësimin e efikasitetit në zbatimin e legjislacionit dytësor.

Referuar raportimeve nga institucionet, konstatohen arritje në drejtim të metodologjisë së trajnimeve të magistratëve në mënyrë që ato të jenë sa më të dobishme për përfituesit e tyre dhe të rrisin cilësinë e gjyqësorit, po ashtu edhe për procesin e trajnimit të magistratëve dhe të subjekteve të tjera. Në përputhje dhe me rekomandimet e Screening Report të BE-së, në emërimin e profileve profesionale të Shkollës së Magjistraturës duhet marrë parasysh plotësimi i kriterëve profesionalë dhe etikë në mënyrë që të shmanget përfshirja e magistratëve të shkarkuar nga procesi i *vetting-ut*. Krijimi i modeleve pozitive në përgatitjen e magistratëve të rinj është një nga synimet më të rëndësishme të agjendës së ardhshme.

Sa i takon arritjes së objektivit “Informimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve të ligjit “Për ndihmën juridike falas” për të drejtat e tyre për ndihmë dhe akses në institucione” konstatohet progres i dukshëm nëpërmjet organizimit të fushatave ndërgjegjësuese, materialeve promovuese, ndërtimit dhe përmirësimit të website-it informativ dhe i aksesueshëm për të gjitha grupet vulnerabël.

Ndërkohë që, me gjithë përpjekjet e bëra nga institucionet për zbatimin e masave në përmbushje të Qëllimit Politik, referuar raportimeve, konstatohen problematika të cilat duhen adresuar, si:


- Zgjidhja e çështjeve të prapambetura mbetet ende shqetësim. Referuar treguesit për zgjidhjen e çështjeve të prapambetura për Gjykatën e Lartë, konstatohet ulje e kohës së gjykimit të çështjeve penale, gjë që ndikon pozitivisht në uljen e backlog-ut. Nga ana tjetër, lidhur me administrimin e çështjeve civile dhe administrative ka një tendencë në rritje, të kohës së nevojshme për administrimin e çështjeve. Këta tregues bëjnë të nevojshëm vijimin e masave për reduktimin e backlog-ut, si pjesë e një strategjie të mirëfilltë dhe një plan veprimi me masa konkrete;
- Ndërtimi dhe vënja në funksion i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë;

Edhe pas 5 viteve nga krijimi dhe konsolidimi i institucioneve të reja të drejtësisë, ka ende problematika të mëdha në bashkëpunimin dhe koordinimin e tyre. Gjatë vitit 2023, u mbajt me datë 12.5.2023 në qytetin e Korçës një mbledhje e përbashkët, ku tematika kryesore e këtij takimi u fokusua tek sfida e Këshillave dhe instrumentat për të reduktuar numrin e çështjeve të prapambetura (backlog-un) në sistemin gjyqësor dhe rolin e KLGJ/KLP në forcimin e marrëdhënieve me median dhe publikun. Megjithatë numri i ulët i takimeve të përbashkëta mbetet një problematikë në lidhje me bashkëpunimin ndërinstytucional.

Në drejtim të zbatimit të sistemeve alternativë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mbetet sfida puna në drejtim të rritjes së kapaciteteve të DHKN, rritjes së numrit të rasteve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rrugë alternative, gjetjen e mekanizmave për ta bërë ndërmjetësimin më të aksesueshëm, si dhe kërkimi dhe aplikimi i praktikave më të mira evropiane.

Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Tretë Politik “Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore, brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit”, konstatohet se:

Me gjithë hapat e bëra deri më tani, procesi i hartimit dhe miratimit të ndryshimeve të reja të Kodit Penal, në përputhje me *acquis* dhe rekomandimet e screening report, në fushën penale dhe kriminalitetin, ende mbetet i pafinalizuar. Duhet theksuar se hartimi i Kodit të ri Penal në përputhje me *acquis* e BE-së është sfidues dhe kërkon kohën, burime dhe profesionalizmin e duhur. Kështu cilësia e Kodit të ri Penal duhet konsideruar si prioritet.



Lidhur me strukturat e SPAK, në kuadër të forcimit të kapaciteteve institucionale, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2023 ka realizuar me sukses objektivat e saj në përforsimin e kuadrit rregullator të institucionit, duke ndikuar pozitivisht në mirëfunksionimin e veprimtarisë institucionale. Byroja Kombëtare e Hetimit duhet të vijojë plotësimin e vacancave në pozicionet e oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të administratës. Nga ana e kësaj strukture janë paraqitur synime për struktura më efikente, të kompletuara me njësi të analizës së riskut, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe operacionale, si dhe rekrutimi i kapacitetet njerëzore cilësore.

Institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, pavarësisht hapave pozitivë në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, ndeshen ende me disa nevoja, si p.sh. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, paraqet nevoja lidhur me zgjerimin e hapësirave dhe përmirësimin e standarteve të godinave të degëve lokale, gjë e cila do të sigurojë përmirësimin e shërbimit që ofron kjo drejtori.


Mbetet sfidë bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e drejtësisë penale, veçanërisht bashkëpunimi midis prokurorive dhe shërbimit të provës, për të mundur respektimin e afateve ligjore për ekzekutimin e vendimeve me shërbim prove. Vonesa në ekzekutimin e shërbimit të provës ndikon në zbatimin e duhur të shërbimit të provës si dënim alternativ, efektin individual të këtij ndëshkimi si dhe cënon besimin në sistemin e drejtësisë.

Në lidhje me sistemin e vuajtjes së dënimit, shënohen arritje në miratimin dhe implementimin e Master Planit të ri të Burgjeve dhe në drejtim të rritjes së kapaciteteve të punonjësve të burgjeve. Ndërkohë që, referuar treguesve të raportit të personave me numrin e shtretërve në burgje (shih tregues e OS 3.5), konstatohet risk mbipopullimi i cili duhet adresuar me masa konkrete.

Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Katërt Politik “Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucionet e sektorit”, konstatohet se:

Miratimi dhe implementimi me një sërë aktivitete të Strategjisë dhe Planit të Komunikimit në fushën e drejtësisë është një arritje e regjistruar përgjatë vitit 2023 nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Në vijim të procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, për herë të parë, Qeveria Shqiptare me vendimin nr. 729, datë 13.12.2023, miratoi Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, të propozuar nga Ministria e Drejtësisë, në përputhje me prioritetet dhe programin e Qeverisë Shqiptare, duke siguruar një kuadër të plotë për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimit.




Ndërkohë që, dixhitalizimi i sistemit të drejtësisë dhe vënia në funksion e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve, paraqet vështirësi dhe sfida, të cilat duhen adresuar. Vonesat në ndërtimin e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve paraqesin një risk të konsiderueshëm, në vënien në funksion të këtij sistemi. Zbatimi i Udhërrëfyesit ndërinstytucional për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë dhe në këtë kuadër ndërlidhja e sistemeve të menaxhimit të çështjeve të çdo institucioni në një system të integruar të menaxhimit të çështjeve, duke marrë në konsideratë hapat e ngadaltë deri më tani, mbart në vetvete gjithashtu një risk të konsiderueshëm dhe kërkon përpjekje maksimale për vënien në jetë.

Dixhitalizimi i sistemit të drejtësisë dhe vënia në funksion e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve, synohet të arrihet nëpërmjet: plotësimi të vakancave, rritjes së kapaciteteve, ndryshimeve ligjore, bashkëpunimit ndërmjet institucioneve për sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve, si dhe sigurimit të buxheteve të nevojshme, për vënien në funksion të sistemit.

Rritja në tërësi e bashkëpunimit ndërinstytucional, për zbatimin e politikave dhe reformave, gjithsesi, mbetet sfida e agjendës së ardhshme.

Arritjet dhe sfidat kryesore të identifikuar në këtë raport janë përmbledhur vizualisht në grafikun më poshtë.

DISA NGA ARRITJET DHE SFIDAT KRYESORE



Duke parë përpara, SND dhe dokumentet e saj strategjike do të përditësohen për të mundësuar përmirësimin e performancës nga institucionet dhe një raport të orientuar drejt rezultateve për monitorimin e performancës në zbatimin e SND, i cili përmban mjete për identifikimin dhe zbutjen e riskut. Përditësimi do të pasqyrojë situatën aktuale të sistemit dhe institucioneve të drejtësisë, si dhe nevojat dhe prioritetet e institucioneve në kuadër të integritetit në BE.

I. INFORMACION PËRMBLEDHËS

1.1. Hyrje

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021–2025 (SND 2021-2025) dhe dokumentet e saj strategjike si Plani i Veprimit dhe Pasaporta e Treguesve u miratuan në vitin 2021, me VKM nr. 823, datë 24.12.2021 dhe zbatimi i saj nisi menjëherë, si një përgjigje e ushtrimit të përgjegjësiwe institucionale për jetësimin e Reformës në Drejtësi.

Raporti Vjetor i Monitorimit për vitin 2023, mbi zbatimin e SND 2021-2025, është raporti vjetor i tretë i monitorimit të zbatimit të SND 2021-2025. Ky raport është hartuar në një kohë që përkon me realizimin e gjysmës së afatit kohor 5 vjeçar, të zbatueshmërisë së SND 2021-2025, si dhe përkon me kohën në të cilën është kërkuar kryerja e një vlerësimi të ndërmjetëm të SND 2021-2025.

Raporti i Vlerësimi të Ndërmjetëm, i cili u hartua disa muaj përpara hartimit të Raportit Vjetor të Monitorimit për vitin 2023, përmban disa gjetje dhe rekomandime lidhur me status-quo-në e zbatimit të SND 2021-2025, cilësinë e administrimit dhe nivelin e zbatueshmërisë së masave dhe treguesve.

Në këtë raport analizohet ecuria e zbatimit të SND 2021-2025, për vitin 2023. Raporti përmbledh të dhëna dhe analiza nga 18 institucione në sektorin e drejtësisë. Të gjitha institucionet e pavarura të drejtësisë dhe disa institucione nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë kanë kontribuar në zbatimin e SND.

Tashmë, në vitin e tretë të zbatimit të saj, SND 2021-2025 ka shënuar arritje të rëndësishme dhe inkurajuese në drejtim të konsolidimit të pavarësisë së institucioneve të drejtësisë, efikasitetit, rritjes së transparencës, forcimit të besimit të publikut, si dhe përmirësimit të mëtejshëm të infrastrukturës, së të gjithë hallkave të sistemit të drejtësisë, nëpërmjet zbatimit të masave konkrete dhe arritjes së objektivave të parashikuara strategjikë. Këto arritje konfirmohen, gjithashtu, nga gjetjet e Progres Raportit të Komisionit Evropian, tetor 2023, ku theksohet se Shqipëria ka bërë një progres të mirë me zbatimin e Reformës në Drejtësi.

Nën dritën e rekomandimeve, në kuadër të procesit të negociatave të anëtarësimit ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, ky raport ka një rëndësi të vecantë për të reflektuar sfidat e agjendës 2030 dhe për të vendosur piketat e procesit të hartimit të Strategjisë së re Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030.

Gjatë pesë viteve të zbatimit të saj, SND 2021-2025 parashikon realizimin e 17 Objektivave Specifike dhe 184 masave, të ndara në katër objektiva politikë. Arritjet dhe sfidat kryesore në sektorin e drejtësisë maten përmes 32 treguesve, të përfshirë në Pasaportën e Treguesve. Në këtë raport janë marë në analizë:

- 16 OS (nga totali 17 OS), pasi OS që lidhet me Drejtësinë për të Mitur, gjen zbatim në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026
- 163 masa të zbatueshme në vitin 2023

Raporti paraqet gjithashtu një analizë të thellë mbi zbatimin e 32 indikatorëve të parashikuar në Pasaportën e Treguesve, lidhur me secilin Qëllim Politik dhe Objektiv Specifik. Gjetjet dhe

rekomandimet kryesore të këtij Raporti, paraqiten si më poshtë.

1.2. Përmbledhje e arritjeve dhe sfidave kryesore

Në tabelën më poshtë listohen disa konkluzione të përgjithshme lidhur me arritjet dhe sfidat në sektorin e drejtësisë bazuar në gjetjet dhe analizat për periudhën raportuese janar-dhjetor 2023. Tabela e konkluzioneve është ndarë sipas Qëllimeve të Politikës.

Qëllimi Politik I	
Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet evropiane, duke garantuar pavarësi, efikasitet dhe llogaridhënie.	
<p>Arritjet</p> <ul style="list-style-type: none"> Vijueshmëria e procesit të verifikimit kalimtar të subjekteve të vlerësimit nga organet ekzistuese të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve po ecën me ritme të mira, si nga ana e KPK-së dhe KPA-së. (Objektivi specifik 1.1) Evidentohet si një arritje e konsiderueshme përgjatë vitit 2023, përfundimi i procesit të trajtimit të ankesave të mbartura nga institucionet e mëparshme (basklog), nga ana e ILD-së. (Objektivi specifik 1.2) 	<p>Sfidat</p> <ul style="list-style-type: none"> Ndërmarrja nga ana e institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (KLGJ, KLP) e masave të cilat sigurojnë vijueshmërinë e standardeve të procesit të verifikimit kalimtar të subjekteve, edhe pas përfundimit të organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, mbetet një sfidë e cila duhet adresuar në të ardhmen. (Objektivi specifik 1.1) Cilësia e akteve nënligjore, e të gjitha organeve të drejtësisë, përfshirë këtu edhe gjykatat dhe institucionet e varësisë, mbetet një sfidë e së ardhmes e cila ndikon drejtpërsëdrejti në mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë dhe është një parakusht për funksionimin me efikasitet të këtyre institucioneve. (Objektivi specifik 1.2) Zhvillimi i kapaciteteve të KLGJ dhe KLP, procedurat e emërimit, promovimit dhe transferimit të magistratëve duhet të kalojnë nëpërmjet sistemit të kontroleve të integritetit përpara hyrjes në karrierën e magistraturës si dhe gjatë karrierës, si dhe kontrollit të pasurisë. Aplikimi, në këtë drejtim, i të njëjtave standardeve të larta të vendosura nga procesi i vetting-ut vlerësohet tejet i rëndësishëm. (Objektivi specifik 1.3) Plotësimi i vakancave të inspektorëve magistratë dhe jo-magjistratë, por veçanërisht plotësimi i pozicioneve të

	<p>inspektorëve magistratë në ILD. (Objektivi specifik 1.3)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërmarrja nga ana e ILD-së, brenda vitit 2024 dhe 2025 në bashkëpunim me partnerët dhe me institucionet e tjera masa lidhur me forcimin e kapaciteteve të inspektimit: <ul style="list-style-type: none"> ▪ promovimin e imazhit publik të inspektorëve; ▪ hapja e thirrjeve me qëllim tërheqjen e inspektorëve të profilit të lartë; ▪ Rekrutimin e inspektorëve me inspektorë të profilit të lartë. (Objektivi specifik 1.3)
--	---

Qëllimi Politik II

Forcimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me standardet kushtetuese, ligjore dhe evropiane.

Arritjet	Sfidat
<ul style="list-style-type: none"> • Evidentohet një përpjekje e mirë në plotësimin e kuadrit nënligjor për funksionimin e gjykatave por nevojitet një mbështetje më e madhe për zbatimin e këtyre akteve. (Shih objektivin specifik 2.1) • Plotësimi i vakancave dhe i kapaciteteve infrastrukture në Gjykatën Kushtetuese konsiderohet një premisë për funksionimin e plotë të kësaj Gjykate. (Shih objektivin specifik 2.2) • Ka arritje në drejtim të metodologjisë së trajnimeve në mënyrë që ato të jenë sa më të dobishme për përfituesit e tyre dhe të rrisin cilësinë e gjyqësorit, po ashtu edhe për trajnimin e magistratëve dhe të subjekteve të tjera. (Shih objektivin specifik 2.3) • Fillimi i punës për hartimin e një strategjie të mirëfilltë dhe një plan veprimi me masa konkrete, për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura mund të konsiderohet si një hap pozitiv për krijimin e hapësirave për uljen e backlogut dhe përsheptimin e gjykimit të çështjeve gjyqësore. (Shih masën 2.4.4) 	<ul style="list-style-type: none"> • Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (shmangja e backlog-ut) kërkon hartimin e një strategjie të mirëfilltë dhe një plan veprimi me masa konkrete. (Shih masën 2.2.4) • Ndërtimi i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve dhe dixhitalizimi i vendimarrjes së Gjykatës Kushtetuese. (Shih masën 2.2.4) • Ndërtimi i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve dhe dixhitalizimi i vendimarrjes në Gjykatën e Lartë. (Shih masën 2.2.4) • Në përputhje dhe me rekomandimet e Screening Report, emërimi i profesorëve të shkollës së magistraturës duhet të marrë parasysh plotësimin e kriteve profesionale dhe etikë në mënyrë që të shmangët emërimi i magistratëve të shkarkuar nga vetting-u. Krijimi i modeleve pozitive në përgatitjen e magistratëve të rinj. (Shih masën 2.2.4) • Zhvillimi i standarteve të plota dhe të gjithanshme lidhur me treguesit e performancës së gjykatave përbën një risk për

<ul style="list-style-type: none"> Sa i takon arritjes së objektivit “Informimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve të ligjit “Për ndihmën juridike falas” për të drejtat e tyre për ndihmë dhe akses në institucione’ konstatohet progres i dukshëm nëpërmjet organizimit të fushatave ndërgjegjësuese, materialeve promovuese, ndërtimit dhe përmirësimit të ëeb-site informativ dhe i aksesueshëm për të gjitha grupet vulnerabël. (Shih masën 2.5.1) 	<p>monitorimin e performancës së gjykatave, sipas standarteve më të mira. (Shih masën 2.4.2)</p> <ul style="list-style-type: none"> Në drejtim të zbatimit të sistemeve alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mbetet sfida puna në disa drejtime: <ol style="list-style-type: none"> rritja e kapaciteteve të DHKN; rritja e numrit të rasteve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rrugë alternative; gjetja e mekanizmave për ta bërë ndërmjetësimin më të aksesueshëm; research dhe aplikim i praktikave më të mira europiane. (Shih masën 2.5.10)
--	---

Qëllimi Politik III

Një sistem i drejtësisë penale i bazuar në parimet moderne të drejtësisë, i cili garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazinë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide parandaluese të krimit.

Arritjet	Sfidat
<ul style="list-style-type: none"> Rritje dukshëm e efektivitetit në hetimin, ndjekjen penale, sekuestrin e pasurive, dhe numrin e akuzave të ngritura me kërkesat për gjykim për pastrimin e parave të dërguara në gjykatë, si dhe rritja dukshëm e dënimeve penale dhe konfiskimeve të pasurive në zbatim të rezultateve. (Shih masën 3.2.10) Për vitin 2023, nga çështjet e gjykuara në shkallë të parë të dërguara nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, vetëm në 4.3% është vendosur pafajësi ose është pushuar çështja/akuza dhe në 95.7% të pandehurit janë deklaruar fajtorë. (Shih indikatorin e OS. 3.2) Në kuadër të forcimit të kapaciteteve institucionale, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2023 ka realizuar me sukses objektivat e saj në përforcimin e kuadrit rregullator të institucionit, duke 	<ul style="list-style-type: none"> Miratimi i Kodit Penal në përputhje me <i>acquis</i> dhe rekomandimet e screening report lidhur me fushën penale dhe kriminalitetin. (Shih objektivin specifik 3.1) Struktura më efiçente të BKH, të kompletuara me njësi të analizës së riskut, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe operacionale, si dhe me kapacitetet njerëzore. (Shih masën 3.2.12) Bashkëpunimi ndërinstitucional për të respektuar afatet ligjore për ekzekutimin e vendimeve me shërbim prove, mbetet sfida. (ekzekutimi i vendimeve në lidhje me shërbimin e proves vonohet nga zyra e prokurorisë. Vonesa në ekzekutimin e shërbimit të provës ndikon në kuptimin e saj tek i denuari. (Shih masën 3.4.16) Rritja e kapaciteteve të punonjësve të burgjeve për marrëdhënien me të burgosurit. (Shih masën 3.5.4)

<p>hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore për mirëfunksionimin e veprimtarisë institucionale. (Shih masën 3.2.13)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Implementimi i Master Planit të ri të Burgjeve. (Shih masën 3.5.10)
--	---

Qëllimi Politik IV	
Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjitha institucionet e sektorit.	
<p>Arritjet</p> <ul style="list-style-type: none"> • Miratimi dhe implementimi me një sërë aktiviteteve të Strategjisë dhe Planit të Komunikimit në fushën e drejtësisë është një arritje e regjistruar përgjatë vitit 2023 nga ana e Ministrisë së Drejtësisë. (Shih objektivin specifik 4.3) • Në vijim të procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, për herë të parë Qeveria Shqiptare me vendimin nr. 729, datë 13.12.2023, miratoi Strategjinë Ndërsëktoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, të propozuar nga Ministria e Drejtësisë, në përputhje me prioritetet dhe programin e Qeverisë Shqiptare, duke siguruar një kuadër të plotë për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimit. (Shih objektivin specifik 4.3) 	<p>Sfidat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dixhitalizimi i sistemit të drejtësisë dhe vënia në funksion e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve, nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> ▪ plotësimit të vakancave, rritjes së kapaciteteve, amendamenteve ligjore etj. ▪ bashkëpunimit ndërmjet institucioneve për sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve. ▪ sigurimit të buxheteve të nevojshme për vënien në funksion të Sistemit; (shih masën 4.1.1). • Rritja në tërësi e bashkëpunimit ndër-institucional, për zbatimin e politikave dhe reformave. (Shih objektivin specifik 4.3)

1.3. Metodologjia

Metodologjia e Raportit të Monitorimit, përshkruan procesin e ndjekur gjatë hartimit të raportit dhe ka si qëllim kryesor të mundësojë udhëzimet e nevojshme për lehtësimin në kuptueshmërinë e tij, si dhe të orientohet drejt prezantimit të rezultateve kryesore për të nxjerrë në pah arritjet, sfidat dhe rekomandimet e adresuara për përmirësim.

Për të siguruar një proces monitorimi bazuar në arritje konkrete, Ministria e Drejtësisë realizon komunikime intensive me përfaqësuesit e strukturave të përfshira në Planin e Veprimit, me qëllim prezantimin e drejtë dhe të qartë të rezultateve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës së raportimit.

Kështu, gjatë periudhës hartuese, është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm (verbal dhe zyrtar) në varësi të specifikave për plotësimin e dokumentave raportues me disa prej institucioneve të përfshira në strategji, me qëllim evidentimin e rasteve të suksesit, të cilat kanë

sjellë rezultate të dukshme në veprimtarinë e tyre, gjithashtu identifikimin e sfidave, problematikave dhe komponentëve të cilët kanë ndikuar apo penguar progresin apo zbatimin e aktiviteteve të parashikuara.

Koordinimi institucional për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 128, dt. 08.11.2021 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues si dhe hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive. Ky sektor kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik (SND 2021-2025) për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2023, është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga institucionet përgjegjëse dhe kontributore të planit të veprimit.

Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Ministria e Drejtësisë, harton raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SND-së për 5 vitet e ardhshme, raporte të cilat publikohen në linkun: <https://drejtesia.gov.al/plani-i-veprimit-te-strategjise-ndersektoriale-te-drejtesise/>

Manuali i Raportimit sipas sistemit IPSIS

Ministria e Drejtësisë ka hartuar raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse sipas manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS miratuar me vendimin nr.290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS).

Përputhshmëria e raporteve të monitorimit dhe performancës me Parimet e Mirëqeverisjes

Ky raport është hartuar përputhje me Parimet e Mirëqeverisjes të cilët përmbajnë një kornizë të vlerësimit të Raporteve të Monitorimit dhe të Performancës e cila mundëson analizën e rregullt të progresit të arritur në zbatimin e Parimeve dhe caktimin e standardeve që duhet të përmbush vendi. Parimet janë të hartuara për vendet që duan të anëtarësohen në BE dhe që marrin ndihmë nga BE-ja përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA).

- **Efikasiteti:** Agregimi i niveleve të dokumenteve. Ky parim duhet të lejojë shfrytëzimin e sinergjive mes raporteve të dokumenteve të ndryshme. Nëse dokumentet janë të lidhura ngushtë në aspektin e përmbajtjes, atëherë sistemi i M & R-së duhet ta marrë këtë parasysh për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të njëri-tjetrit dhe jo

mbivendosjen e njëri-tjetrit. Elementet bazë të raporteve të M & R-së (p.sh. objektivat, masat, indikatorët) në dokumentin e nivelit më të ulët do të zhvillohen drejt përmbajtjes së M & R-së në dokumentet e nivelit në të lartë. Duhet të merren parasysh lidhjet. Ky parim duhet të përmirësojë frekuencën dhe përmbajtjen e raporteve të M & R-së.

- **Llogaridhënia:** Respektimi i përmbajtjes së dokumenteve të planifikimit. Raportet e monitorimit duhet të përqendrohen në elementet e dokumenteve të planifikimit për të siguruar llogaridhënie lidhur me reformat dhe ndërhyrjet e planifikuara.
- **Rëndësia:** Respektimi i nevojave të përdoruesve të monitorimit dhe performancës. Raportet e M & R-së duhet të jenë të përshtatura për nevojat e përdoruesit në aspektin e përmbajtjes, gjatësisë dhe frekuencës. Për më tepër, raportet duhet të japin llogari për arritjen e rezultateve në mënyrë të verifikueshme dhe në raport me treguesit SMART.

Mekanizimi i Integruar i Politikave

Sipas Urdhërit Nr.90 datë 01.08.2023 të Kryeministrit “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe riorganizimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar” mekanizmat ndërsektorial tanimë funksionojnë mbi bazën e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës (GNP).

Fazat e ndjekura për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Fazat që janë ndjekur për përgatitjen dhe konsolidimin e raportimit të monitorimit dhe performancës, paraqiten si më poshtë:

- kërkesa për kontribut u dërgua në datë 30 janar 2024 tek të gjitha institucionet raportuese në përputhje me standardet e sistemit IPSIS dhe Parimet e Mirëqeverisjes;
- organizimi i një workshop nga asistenca JUSTAL 7 nëntor 2023;
- publikimi në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe dërgimi tek të gjitha institucionet e përfshira në strategji me qëllim marrjen e komenteve dhe sugjerimeve më datë 12 prill 2024;
- konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të sjella;
- organizimi i mbledhjes së Komitetit Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi me qëllim miratimi i raportit të monitorimit më datë 25 prill 2024;
- publikimi i Raportit Vjetor të Monitorimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë;
- dërgimi i procedurave të mbledhjes të KDS-së (minutat e takimit, konkluzionet operacionale, raporti i konsultimit publik) dhe paketa finale, së bashku me linkun e publikimit për njohje SASPAC.

Metodologjia e analizimit të të dhënave për Raportin e Monitorimit dhe Performancës

Raporti shpreh qartë vlerësimin e arritjeve kryesore duke përdorur grafikë, dashboards, analiza të thelluara, edhe vizualisht përmes tabelave. Gjithashtu paraqitet qartë identifikimi i shkallës së performancës për Qëllimet e Politikave dhe Objektivët Specifikë.

Analiza mbi progresin e realizimit të Qëllimeve Politike ndjek një qasje të strukturuar. Progresi lidhur me secilin Qëllim Politik është analizuar në përgjithësi sipas Objektivave Specifikë (OS) përkatës. Në vijim, për secilin OS është paraqitur një përmbledhje e rezultateve sasiore dhe cilësore të zbatimit të masave përkundrejt kryerjes së veprimeve për realizimin e tyre nga institucionet përgjegjëse, analiza e risqeve dhe veprimeve për adresimin e tyre (sipas rastit) dhe analiza e treguesve të performancës, nëse kjo ka qënë e mundur mbi bazën e të dhënave të paraqitura nga institucionet përgjegjëse.

Prezantimi i rezultateve mbi zbatimin a masave ndjek numërimin e Planit të Veprimit dhe është paraqitur me sfond me ngjyrë sipas nivelit të zbatimit (*të zbatuara plotësisht/ të zbatuara pjesërisht/ të pazbatuara*). Disa masa rezultojnë të pazbatueshme dhe janë paraqitur me sfond të bardhë. Ato përfshijnë: (i) masat afati i zbatimit i të cilave fillon pas periudhës aktuale të raportimit; (ii) masa të cilat nuk mund të zbatohen nga institucioni raportues për arsye të cilat nuk varen nga institucioni (p.sh. mungesë e kompetencave).

Pë sa është e mundur, analiza për vitin 2023 përmban edhe elemente krahasueshmërie me vitet 2021 dhe 2022, për të evidentuar zhvillime në lidhje me realizimin e Qëllimeve të Politikës, Objektivave Specifikë, masave dhe treguesve të performancës.

- **Përcaktimi i nivelit të zbatimit të masave** (në përqindje) është ai i raportuar nga secili institucion përgjegjës, dhe është evidentuar në kontributet e përcjella prej tyre mbi çdo masë të përcaktuar. Shkalla e zbatimit të masave është përcaktuar si më poshtë:
 - **E zbatuar:** masa e cila është përmbushur plotësisht;
 - **Pjesërisht e zbatuar/Në proces:** masa e cila në periudhën e raportimit ka pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijon të jetë në zbatueshmëri.
 - **E pazbatuar:** masa e cila nuk ka pasur zhvillim dhe progres për periudhën raportuese.
- **Përcaktimi i nivelit të realizimit të OS** është kryer përkundrejt numrit të masave të zbatuara (i shprehur në %). Përlllogaritja është kryer në bazë të raportit të masave të zbatuara dhe numrit total të masave të zbatueshme për një objektiv specifik.
- **Përcaktimi i nivelit të realizimit të Qëllimeve të Politikave** është përlllogaritur si mesatarja e përqindjes së realizimit të Objektivave Specifikë përkatës.
- Në raportin e monitorimit vlerësohet **identifikimi i risqeve** me qëllim identifikimin e hapave që do të duhen të ndiqen për tu adresuar në kuadër të implementimit të objektivëve të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. Risqet janë identifikuar në nivel QP dhe OS në

zbatim të Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.¹ Janë marrë në konsiderate dy aspekte: mundësia e verifikimit të risqeve dhe ndikimi i tyre, sipas vlerësimit të kryer nga secili institucion përgjegjës për zbatim. Secili nga këto dy aspekte vlerësohet në bazë të tre kategorizimeve: *i. ulët; ii. mesëm dhe iii. lartë.*

- Konkluzionet dhe rekomandimet janë në përputhje me evidencat e raportit dhe përfshijnë masa konkrete për përmirësim për tu adresuar në vendimmarrje.

Konsultimi publik i Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Një komponent i rëndësishëm i mirëqeverisjes që ndërlidhet me rritjen e cilësisë së llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve publike si dhe forcimin e demokracisë është procesi i konsultimit publik. Tashmë korniza rregullatore për konsultimin publik është unifikuar dhe ka ndikuar në përmirësimin e transparencës dhe cilësisë së politikave. Prioritare mbetet përfshirja aktive e publikut dhe shoqërisë civile në proceset e politikëbërjes.

Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë e dërgoi në datën 12.04.2024 dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe e publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit www.drejtësia.gov.al, në menu prioritete/strategjia ndërsektoriale/Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kryen reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe vijoi me zhvillimin e një takimi të dedikuar, në kuadër të diskutimit të analizës së kryer, gjetjeve të raportit, vlerësimit të qëllimeve të politikës në prezencë të të gjithë institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit.

Pas miratimit të raportit në Komitet Drejtues Sektorial, Ministria e Drejtësisë publikon në faqen e tij zyrtare raportin në gjuhën Shqipe dhe Angleze.

¹ Analiza dhe vlerësimi i riskut është kryer referuar Guidës Metodologjike për hartimin e raporteve të monitorimit për Agjendën e Mirëqeverisjes.



II. VLERËSIMI I ARRITJES SË QËLLIMEVE TË POLITIKËS KUNDREJT MASAVE DHE TREGUESVE

2.1. Qëllimi i Parë i Politikës

Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien

Qëllimi i Parë i Politikës: 22 masa

22 masa të zbatueshme në 2023



Në nivelin e Qëllimit të Parë të Politikës është parashikuar një tregues:

- *% e subjekteve të rivlerësimit kalimtar që besojnë se institucionet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë janë të pavarura dhe të paanshme*

Treguesi synon të masë nëpërmjet një pyetësori të hartuar nga KLGJ dhe KLP punën e institucioneve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë nëpërmjet perceptimit të subjekteve të rivlerësimit kalimtar. Informacionet e raportuara dhe analizuara tregojnë se një vlerësim i tillë nuk është bërë. KLGJ dhe KLP argumentojnë se kjo masë nuk lidhet me institucionin, ndaj nuk janë raportuar të dhëna.

Obiektivi Specifik 1.1.

Plani i Veprimit për Objektivin 1.1 parashikon parashikon 5 masa, prej të cilave **4 masa janë zbatuar plotësisht** dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht. 80% e masave janë zbatuar plotësisht.

OS 1.1: Vazhdimi i zbatimit dhe finalizimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në mënyrë efektive dhe efikase sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe ligjit.	
1.1.1	<p><i>Përgatitja dhe konsolidimi i raporteve të rivlerësimit kalimtar të subjekteve të vlerësimit nga organet ekzistuese të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në mandatin ekzistues.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA)</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Sipas raportimit të KPK-së për Raportin Vjetor 2023 për zbatimin e SND 2021 – 2025, KPK-ja ka nxjerrë 119 vendime në vitin 2023. Përgjatë periudhës së raportimit, KPK ka treguar qëndrueshmëri në përgatitjen dhe konsolidimin e raporteve të vlerësimit kalimtar të subjekteve krahasuar me vitin 2022 (117 vendime).</p> <p>Duke patur parasysh që mandati i KPK, sipas parashikimit ligjor përfundon në dhjetor 2024, bazuar në trendin e qëndrueshëm në përgatitjen dhe konsolidimin e raporteve të vlerësimit kalimtar të subjekteve, ky proces do të përfundojë brenda afatit.</p>
1.1.2	<p><i>Mbështetje ligjore dhe buxhetore për organet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Kuvendi</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Masa është zbatuar në vitin 2022 nëpërmjet vendimeve Nr. 35. 36 dhe 37 datë 12.05.2022 të Kuvendit për ndryshimet strukturore të organeve të vettingut dhe Vendimi për fonde shtesë në vitin 2022.</p> <p>Mbështetja ligjore dhe buxhetore për organet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve është plotësisht i siguruar.</p>
1.1.3	<p><i>Finalizimi i raporteve të vlerësimit përfundimtar.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> KPK, KPA</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Gjatë vitit 2023, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë gjithsej 119 vendime.</p> <p>Gjatë periudhës së aktivitetit, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë regjistruar gjithsej 361 çështje të juridiksionit të rivlerësimit, nga të cilat, 57 çështje përgjatë vitit 2023.</p> <p>Në të njëjtën periudhë, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka shpallur gjithsej 230 vendime të Juridiksionit të Rivlerësimit, nga të cilat, 55 vendime përgjatë vitit 2023. Specifikisht, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka vendosur:</p> <ul style="list-style-type: none">- Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit - 42 vendime- Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit - 10 vendime- Ndërprerjen, përfundimin e procesit të rivlerësimit dhe pezullimin për një periudhë 1-vjecare - 3 vendime

	Sa i përket denoncimeve nga publiku, gjatë periudhës kohore janar - dhjetor 2023, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit janë regjistruar dhe trajtuar 121 denoncime.
1.1.4	<p><i>Rishikimi i kuadrit ligjor për organet e qeverisjes së drejtësisë dhe përfshirja e përvojave të mira në legjislacionin e rishikuar. (2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Komsioni i Pavarur i Kualifikimit</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Masa është zbatuar në vitin 2022 me vazhdimin e mandatit të KPK-së deri më 31.12. 2024.</p>
1.1.5	<p><i>Rishikimi i rregulloreve të brendshme të organeve të qeverisjes në sistemin e drejtësisë dhe përfshirja e praktikave të mira në rregulloret e rishikuara. (2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Komsioni i Pavarur i Kualifikimit</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Me zgjatjen e mandatit të KPK-së dhe me vendimin e Kuvendit për finalizimin e procesit të vettingut nga KPK dhe KPA nuk është më e nevojshme të ndryshohen rregulloret e brendshme të institucioneve të qeverisjes së drejtësisë.</p>

Për OS 1.1 është përcaktuar një tregues performance:


- ***% e gjyqtarëve që kanë përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar nga organet e sistemit të drejtësisë.²***

Sipas treguesve të pasaportës, vlera e synuar për vitin 2023 për këtë tregues është “80% e numrit total të subjekteve të rivlerësimit” (805 subjekte vlerësimi në fillim të procesit). Deri në fund të vitit 2023, KPK përfundoi procesin kalimtar të rivlerësimit me vendim përfundimtar për 723 subjekte, ose rreth 90% të listës së subjekteve (periudha 8 shkurt 2018 deri më 31 dhjetor 2023). Në vitin e fundit të mandatit, Komisioni duhet të rivlerësojë 10% të subjekteve të fundit në listë, dhe të përfundojë me vendim të arsyetuar rivlerësimin kalimtar brenda datës 31.12.2024, për të gjithë subjektet e nenit 179/b të Kushtetutës. Vlera e synuar e treguesit u arrit dhe u tejkalua.

²Targeti i vendosur është pjesë e analizës vetëm për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK). Raportimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit bazuar në organizimin dhe funksionin e tij konsiston vetëm në të dhënat statistikore lidhur me ecurinë e procesit të rivlerësimit si dhe koston në buxhet të aktivitetit të parashikuar për vitin përkatës.

Gjatë gjithë periudhes së aktivitetit, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë regjistruar gjithsej 361 çështje të juridiksionit të rivlerësimit. Deri në fund të vitit 2023, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka shpallur gjithsej 230 vendime nga të cilat, 55 vendime përgjatë vitit 2023.

% e gjyqtarëve/prokurorëve që kanë përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar



Obiektivi Specifik 1.2.

Plani i Veprimit për Obiektivin 1.2 parashikon parashikon 12 masa, prej të cilave **11 masa janë zbatuar plotësisht** dhe **1 masë rezulton e pazbatuar**. 91.6 % e masave janë zbatuar plotësisht.

OS 1.2: Përditësimi dhe përmirësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi bazuar në gjetjet nga analiza dhe monitorimi i zbatimit të reformës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, legjislacionin e përditësuar për kompetencat, transparencën, efikasitetin, dhe koordinimin.

1.2.1	<p>Përgatitja e analizës së zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLGJ-në. (pz 2021-2021)</p> <p>Institucioni raportues: Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p>Informacion mbi zbatimin e masës: Zbatuar.</p>
1.2.2	<p>Përgatitja e përgjigjes mbi analizën e rishikimit të ligjit mbi statusin dhe strukturën qeverisëse të KLGJ-së (draftpropozimet ligjore). (pz 2021-2021)</p> <p>Institucioni raportues: Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p>Informacion mbi zbatimin e masës: Zbatuar.</p>
1.2.3	<p>Finalizimi i rishikimit të kuadrit ligjor të lidhur me qeverisjen e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLGJ-në (konsultimi dhe miratimi i akteve). (pz 2021-2022)</p> <p>Institucioni raportues: Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p>Informacion mbi zbatimin e masës: Zbatuar.</p>
1.2.4	<p>Rishikimi dhe konsolidimi i rregullave të brendshme të KLGJ-së. (pz 2021-2021)</p>

	<p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Masa për periudhën raportuese është në proces. Arsyeja e shtyrjes së zbatimit të kësaj mase lidhet me prioritetet që Këshilli ka patur duke marrë në konsideratë gjendjen dhe nevojat emergjente të sistemit gjyqësor. Prioritet i Këshillit ka qenë implementimi i plotë i hartës gjyqësore si edhe strategjia e uljes së numrit të çështjeve të mbartura në gjykata.</p>
1.2.5	<p><i>Përgatitja e analizës së zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLP-në. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë i Prokurorisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer analizën e mangësive ligjore, si rrjedhojë e së cilës, është parë e nevojshme miratimi i disa akteve nënligjore të domosdoshme për karrierën e prokurorëve, duke tejkaluar edhe targetin e synuar për vitin 2023. Në kuadër të analizës së kryer nga ana e Këshillit, janë përcaktuar edhe prioritetet në hartimin e disa akteve të tjera nënligjore, që priten të miratohen gjatë vitit 2024.</p> <p>Për periudhën periudhën raportuese, KLP ka miratuar 7 akte rregullatore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Rregullore “Për përcaktimin e rregullave dhe arsyeve të lejimit të kandidatit për magjistrat për t’u emëruar në vitin pasardhës”; ▪ Rregullore “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë prokurorisë së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”; ▪ Rregullore “Për caktimin e rregullave dhe procedurave mbi uljen e ngarkesës së punës për prokurorët”; ▪ Rregullore “Mbi dhënien e lejes së papaguar”; ▪ Rregullore “Për caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë”; ▪ Rregullore "Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”; ▪ Rregullore “Për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm”. <p>Lidhur me vijimësinë e procesit të vlerësimit etik dhe profesional, KLP ka përfunduar plotësimin e tabelave statistikore mbi të gjitha prokuroritë. Ka përfunduar procesi i përzgjedhjes së dosjeve nga çdo prokuror që do t’i nënshtrohet vlerësimit, si dhe ka nisur hartimi i raporteve analitike, që priten të miratohen në fillim të vitit 2024. Ndërkohë, me vendimin Nr.381, datë 30.11.2023, është miratuar programi që përcakton listën e prokurorëve që do t’i nënshtrohen vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2024. Ndërsa, me vendimin Nr.406, datë 28.12.2023, janë caktuar me short relatorët dhe këshilltarët përgjegjës për procedurën e vlerësimit të prokurorëve të shortuar.</p>
1.2.6	<p><i>Përgatitja e përgjigjes mbi analizën e rishikimit të ligjit mbi statusin dhe strukturën qeverisëse të KLP-së (draftpropozimet ligjore). (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë i Prokurorisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>KLP-ja ka bashkëpunuar në vazhdimësi me Ministrinë e Drejtësisë, duke dhënë mendimin e saj kur një projektligj paraqitet për opinion, si dhe duke paraqitur shqetësimet e saj në takime të</p>

	<p>ndryshme, dhe arsytet për nevojën e ndryshimit të legjislacionit në fuqi.</p> <p>Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk e ka parë të nevojshme të propozojë ndryshime të tjera ligjore gjatë vitit 2023, pasi propozimet e vitit 2022 nuk janë pasqyruar ende në legjislacionin në fuqi.</p>
1.2.7	<p><i>Finalizimi i rishikimit të kuadrit ligjor të lidhur me qeverisjen e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLP-në (konsultimi dhe miratimi i akteve).</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë i Prokurorisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Për vitin 2023 Këshilli i Lartë i Prokurorisë miratoi 7 akte nënligjore (shih masën 1.2.5). Zbatimi i masës do të vijojë gjatë periudhave të tjera raportuese.</p>
1.2.8	<p><i>Rishikimi dhe konsolidimi i rregullave të brendshme të KLP-së.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë i Prokurorisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>“Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të KLP-së” është miratuar me Vendimin e KLP-së nr. 407, datë 17.12.2021.</p> <p>Me vendimin Nr.405, datë 28.12.2023 është miratuar Rregullorja "Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë".</p> <p>Me miratimin e kësaj Rregulloreje Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka rregulluar të gjithë aspektet e organizimit të brendshëm të institucionit.</p>
1.2.9	<p><i>Përgatitja e analizës së zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me ILD-në.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Kjo masë është zbatuar në vitet 2021 dhe 2022 duke kryer disa analiza mbi kuadrin ligjor dhe mbi zbatimin e reformës nga ILD. Bazuar në këtë analizë, ILD ka miratuar të gjitha rregullat e brendshme, aktet nënligjore dhe metodologjitë dhe ka dorëzuar propozime për ndryshime të legjislacionit për vitin 2022.</p>
1.2.10	<p><i>Përgatitja e përgjigjes mbi analizën e rishikimit të ligjit mbi statusin dhe strukturën qeverisëse të ILD-së (draft-propozimet ligjore).</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Projektpropozimet për ndryshimin e ligjit janë ende në pritje në Kuvend. Risi është Vendimi i Kuvendit për ndryshime strukturore të Zyrës së ILD-së (shih më poshtë).</p> <p>Kjo masë është realizuar plotësisht nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi pranë autoriteteve kompetente janë depozituar ndryshimet ligjore për të cilat priten zhvillimet e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e tyre.</p> <p>Krahas propozimeve ligjore, referuar analizës së punës, me qëllim realizimin e detyrimeve e kompetencave kushtetuese dhe mbarëvajtjen e punës në institucion, u vlerësua i nevojshëm propozimi i ndryshimeve në strukturën organizative e cila hyri në fuqi prej datës 23.03.2023 me vendimin nr.10/2023, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e kuvendit nr.28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, gjatë vitit 2023 ka vijuar me procedurat ligjore për plotësimin e vendeve vakante të krijuara dhe atyre që rezultuan nga ristrukturimi. Detaje të mëtejshme lidhur me procedurat për</p>

	plotësimin e vendeve vakante, gjenden të përcaktuara në të dhënat për masën 1.3.2.
1.2.11	<p>Rishikimi dhe konsolidimi i rregullave të brendshme të ILD-së. (pz 2021-2025)</p> <p>Institucioni raportues: Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p>Informacion mbi zbatimin e masës:</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë raporton se gjatë 2023 ka miratuar 28 urdhëra dhe vendime me karakter administrativ.</p>
1.2.12	<p>Përgatitja e një plani operacional të ILD-së për trajtimin e ankesave të prapambetura. (pz 2021-2025)</p> <p>Institucioni raportues: Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p>Informacion mbi zbatimin e masës:</p> <p>Në vitin 2022, ILD përfundoi 534 ankesa të prapambetura të insitucioneve të mëparshme. Për periudhën janar-dhjetor 2023, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka trajtuar të gjitha ankesat e mbetura (1072) duke mbyllur kështu trajtimin e ankesave të trashëguar nga insitucionet e mëparshme.</p> <p>Krahasimi i ankesave të përfunduara në vitin 2022 (534) në 2023 (1072) tregon rezultate efikasitet më të lartë në vitin 2023.</p>


Për OS 1.2 janë përcaktuar dy tregues performance:

Numri i akteve nënligjore të miratuara në lidhje me kompetencat, efikasitetin dhe koordinimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (vlera të ndara për KLGJ/KLP/ILD).

Pasaporta e treguesve përcakton si vlera të synuara për këtë tregues 6 akte rregullatore që lidhen me kompetencën, efikasitetin dhe koordinimin për KLGJ-në, 4 akte për KLP-në dhe 2 akte për ILD-në.

Në zbatim të nenit 94, pika 4 të ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, sipas të cilit Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregullat standarde për funksionimin e brendshëm të gjykatave, KLGJ ka miratuar në total 27 akte nënligjore nga të cilat 1 vendim lidhet me “Miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”; 26 aktet e tjera lidhen me zbatimin e riorganizimit të gjykatave. Deri në fund të vitit 2023, ILD raportoi se kishte miratuar 28 akte (urdhëra të natyrës administrative), ndërsa KLP raportoi 7 akte.

Akte nënligjore të miratuara nga institucionet e drejtësisë (2023)



Numri i propozimeve për ndryshime ligjore të bëra nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.


Në vitin 2023 ILD ka propozuar 2 ndryshime ligjore duke arritur targetin e vendosur për 2023, ndërsa KLP nuk ka propozuar asnjë ndryshim ligjor edhe pse targeti ishte 2 propozime. KLGJ ka arritur targetin dhe ka propozuar 3 ndryshime ligjore si më poshtë:

Projektligj për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Projektligj për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar.

Propozim për ndryshim në nenin 44/1 të ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"

Ndryshimet ligjore të propozuara nga institucionet e drejtësisë (2023)



Obiektivi Specifik 1.3.

Plani i Veprimit për Objektivin 1.3 parashikon parashikon pesë (5) masa, prej të cilave **3 masa janë zbatuar plotësisht** dhe **2 masa janë zbatuar pjesërisht**. 60% e masave janë zbatuar plotësisht.


OS 1.3: Fuqizimi dhe konsolidimi i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me standardet Evropiane, nëpërmjet krijimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, që të kryejnë aktivitetin me pavarësi, efikasitet dhe standarde profesionale, dhe ofrimi i shërbimit të institucioneve të qeverisjes në drejtësi përmbush rregullat dhe standardet përkatëse.	
1.3.1	<p><i>Përfundimi i procedurave të emërimit, promovimit, transferimit të magistratëve të diplomuar nga Shkolla e Magistraturës.</i> (pz 2021-2025)</p> <p>Institucioni raportues: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë</p> <p>Informacion mbi zbatimin e masës:</p> <p>KLP raportoi për emërimin e 26 prokurorëve të rinj të diplomuar në SHM në qershor 2023. KLP raportoi për 28 lëvizje paralele të prokurorëve dhe 2 ngritje në detyrë në pozicion drejtuesi.</p> <p>KLJG raportoi që kanë përfunduar procedurat për emërimin dhe caktimin e magistratëve të diplomuar nga Shkolla e Magistraturës. Konkretisht në datën 19.10.2023 KLJG zhvilloi Mbledhjen Plenare në të cilën vendosi për caktimin në pozicion të 40 gjyqtarëve të emëruar, duke përmbyllur me sukses këtë proces.</p>
1.3.2	<p><i>Përfundimi i procedurave të emërimit të inspektorëve magistratë dhe jo-magjistratë pranë ILD-së si dhe përfundimi i rekrutimeve të stafit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</i> (pz 2021-2023)</p> <p>Institucioni raportues: Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p>Informacion mbi zbatimin e masës:</p> <p>Numri i punonjësve sipas strukturës së miraturar të ILD për periudhën Janar-Dhjetor 2023 është 101 punonjës, nga të cilët njësia e inspektorëve përbëhet nga 20 inspektorë (10 inspektorë magistratë dhe 10 inspektorë jo-magjistratë) dhe 81 janë pjesë e stafit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Totali i punonjësve që ushtrojnë efektivisht detyrën është 80 punonjës, nga të cilët 4 inspektorë magistratë (6 vende vakante), 6 inspektorë jo magistratë (4 vende vakante), dhe 71 punonjës të stafit (10 vende vakante). Këto shifra reflektojnë ndryshimet sipas Vendimit të Kuvendit nr.10/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr.28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organike dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.</p> <p>Ndryshimet strukturore kanë konsistuar në:</p> <p><u>Pakësimin e numrit të inspektorëve nga 26 inspektorë në 20 inspektorë</u>, kjo për shkak të vështirësisë për plotësimin e vendeve vakante gjatë 2 viteve të funksionimit të ILD-së. Përvoja e deri tanishme - bazuar në kriteret ligjore për të qenë inspektor, vakancat në rritje të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë, mungesa e interesit, thirrjet e vazhdueshme të KLJG, për komandime - ka treguar se plotësimi i numrit të përgjithshëm me 26 inspektorë, mund të mos arrihej. Po kështu edhe procedurat rekrutuese të ndjekura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, zgjasin më shumë se një vit dhe nuk garantojnë plotësimin e numrit brenda një kohe shkurtër. Të gjitha këto opsione janë vlerësuar si faktorë që ndikonin në ngadalësimin e përmbushjes së veprimtarisë hetimore.</p> <p><u>Shtimin e numrit të ndihmës inspektorëve nga 17 në 23.</u> Rritja e numrit të ndihmës inspektorëve do të krijojë mundësinë e rritjes së efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë mbështetëse për inspektorin</p>

	<p>duke krijuar mundësi që inspektori të ketë në fokus vetëm vlerësimin e veprimtarisë hetimore dhe inspektuese, për të cilën mban përgjegjësi para ligjit.</p> <p>Për periudhën Janar-Dhjetor 2023, ILD ka paraqitur 4 kërkesa për komandimin e magjistratëve si inspektorë magjistratë (2 me profil gjyqtar dhe 2 me profil prokuror). Në përfundim të afatit të kandidimit për procedurat e komandimit të magjistratëve, për vitin 2023 pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk ka patur asnjë magjistratë të komanduar.</p> <p>Për sa i takon rekrutimeve të stafit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë realizuar në total 23 emërim/rekrutime brenda strukturës së miratuar.</p>
1.3.3	<p><i>Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të inspektorëve të drejtësisë nëpërmjet trajnimeve specifike për pozicionet e punës.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Gjatë vitit 2023 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka marrë pjesë në 2 trajnime dhe 1 seminar jashtë vendit, ndërsa nëpunësit civilë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë ndjekur 41 trajnime të zhvilluara nga ASPA.</p>
1.3.4	<p><i>Përgatitja e raporteve të analizës së grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të mbartura nga institucionet e tjera, sipas objektit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Nga 1072 ankesa të mbetura për shqyrtim nga viti 2022, për periudhën Janar-Dhjetor 2023, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka trajtuar ankesat e mbetura backlog duke mbyllur kështu trajtimin e ankesave të trashëguara nga insitucionet e mëparshme.</p>
1.3.5	<p><i>Përgatitja e ndërhyrjeve të nevojshme për përmirësimin infrastrukturor dhe logjistik të ILD për pajisjen me ambiente pune/logjistikë për të gjithë numrin e punonjësve të ILD-së.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Kontrata për rikonstruksionin e objektit të ILD është nënshkruar më 30.12.2022, rikonstruksionet kanë filluar më 27.03.2023 dhe është ende në vazhdim. Bazuar në raportimin e fundit të ILD kontrata e ndërtimit Nr.1773/8 Prot., datë 31.12.2022 për zbatimin e punimeve të ndërtimit me Objekt “Rikonstruksion i godinës dhe zyrave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Tiranë” parashikohet të përfundojë në shtator 2024.</p>

Për OS 1.3 janë përcaktuar tre tregues performance:

➤ ***% e buxhetit të shtetit dedikuar organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë***

Për vitin 2023 targeti i synuar për % e buxhetit dedikuar organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë ishte 0.06% ILD, 0.089% KLGJ, 0.05% KLP. Gjatë kësaj periudhe, treguesi është realizuar në masën 70% për KLGJ pasi buxheti i dedikuar ishte 0.0625%, ndërsa për KLP treguesi është arritur në masën 94% pasi buxheti i dedikuar ishte 0.047%. Për sa i përket ILD treguesi është realizuar 46% pasi buxheti i dedikuar ishte 0.0409%..



➤ ***Përqindja e procedurave disiplinore të filluara për ankesat kundër gjyqtarëve ose prokurorëve***

Siç shpjegohet në Pasaportën e Treguesve, ky tregues mat raportin ndërmjet numrit të kërkesave për procedim disiplinor pranë Këshillave dhe numrit të vendimeve të ILD-se për fillimin e hetimeve disiplinore (shprehur në përqindje). Vlera e synuar për këtë tregues për vitin 2023 është 100%.

Gjatë periudhës së raportimit, ILD ka hetuar 25 magjistratë dhe për 6 prej tyre ka përcjellë kërkesë për procedim disiplinor pranë Këshillave. Në përqindje kjo vlerë rezulton të jetë 24%.

KLGJ raporton se për periudhën raportuese, Komisioni përkatës ka kaluar për shqyrtim në seancë plenare 4 (katër) procedura disiplinore dhe 1 (një) procedurë të mbartur nga viti i mëparshëm. Për sa më sipër, gjatë periudhës së raportimit Këshilli ka konkluduar si më poshtë:

-“Pezullimin për një afat 1-vjeçar” të 3 procedimeve disiplinore (një procedim i filluar që në vitin 2022) në ngarkim të 1 magjistrati;

- “Pezullimin e procedimit disiplinor” të 2 procedimeve disiplinore të filluara në ngarkim të 3 magjistratëve, deri në marrjen e formës së prerë të vendimeve respektive të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ndërkohë, Këshilli, lidhur me procedurat disiplinore të pezulluara më parë, ka konkluduar në 2 vendimmarrje konkretisht si më poshtë:

-Përfundimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj 1 magjistrati, pa një vendim përfundimtar;

-Për mbylljen e procedimit disiplinor të filluar ndaj 1 magjistrati, për shkak të parashkrimit të shkeljeve disiplinore të pretenduara, për të cilat ka nisur ky procedim 4%. Duke vlerësuar ecurinë në vite, ky tregues ka nevojë të rishikohet në strategjinë e re.


KLP raporton se për vitin 2023, nga ILD janë paraqitur dy propozime për fillimin e procedimit disiplinor dhe caktimi i masës së shkarkimit nga detyra për 2 prokurorë, për të cilët KLP ka vendosur pranimin e kërkesës së ILD për shkëljen disiplinore dhe dhënien e masës “shkarkim nga detyra” për të dy prokurorët. 1 rast (vendim) ka marrë formë përfundimtare, ndërsa 1 rast (vendim) është ankimuar pranë KPA, i cili ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

Duke vlerësuar ecurinë në vite, ky tregues ka nevojë të rishikohet në strategjinë e re.

➤ ***Treguesi i zgjidhjes së çështjeve të prapambetura për disiplinën e ankesave të paraqitura në ILD.***

Treguesi llogaritet si raporti midis numrit të përgjithshëm të ankesave të prapambetura disiplinore dhe numrit të ankesave të trajtuara. Për vitin 2023, ILD trajtoi 1072 ankesa nga pjesa e mbetur e backlog, duke trajtuar kështu 100% të totalit të çështjeve të trashëguara nga institucionet e mëparshme duke përmbushur kështu targetin e synuar.

ILD - Backlogu




2.2. Qëllimi i Dytë i Politikës


Forcimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me standardet kushtetuese, ligjore dhe evropiane

Qëllimi i Dytë i Politikës: 61 masa

52 masa të zbatueshme në 2023



- Plotësisht të zbatuara
- Pjesërisht të zbatuara
- Të pazbatuara



Për këtë Qëllim Politik është parashikuar një tregues:

➤ *Treguesi i zgjidhjes së çështjeve të prapambetura për Gjykatën e Lartë*

Sipas metodologjisë së përcaktuar në pasaportën e treguesve, vlera e synuar mat kohën e nevojshme për administrimin e çështjeve të prapambetura. Treguesi i njohur si “koha e disponimit DT” llogarit kohën teorike të nevojshme për zgjidhjen e çështjeve të prapambetura duke marrë parasysh numrin e çështjeve të zgjidhura gjatë vitit dhe numrin e **çështjeve të mbartura** në fund të vitit (tregues i CEPEJ)³. Objektivat e përcaktuara në pasaportën e treguesve synojnë të reduktojnë në mënyrë progresive kohën e nevojshme për administrimin e çështjeve të prapambetura. Treguesi duhet të ketë një tendencë në rënie. Prandaj, sa më e shkurtër të jetë koha e nevojshme për administrimin e çështjeve të prapambetura, aq më pozitive është performanca e gjykatës.


Duke patur parasysh numrin e madh të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë për shkak të mosfunksionimit të plotë të kësaj Gjykate gjatë viteve 2018-2022, objektivat e përcaktuara në pasaportën e treguesve për vitin 2023 janë 12 vjet (ose 4380 ditë) për çështjet civile, 6 vjet (ose 2190 ditë) për çështjet administrative, dhe 3 vjet (ose 1095 ditë) për çështjet penale.

Për vitin 2023, Gjykata e Lartë raporton një ulje të kohës së disponimit DT për çështjet penale

³ Formula e llogaritjes është: DT= Numri i çështjeve të prapambetura në fund të periudhës së raportimit/ Numri i çështjeve të zgjidhura gjatë periudhës së raportimit x 365.

në 1.3 vjet (498 ditë) krahasuar me vitin 2022 (902 ditë), kohëzgjatje e cila është gjithashu më e ulët (positive) se targeti i përcaktuar në pasaportën e indikatorëve (1095 ditë). Sa i përket çështjeve civile dhe administrative, vlera e raportuar e DT, 8.3 vjet (3020 ditë) është më e lartë (përkeqësim) se në vitin 2022, por megjithatë targeti për vitin 2023 është arritur dhe tejkaluar (3285 ditë mesatarisht për këtë kategori).

Të dhënat lidhur me trendin e DT në periudhën 2019-2023 tregohen në grafikun më poshtë. Gjykata e Lartë ka arritur të përmirësojë (ulë) DT-në shumë përtej targeteve të përcaktuara në Pasaportën e Treguesve, 3285 ditë mesatarisht për çështjet civile dhe administrative dhe 1095 ditë për çështjet penale.



Objektivi Specifik 2.1.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.1 parashikon parashikon 14 masa, prej të cilave **6 masa janë zbatuar plotësisht**, **3 masa janë zbatuar pjesërisht**, **1 masë rezulton e pazbatuar** dhe 4 masa janë të pazbatueshme (me ngjyrë të bardhë, shih metodologjinë). 75% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht.

OS 2.1: Rishikimi i kuadrit ligjor në lidhje me gjyqësorin sipas nevojës për të përmirësuar më tej aftësinë profesionale, aksesueshmërinë, transparencën dhe efijencën.	
2.1.1	<p><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme të Kodi i Procedurës Civile (KPC).</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Në Raportin Vjetor 2022, masa është raportuar si e zbatuar në vitin 2021. Në fakt në atë periudhë MD ka bërë një analizë dhe ka sugjeruar ndryshime të KPC-së të cilat janë miratuar nga Kuvendi në vitin 2021. Megjithatë është kryer një tjetër analizë në vitin 2023 mbi ndryshimet e KPC në që lidhen me efikasitetin e sistemit të drejtësisë.</p>
2.1.2	<p><i>Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme të KPC-së.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Gjatë vitit 2023 janë punuar projekt-amendamentet e reja të KPC-së në lidhje me efikasitetin e sistemit të drejtësisë. Kuvendi pritet të miratojë amendamentet.</p>
2.1.3	<p><i>Kryerja e analizës së rishikimit të funksionimit dhe zbatimit të KPC-së të ndryshuar.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Rishikimi kryhet në vazhdimësi bazuar në praktikën dhe problemet e evidentuara nga KLGJ.</p>
2.1.4	<p><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme të Kodit të Familjes (KF).</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Me shkresën nr.1822 prot., datë 17.03.2023 u kërkuar heqja e projektligjit ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Familjes’ nga Plani i Përgjithshëm Analitik që do të shqyrtohet nga Këshilli i Ministrave gjatë vitit 2023. Ministria e Drejtësisë, në vijim të problematikave të parashtruara dhe evidentuara lidhur me dispozitat e Kodit të Familjes, politikave strategjike të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe zhvillimet e jurisprudencës ndërkombëtare dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me çështjet familjare dhe të birësimit, vlerëson se është e domosdoshme kryerja e një studimi dhe analize të thelluar mbi ndërhyrjet e nevojshme në kod, duke patur në konsideratë edhe impaktin e lartë social që ai ka.</p>
2.1.5	<p><i>Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme të Kodit të Familjes (KF).</i> (pz 2021-2025)</p>

	<p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme të Kodit të Familjes do të vijojë pas kryerjes së analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme.</p>
2.1.6	<p><i>Kryerja e analizës së rishikimit të funksionimit dhe zbatimit të KF-së të ndryshuar.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Kryerja e analizës së rishikimit të funksionimit dhe zbatimit të KF-së të ndryshuar do të vijojë pas kryerjes së analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme.</p>
2.1.7	<p><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme të ligjit “Për gjykatat administrative dhe mosmarrëveshjet administrative”.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Ligji për Gjykatat Administrative dhe Mosmarrëveshjet Administrative është ndryshuar në vitin 2021 në bazë të propozimeve të MD. Megjithatë, është kryer një analizë vlerësuese e ligjit në fillim të vitit 2023 për ndryshimet e nevojshme në lidhje me efikasitetin e sistemit të drejtësisë.</p>
2.1.8	<p><i>Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme të ligjit “Për gjykatat administrative dhe mosmarrëveshjet administrative”.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Ligji për Gjykatat Administrative dhe Mosmarrëveshjet Administrative u ndryshua në vitin 2021. Megjithatë, draft-amendamentet e reja që lidhen me efikasitetin e sistemit të drejtësisë janë përpunuar gjatë periudhës raportuese.</p>
2.1.9	<p><i>Kryerja e analizës së rishikimit të funksionimit dhe zbatimit të ligjit “Për gjykatat administrative dhe mosmarrëveshjet administrative”, të ndryshuar.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Kjo masë paraqitet në vijimësi në çdo rast, në kushtet kur zbatimi i ligjit për gjykatat administrative nuk bëhet nga DPKHL(Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit), por nga gjykatat dhe subjektet e tjera për të cilat është e detyrueshme, trajtohen rregulla të njëjta dhe të barabarta, ose gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative të parashikuara në këtë ligj.</p> <p>Në çdo rast, analiza nuk mund të kryhet sipas detyrës zyrtare nga DPKHL pa administruar kërkesa apo informacione nga subjektet e zbatimit të ligjit për mënyrën e zbatimit të tij, problemet e konstatuara gjatë zbatimit në aktivitetin e përditshëm etj., të cilat nxjerrin në pah efikasitetin gjatë gjithë zbatimit dhe nevojën për të marrë masa ligjore ose administrative/praktike për adresimin e tyre.</p>
2.1.10	<p><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme të akteve nënligjore në lidhje me sistemin gjyqësor (udhëzime/urdhëra) dhe rregullave standarde për funksionimin e gjykatave.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Këshilli i Lartë Gjyqësor e konsideron të përfunduar realizimin e kësaj mase. Rregullat standarte për</p>

	<p>funksionimin e gjykatave janë miratuar. Gjithashtu konfirmohet se janë miratuar të gjitha aktet nënligjore të nevojshme si dhe rregullat standarte për funksionimin e gjykatave të riorganizuara sipas “Hartës së re gjyqësore” bazuar në raportin e vlerësimit të kryer për Hartën e re Gjyqësore.</p>
2.1.11	<p><i>Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së akteve rregullatore për funksionimin e gjykatave.</i> (pz 2021-2022)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>KLJGJ raporton për vitin 2023 që ka konsoliduar më tej paketën e akteve rregullatore për funksionimin e gjykatave me miratimin në total të 21 vendimeve, duke mbajtur në vëmendje procesin e implementimit të Hartës së Re Gjyqësore. Në kuadër të këtij procesi, për periudhën janar - dhjetor 2023, KLJGJ ka miratuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 13 vendime për fillimin e funksionimit të 13 gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, konkretisht grupi i vendimeve nr. 129 – vendimi nr. 141, të marra në datë 28.03.2023; • 2 vendime për fillimin e funksionimit të gjykatave administrative të shkallës së parë, konkretisht vendimet nr.271, dhe. 272, datë 25.05.2023 (si dhe 1 vendim -nr. 328, datë 14.06.2023 për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.271, datë 25.05.2023); • 1 vendim për përcaktimin e kategorive të gjykatave – vendim nr. 147, datë 29.03.2023; • 2 vendime për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm si dhe në gjykatat administrative të shkallës së parë – vendimet nr. 146, datë 28.03.2023 dhe nr. 286, datë 29.05.2023; <p>Gjithashtu, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit gjyqësor janë miratuar edhe vendimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nr. 445, datë 24.07.2023 "Për miratimin e formularëve standard të regjistrimit elektronik të organizatave jofitimprurëse"; • Nr. 724, datë 07.12.2023 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore".
2.1.12	<p><i>Kryerja e analizës të zbatimit të akteve rregullatore për funksionimin e gjykatave</i> (pz 2021-2025).</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Për periudhën raportuese, në kuadër të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore, KLJGJ ka marrë masa për hartimin dhe miratimin e akteve rregullatore për funksionimin e gjykatave. Në këtë mënyrë, KLJGJ mori 15 vendime për transferimin e kancelarëve të gjykatave sipas ristrukturimit dhe miratoi 14 vendime në lidhje me krijimin e komisioneve të ristrukturimit të gjykatave të ristrukturuara.</p> <p>Për sa i përket evidentimit të statusit të saj, është ende herët për të analizuar zbatimin për sa kohë që vetë harta e re është finalizuar në Korrik 2023. Kjo mund të përfundojë implementimin në vitet në vijim.</p>
2.1.13	<p><i>Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së akteve nënligjore mbi nëpunësit civilë gjyqësorë.</i> (pz 2021-2022)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>KLJGJ raporton se në vijim të konsolidimit të paketës së akteve nënligjore mbi nëpunësit civilë gjyqësorë, Këshilli gjatë vitit 2023 ka miratuar vendimet e mëposhtme:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Nr. 147, datë 29.03.2023 “Për përcaktimin e kategorive të gjykatave” • Nr. 148, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të punonjësve të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e parë”. • Nr. 149, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të punonjësve të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, pa zyra shërbimi”. • Nr. 150, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të punonjësve të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi”. • Nr. 298, datë 30.05.2023 “Për miratimin e “Rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësore dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës të Parë Tiranë”. • Nr. 299, datë 30.05.2023 “Për miratimin e “Rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësore dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës të Parë Lushnjë”. <p>Gjithashtu në ushtrim të kompetencave të tij lidhur me administrimin e gjykatave dhe ndjekjes së çështjeve të burimeve njerëzore në gjykata, Këshilli ka miratuar edhe aktet rregullatore si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nr. 151, datë 29.03.2023 “Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm” • Nr.300, datë 30.05.2023 “Për caktimin e numrit të pozicioneve të punës së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë” • Nr.301, datë 30.05.2023 “Për caktimin e numrit të pozicioneve të punës së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”. • Nr. 444, datë 24.07.2023 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave për administratën gjyqësore”
2.1.14	<p><u>Kryerja e analizës të zbatimit të kuadrit ligjor të lidhur me nëpunësit civilë gjyqësorë.</u> (pz 2024-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Masa fillon zbatueshmerine ne 2024.</p>

Për OS 2.1 është përcaktuar një tregues performance:

➤ ***% e akteve ligjore dhe nënligjore që i janë nënshtruar analizës së vlerësimit nga organet gjyqësore.***

Për periudhën raportuese 2023, KLGJ raportoi se 23 akte nënligjore i janë nënshtruar një analize vlerësimi. KLGJ saktësoi se këto janë aktet nënligjore që lidhen me zbatimin e Hartës së re Gjyqësore dhe se 100% e akteve i janë nënshtruar analizës së vlerësimit, pra targeti i përcaktuar në Pasaportën e Indikatorëve është arritur.

Objektivi Specifik 2.2.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.2 parashikon 6 masa, prej të cilave **2 masa janë zbatuar plotësisht**, 2 masa janë zbatuar pjesërisht, dhe 2 masa janë të pazbatueshme (me ngjyrë të bardhë, shih metodologjinë). 50% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht.

OS 2.2: Fuqizimi institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese (GJK), sigurimi i burimeve të përshtatshme dhe funksionimi i saj profesional, në mënyrë transparente dhe efektive.	
2.2.1	<p><i>Kryerja e analizës mbi vendet vakante në GJK, hapja e thirrjeve dhe plotësimi i vakancave.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Gjykata Kushtetuese</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Gjatë vitit 2022, në Gjykatën Kushtetuese u plotësuan të tre vendet vakante për gjyqtarë. Ndaj kjo masë konsiderohet e zbatuar edhe për 2023.</p>
2.2.2	<p><i>Hartimi, publikimi dhe shpërndarja e raporteve të monitorimit për zbatimin e metodologjisë së re për vlerësimin e nevojave për trajnimet e gjyqtarëve.</i> (pz 2022-2024)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Gjykata Kushtetuese</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>E pazbatueshme.</p>
2.2.3	<p><i>Përmirësimi infrastrukturor / logjistik i Gjykatës Kushtetuese bazuar në gjetjet e analizës.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Gjykata Kushtetuese</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Gjatë periudhës raportuese, instucioni ka kryer përmirësime të ambjenteve të brendshme në vlerën 748.800 mijë lekë, dhe ka blerë pajisje zyre në vlerën 1.161.000 mijë lekë.</p>
2.2.4	<p><i>Kryerja e një studimi dhe specifikimi i kërkesave të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me teknologjinë e informacionit, duke përfshirë regjistrin online dhe menaxhimin e çështjeve, arkivimin elektronik, nevojën për staf të specializuar etj.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Gjykata Kushtetuese</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>GJK raporton se nevojat në lidhje me sigurimin e një sistemi elektronik funksional për menaxhimin e çështjeve, përmirësimin e kapaciteteve profesionale të stafit dhe arkivës elektronike, parashikohen në Strategjinë e GJK 2021-2023 (fq.52, objektivi specifik 1.2), dhe është detajuar edhe në Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë (fq. 57-58). Për periudhën në fjalë, pas procedurave të prokurimit janë lidhur këto kontrata:</p> <ol style="list-style-type: none">1. “Auditimi dhe vlerësimi i funksionaliteteve dhe sigurisë së sistemeve dhe infrastrukturës IT” me operatorin ekonomik “INET” sh.p.k, me vlerën e kontratës 3 799 200 (tre milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekë me TVSH. .2. “Mbështetje e mirëmbajtjes dhe përditësimit në sistemin e menaxhimit të çështjeve”, me operatorin ekonomik “ARK IT” sh.p.k, me shumën e kontratës 420 000 (katërqind e njëzet mijë) lekë me TVSH.
2.2.5	<p><i>Blerja e hardware dhe software për Gjykatën Kushtetuese.</i> (pz 2021-2025)</p>

	<p><u>Institucioni raportues:</u> Gjykata Kushtetuese</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Për periudhën në fjalë pas procedurave të prokurimit është lidhur kontrata me objekt: “Blerje e pajisjeve kompjuterike për vitin 2023”, me operatorin ekonomik “ATOM” sh.p.k., me vlerën e kontratës prej 3,906,000 (tremilion e nëntëqind e gjashtëmijë) lekë me T.V.SH.</p>
2.2.6	<p><i>Përgatitja, publikimi dhe shpërndarja e raporteve të monitorimit të zbatimit të metodologjisë së re për vlerësimin e trajnerëve.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Gjykata Kushtetuese</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Shih Masen 2.2.2 – institucioni raportues duhet të ishte ShM, jo GJK. Shih edhe masën 2.3.4. më poshtë.</p>

Për OS 2.2 janë përcaktuar dy tregues performance:

➤ ***% e numrit të akteve rregullatore që ka miratuar Gjykata Kushtetuese në zbatim të ligjit të saj***

Vlera e synuar për këtë tregues në vitin 2023 është 1 akt dhe Gjykata Kushtetuese ka miratuar gjatë vitit 2023 në zbatim të ligjit të saj organik gjithsej 18 akte. Vlera e targetit është arritur dhe tejkaluar.

➤ ***Raporti i çështjeve të mbartura nga Gjykata Kushtetuese (%)***

Ky tregues me bazë vjetore mat raportin midis numrit të çështjeve të pazgjidhura në fund të vitit raportues dhe numrit total të çështjeve në atë vit në Gjykatën Kushtetuese (d.m.th., çështjet në pritje nga viti 2022 + çështjet e regjistruara gjatë vitit 2023).


Objektivat e përcaktuara në pasaportën e treguesve synojnë të ulin peshën e çështjeve në pritje nga 68% në vitin 2020, në 30% në 2025.

Në vitin 2023 janë paraqitur dhe regjistruar 367 kërkesa të reja pranë Gjykatës Kushtetuese ndërsa 85 kërkesa janë mbartur nga viti 2022. Gjykata Kushtetuese raporton gjithashtu se ka perfunduar 353

çështje, ndërsa 39 kërkesa janë në shqyrtim në seancë plenare dhe 54 kërkesa janë në fazën e shqyrtimit paraprak. Targeti i vendosur në Pasaportën e Indikatorëve është një raport prej 40% i cili është arritur dhe tejkaluar për periudhën raportuese në të cilën rezulton se raporti i çështjeve të mbartura nga Gjykata Kushtetuese është 21%. Grafiku tregon ecurinë e zgjidhjes së çështjeve në vitin 2023.

Çështjet në Gjykatën Kushtetuese në 2023

- Të zgjidhura gjatë vitit
- Të papërfunduara në fund të vitit



Objektivi Specifik 2.3.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.3 parashikon 15 masa, prej të cilave **12 masa janë zbatuar plotësisht**, 1 masë është zbatuar pjesërisht, **1 masë rezulton e pazbatuar** dhe 1 masë rezulton e pazbatueshme (me ngjyrë të bardhë, shih metodologjinë). 85.7% e masave (të zbatueshme) janë plotësisht të zbatuara.

OS 2.3: Rritja e efikasitetit dhe aftësisë profesionale të sistemit të trajnimit i cili siguron avancimin drejt praktikave evropiane dhe cilësisë në fushën e drejtësisë duke siguruar një numër të përshtatshëm të magjistratëve dhe këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë të trajnuar për sistemin e drejtësisë në Shqipëri.	
2.3.1	<p><i>Kryerja e analizës së përputhshmërisë së metodologjisë për vlerësimin e nevojave për trajnim me standardet evropiane. (pz 2021-2025)</i></p> <p>Institucioni raportues: Shkolla e Magjistraturës</p> <p>Informacion mbi zbatimin e masës:</p> <p>Shkolla e Magjistraturës përmbylli në vitin 2023 një proces të gjatë analize të ecurisë së punës dhe nevojave për përmirësim në Programin e Formimit Vazhdues, duke nisur nga kontrolli mbi efencën, praktikitetin dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të metodologjisë që ndiqet për analizën e nevojave për trajnim. Nga analiza u evidentua nevoja rritjen e bashkepunimit me gjykatat dhe prokurorite e vendit.</p>
2.3.2	<p><i>Përgatitja e metodologjisë së re për vlerësimin e nevojave për trajnim bazuar në rezultatet e analizës së përputhshmërisë. (pz 2021-2025)</i></p> <p>Institucioni raportues: Shkolla e Magjistraturës</p> <p>Informacion mbi zbatimin e masës:</p> <p>Në vitet e fundit, Shkolla e Magjistratures ka kryer në bazë vjetore analizën e nevojave për trajnim, e cila fillon në periudhën janar-mars dhe përfundon në shtator-tetor, që përkon me fillimin e vitit të ri akademik në të cilin do të zhvillohen trajnimet. Analiza merr parasysh burime të ndryshme si plane strategjike kombëtare të institucioneve, raporte ndërkombëtare, dhe kërkesat e magjistratëve dhe subjekteve të tjera që trajnohen.</p> <p>Shkolla e Magjistratures përmirësoi metodologjinë e vlerësimit të nevojave për trajnim përmes kërkimit, analizës së gjetjeve dhe propozimeve konkrete për orientimin e moduleve të trajnimit drejt specializimit, si edhe për orientimin e moduleve lidhur me subjektin që do të trajnohet. Sipas kësaj metodologjie u konkludua se është e nevojshme të ketë: a) module trajnimi për magjistratët që kanë deri në 5 vite pune në sistem, b) module trajnimi të thelluara/specializuara në tema specifike të rëndësishme për punën e magjistratit, dhe c) module trajnimi për kategoritë e tjera të subjekteve që trajnohen nga SHM.</p>
2.3.3	<p><i>Përgatitja, publikimi dhe shpërndarja e raporteve të monitorimit të zbatimit të metodologjisë së re për vlerësimin e nevojave për trajnim. (pz 2022-2024)</i></p> <p>Institucioni raportues: Shkolla e Magjistraturës</p> <p>Informacion mbi zbatimin e masës:</p> <p>Në vitet e fundit, Shkolla e Magjistraturës ka kryer në bazë vjetore analizën e nevojave për trajnim, e cila fillon në periudhën janar-mars dhe përfundon në shtator-tetor, që përkon me fillimin e vitit të ri akademik në të cilin do të zhvillohen trajnimet. Analiza merr parasysh burime të ndryshme si plane strategjike kombëtare të institucioneve, raporte ndërkombëtare, dhe kërkesat e magjistratëve dhe subjekteve të tjera që trajnohen.</p>

	<p>Shkolla e Magjistraturës është duke hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të metodologjise së re për vlerësimin e nevojave për trajnim. Shpërndarja e raporteve do të realizohet gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2024, moment që përkon edhe me realizimin e aktiviteteve trajnuese dhe kontaktin e drejtperdrejtë me përfituesit e trajnimit.</p>
2.3.4	<p><i>Kryerja e analizës së përputhshmërisë së metodologjisë për vlerësimin e trajnerëve me standardet evropiane.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Shkolla analizoi në mënyrë tërësore çështjet e rekrutimit të trajnerëve dhe vlerësimit të tyre në funksion të rritjes së cilësisë së trajnimit dhe llogaridhënies. Ky proces u realizua së bashku me përcaktimin e drejtimeve strategjike të Shkolles për 4 vjecarin e ardhshëm 2024-2028.</p> <p>Vlerësimi i trajnerëve bëhet bazuar në Rregulloren e Shkollës së Magjistraturës. Standardi bazë është ai i kërkuar për trajnerët nga EJTN (Rrjeti i trajnimit gjyqësor në Europë) i shtjelluar në dokumentet: “EJTN Handbook on Judicial Training Methodology in Europe” dhe “Judicial Training Methods Guidelines for Evaluation of Judicial Training Practices”. Deri më tani nuk është vlerësuar se duhet të ketë ndërhyrje në legjislacionin parësor apo dytësor në këtë komponent.</p>
2.3.5	<p><i>Përgatitja e metodologjisë së re për vlerësimin e trajnerëve bazuar në rezultatet e analizës së përputhshmërisë.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Analiza e nevojave për përmirësim të metodologjisë së vlerësimit të trajnerëve tregoi nevojën për rishikim të akteve të brendshme që rregullojnë procesin e vlerësimit, publicitetin e tij, etj. Metodologjia e vlerësimit është ende në proces përgatitje nga SHM.</p>
2.3.6	<p><i>Përgatitja, publikimi dhe shpërndarja e raporteve të monitorimit të zbatimit të metodologjisë së re për vlerësimin e trajnerëve.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><u>Përmbledhja e veprimeve:</u></p> <p>Se bashku me zbatimin e metodologjise se re do te realizohet edhe monitorimi i këtij procesi përmes raporteve, të cilet janë duke u përgatitur nga ana e Shkollës.</p> <p>Zbatimi i kësaj mase do te vijojë në periudhat e tjera raportuese.</p>
2.3.7	<p><i>Kryerja e analizës së përputhshmërisë së metodologjisë së trajnimit të vazhdueshëm me standardet evropiane.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Në vitin 2022 Shkolla e Magjistraturës ndërmori një proces të gjatë analize të metodologjisë së trajnimeve në mënyrë që ato të jenë sa më të dobishme për përfituesit e tyre dhe të rrisin cilësinë e gjyqësorit, duke mbajtur në konsideratë nevojën e shtuar për trajnim të magjistrateve të rinj që i janë bashkuar sistemit të drejtësisë.</p> <p>Ky proces do të përsëritet sërish nëse të vlerësohet e përshtatshme nga Shkolla dhe nëse do të ketë zhvillime në standarde apo praktika të institucioneve homologe, me qëllim përmirësimin e kësaj metodologjie.</p>

2.3.8	<p><i>Përgatitja dhe unifikimi i metodologjisë së re për trajnimin e vazhdues bazuar në rezultatet e analizës së përputhshmërisë. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Shkolla ka realizuar Programin e Formimit Vazhdues sipas metodologjise se dakordësuar dhe ka trajnuar edhe trajnerët e rinj me qëllim unifikimin në zbatimin e saj. Në datë 18 tetor 2023, në nisje të vitit të ri akademik, Shkolla realizoi trajnim të eksperteve dhe lehtësuesve të rinj që u miratuan për realizimin e Programit të Formimit Vazhdues në Shkollë për vitin akademik 2023-2024.</p>
2.3.9	<p><i>Përgatitja, publikimi dhe shpërndarja e raporteve të monitorimit të zbatimit të metodologjisë së re për trajnimin vazhdues. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Shkolla ka monitoruar gjithë procesin e trajnimit, përfshirë edhe çështje të zbatimit të metodologjisë së trajnimit vazhdues nga ana e trajnerëve dhe ka raporte vlerësimi për çdo aktivitet trajnues. Raportet e vlerësimit nuk janë publikuar apo shpërndare ende. Mbi ecurine e zbatimit të masës do raportohet në periudhën tjetër raportuese.</p>
2.3.10	<p><i>Kryerja e analizës për nevojën për rishikim të programeve të trajnimit vazhdues. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Shkolla ka realizuar procesin e analizes së nevojave për rishikim të programit të formimit vazhdues, proces që ka nisur prej muajit shkurt 2023. Ky proces ka identifikuar nevojën për hartim të një programi tematik të ri, me komponentë edhe më të strukturuar.</p>
2.3.11	<p><i>Përgatitja e programeve të formimit vazhdues në përputhje me standardet evropiane. (pz 2022-2022)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><u>Përmbledhja e veprimeve:</u></p> <p>Shkolla përpiloi në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023 draft programin tematik të formimit vazhdues. Ky program u rishikua në funksion të analizës së bëre për përmirësim të metodologjisë së trajnimeve vazhduese dhe në kalendarin e aktiviteteve të vitit akademik 2023-2024 u përfshinë dy module të reja, me qëllim pilotimi: modul i veçantë për prokurimin publik dhe modul i veçantë për provat në procesin gjyqësor civil. Përgatitja e programeve të formimit vazhdues në përputhje me standardet evropiane", është miratuar nga Këshilli Drejtues, në shtator 2023, Programi i ri i Trajnimit Vazhdues.</p>
2.3.12	<p><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme të ligjit “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloret e saj. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë; Shkolla e Magjistraturës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Shkolla ka dhënë kontributin e saj në analizën që MD po i bën ligjit të organeve të qeverisjes dhe ligjit të statusit të magjistratëve në Shqipëri.</p>
2.3.13	<p><i>Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme të ligjit “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloret e saj. (pz 2022-2022)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p>

	<p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Funksionimi i Shkollës së Magjistraturës rregullohet nga Ligji Nr. 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”. Një grup pune ne kuvend po diskuton të gjitha propozimet për ndryshimet e ligjeve të reformës. Referuar diskutimit me DPKHL, masa nuk duhet të ketë si institucion përgjegjes Ministrinë e Drejtësisë dhe duhet të ketë një riformulim të përmbajtjes së saj në momentin e rishikimit të strategjisë.</p>
2.3.14	<p><i>Përgatitja dhe miratimi i metodologjisë së studimeve dhe botimeve të Shkollës së Magjistraturës në përputhje me standardet evropiane. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>ShM miratoi në Rregulloren e Brendshme të saj realizimin e dy aktiviteteve te reja: 1. Transkriptimi i trajnimeve vazhduese me qëllim hartimin në menyre periodike të Buletineve, të cilët do të përmbajnë, në mënyrë të strukturuar çështjet kryesore të trajtuara në këto aktivitete dhe do të shpërndahet për magjistratët në sistem, por edhe për këdo subjekt të interesuar; 2. Forumi profesional i Shkolles së Magjistraturës, si një hapësire e re diskutimi mbi çështje të rëndësishme të së drejtes, mes magjistrateve, aktoreve të tjerë të sistemit të drejtësisë dhe cdo studiuesi të së drejtës i cili ka interes. SHM ka bërë ndryshime në rregulloren e botimeve dhe ka rritur stafin administrativ dhe akademik që ndjek këtë proces. Publikimet dhe puna kërkimore do të vazhdojnë të jenë veprimtari e rëndësishme e Shkollës për të mbështetur por dhe pasqyruar veprimtaritë akademike të Formimit Fillestar dhe Formimit të Vazhduar. Në përmbushje të objektivit të Shkollës për zhvillim të mëtejshëm të kërkimit shkencor dhe publikimit janë ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm organizativë me qëllim forcimin e kapaciteteve në Sektorin e Studimeve dhe Publikimeve. Kështu, në këtë sektor është plotësuar pozicioni i Këshilltarit për Botimet dhe Publikimet Shkencore dhe është hapur nje pozicion i ri pune "Sekretar per publikimet", i cili do të realizoje transkriptimin e aktiviteteve te formimit fillestar dhe vazhdues ne Shkolle pas nje analize nevojash paraprake. Ne rregulloren e shkolles është shtuar nje dispozite e re qe krijon nje hapësire te re kerkimi me magjistratet qe kane perfunduar vitin e dyte ne Programin e Formimit Fillestar.</p>
2.3.15	<p><i>Krijimi i bazës së të dhënave të lektorëve dhe trajnerëve të Shkollës së Magjistraturës, që kanë njohuri mbi ligjin e BE-së. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><u>Përmbledhja e veprimeve:</u></p> <p>Masa është raportuar si plotësisht e realizuar në vitin 2022.</p>

Për OS 2.3 është përcaktuar një tregues performance:

➤ ***Kuotat vjetore të kandidatëve magjistratë, këshilltarëve dhe ndihmësve në Shkollën e Magjistraturës***

Vlerat e synuara të treguesit për vitin 2023 janë si më poshtë: 100 kandidatë nga KLGJ dhe 30 kandidatë nga KLP. Për vitin akademik 2023-2024 në SHM, KLGJ miratoi një kuotë prej 55 kandidatësh (40 kandidatë për gjyqtarë dhe 15 kandidatë për ndihmës juridikë) dhe KLP miratoi një kuotë prej 40 kandidatësh. Edhe nëse targeti nuk është arritur, kuotat e përcaktuara nga Këshillat bazohen në një analizë të argumentuar të nevojave të sistemit dhe kapacitetit të SHM.

Objektivi Specifik 2.4.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.4 parashikon parashikon 9 masa, prej të cilave **3 masa janë zbatuar plotësisht**, 5 masa janë zbatuar pjesërisht, dhe **1 masë është e pazbatuar**. 37.5% e masave janë zbatuar plotësisht.

OS 2.4: Përmirësimi i sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, duke përfshirë GJL-në, dhe sigurimi i ofrimit të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme për qytetarët.	
2.4.1	<p><i>Përgatitja dhe miratimi i studimeve të fizibilitetit të infrastrukturës së gjykatave. (2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>KLJGJ raporton se bazuar në kompetencat e saj, për çdo vit buxhetor, evidenton dhe vlerëson nevojat e infrastrukturës ndërtimore për të gjithë sistemin gjyqësor. Nisur nga këto nevoja të evidentuara, deri tani KLJGJ ka përfunduar dokumentin e “Detyrës së Projektimit”, për ndërtimin e godinës së re për Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (në një godinë së bashku), duke përmbyllur fazën e parë në mbështetje të hartimit të projektit të zbatimit. Pas miratimit të buxhetit, KLJGJ ka detajuar fonde në artikullin “Studime projektive”, me qëllim hartimin e “Projekteve të Zbatimit” për godinat e reja të gjykatave.</p> <p>Gjatë gjithë kësaj periudhe, KLJGJ i është drejtuar disa herë zyrtarisht Bashkisë Tiranë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Ministrave, për mundësinë e vënies në dispozicion të shesheve të ndërtimit (truallit) si një kusht i domosdoshëm për fillimin e procedurave të hartimit të dokumentit të “Projekteve të Zbatimit” por nuk ka patur një përgjigje. Mos miratimi i shesheve të ndërtimit është faktor pengues për të vijuar me realizimin e procedurave të tjera.</p>
2.4.2	<p><i>Kryerja e vlerësimeve të qëndrueshme, të pavarura dhe gjithëpërfshirëse të gjykatave, për të matur performancën kundrejt standardeve të përcaktuara. (pz 2021-2025).</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>KLJGJ raporton se zbaton vendimin me nr. 25, datë 07.02.2019, “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”, sipas të cilës çdo 3 muaj KLJGJ mbledh të dhëna statistikore të raportuara nga kryetarët e gjykatave mbi veprimtarinë e gjykatave. Për periudhën e raportimit, janë mbledhur 3 analiza statistikore dhe analiza e tremujorit të katërt për vitin 2023 mblidhet në fillim të vitit 2024. Këto të dhëna administrohen dhe përdoren nga KLJGJ me qëllim për të orientuar punën e Këshillit për mirëadministrimin e gjykatave.</p> <p>Njëkohësisht, sipas vendimit nr. 47, datë 11.02.2021 “Për miratimin e udhëzuesit “Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave”, KLJGJ mbledh të dhëna statistikore nga gjykatat në lidhje me performancën e tyre, të cilat më pas analizohen, raportohen në Kuvend dhe publikohen në “Raportin Vjetor të KLJGJ” për vitin përkatës.</p>
2.4.3	<p><i>Kryerja e analizës mbi nivelin e zbatimit të standardeve, kodit të etikës dhe raportimi publik mbi gjetjet. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor.</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>KLJGJ raporton se në përputhje me parashikimet ligjore, në muajin shkurt të vitit 2023, Këshilltari</p>

	<p>për Etikën ka raportuar pranë KLGJ mendimet dhe opinionet mbi ushtrimin e funksionit nga ana e gjyqtarëve dhe më tej Këshilli ka miratuar “Raportin vjetor mbi veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën për vitin 2022”. Këshilltari për Etikën raporton pranë KLGJ çdo vit dhe raporti për vitin 2023 miratohet në vitin 2024. Gjithashtu përgjatë periudhës së raportimit janar - dhjetor 2023, KLGJ sipas detyrimit ligjor, ka kryer Raportimin Vjetor në Kuvend mbi analizën e sistemit gjyqësor për vitin 2022. Ky raportim kryhet një herë në vit. Për këtë KLGJ mbledh të dhëna dhe informacione në mënyrë të vazhdueshme për raportin e vitit pasardhës. Konkretisht për vitin 2023, raporti do të miratohet në fillim të vitit 2024 ndërsa analiza mbi nivelin e zbatimeve të standardeve të kodit të etikës është e nevojshme të kryhet në periudhën në vijim.</p>
2.4.4	<p><i>Miratimi dhe zbatimi i hartës së re gjyqësore.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës :</u></p> <p>KLGJ raporton se ka përmbyllur me sukses tre fazat e implementimit të Hartës së Re Gjyqësore. Konkretisht për periudhën e raportimit, më datë 01.02.2023 ka nisur funksionimin Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Më datë 01.05.2023 kanë nisur funksionimin 13 Gjykatat e shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe më datë 01.07.2023 kanë nisur funksionimin 2 Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë me kompetenca tokësore në Tiranë dhe Lushnje.</p> <p>Më tej, pas implementimit të "Hartës së Re Gjyqësore", me qëllim uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata, nëpërmjet Urdhrit nr. 42, datë 20.07.2023, KLGJ ngriti “Grupin e Punës për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata”. Ky grup pune zhvilloi mbledhjen e parë në datën 26 korrik 2023 dhe po punon për të hartuar një strategji të mirëfillte dhe një plan veprimi me masa konkrete duke nisur me vlerësimin e situatës dhe hartimin e propozimit për standardet minimale të afatit për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore, nevojën për caktimin e standardeve sasiore dhe hartimin e propozimit mbi normën e likuidimit të çështjeve për gjyqtar, numrin e nevojshëm të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit si dhe numrin e nevojshëm për ndihmës ligjor në gjykata. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2023, Grupi i Punës ka realizuar disa takime si dhe ka propozuar tre ndryshime ligjore të rëndësishme në Kodin e Procedurës Civile dhe Ligjin për Gjykatat Administrative, me qëllim thjeshtimin e procesit gjyqësor dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjeve gjyqësore. KLGJ angazhohet për të miratuar Strategjinë që do të propozohet nga Grupi i Punës për uljen e backlogut në gjykata.</p>
2.4.5	<p><i>Ndërtimi i godinës së re të Gjykatës së Apelit, Tiranë, dhe ngritja e kapaciteteve të stafit të gjykatave.</i> (pz 2024-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><u>Përmbledhja e veprimeve:</u></p> <p>Për periudhën e raportimit, KLGJ në bashkëpunim me specialistët e Bashkisë Tiranë ka hartuar dokumentin e “Detyrës së Projektimit” si faza fillestare për hartimin e “Projektit të Zbatimit” për godinën e re të këtyre gjykatave, por ky proces nuk ka vazhduar më tej pasi nuk është miratuar ende sheshi i ndërtimit. Gjithashtu KLGJ është angazhuar dhe ka kryer vlerësime në terma të përgjithshme të gjendjes së infrastrukturës ndërtimore të gjykatave dhe ka parashikuar që brenda periudhës 2026-2027 nisjen e investimeve për rikonstruksione në infrastrukturën e Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.</p>
2.4.6	<p><i>Kryerja e analizës dhe përgatitja e raporteve të monitorimit mbi zbatimin e dokumenteve strategjike të komunikimit nga KLGJ-ja.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>KLGJ raporton se me anë të vendimit nr. 454 datë 02.11.2022 Këshilli miratoi "Planin e</p>

	<p>Komunikimit për Gjykatat" shoqëruar me një "Plan veprimi" konkret. Për periudhën e raportimit, KLGJ ka kryer monitorimin periodik të zbatimit të këtij plani nga ana e gjykatave, të cilat në mbështetje të pikës 3 të vendimit të sipërcituar, pika e kontaktit për secilën gjykatë respektive ka dërguar raportet duke ndjekur veprime konkrete për realizimin e 6 objektivave strategjikë të parashikuar në këtë Plan.</p> <p>Gjithashtu, KLGJ raporton se ka miratuar një tjetër instrument të rëndësishëm me anë të vendimit Nr. 716, Datë 06.12.2023 "Udhëzuesin Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median", i cili synon rritjen e transparencës, të besimit të publikut dhe të kuptueshmërisë nga publiku dhe media të veprimtarisë gjyqësore, nëpërmjet standardizimit të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median.</p>
2.4.7	<p><i>Workshop-e/tryeza teknike periodike me titullarët e institucioneve (KLGJ/KLP/PP), për rritje të bashkëpunimit ndërinstitucional.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Në kuadër të hartimit dhe konsolidimit të dokumentit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 21-25, Ministria e Drejtësisë vlerësoi se përfshirja e institucioneve të reja të drejtësisë do të ndikonte në rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe angazhimit në çdo proces vendimarrës në përgjithësi si dhe në veçanti atë të Reformës në Drejtësi.</p> <p>Institucionet kanë bashkëpunuar në mënyre të ngushtë me qëllim konsolidimin e këtij procesi të rëndësishëm, por për vitin 2023 nuk janë organizuar tryeza teknike për bashkëpunimin ndërinstitucional.</p>
2.4.8	<p><i>Krijimi i infrastrukturës për të ngritur një njësi për pritjen e publikut pranë ILD-së.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Në projektin për rikonstrukcionin e Godinës së ILD-së është parashikuar infrastruktura përkatëse për pritjen e publikut dhe ankesave, sipas standardeve përkatëse. Me përfundimin e punimeve në objekt dhe marrjen në dorëzim, kjo infrastrukturë do të jetë disponibël për pritjen e publikut pranë ILD-së. Megjithatë gjatë kësaj periudhe Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun pret çdo qytetar që paraqitet pranë ambienteve të institucionit si dhe ka vënë në dispozicion një numër kontakti me qëllim sqarimin, orientimin e publikut si dhe adresimin e ankesave të tyre.</p>
2.4.9	<p><i>Ngritja e kapaciteteve të ILD-së për ofrimin e ndihmës/këshillime me publikun për plotësimin e formularit të ankesave.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Për sa i takon periudhës së raportimit 2023, ILD raporton se është fokusuar në lehtësimin e procesit të ankimit i cili mbetet një prioritet konstant i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. ILD është përpjekur në vazhdimësi të qartësojë këtë proces, përmes publikimit të materialeve informuese në faqen zyrtare.</p> <p>Duke patur në vëmendje të posaçme marrëdhënien me qytetarët, si një mënyrë për t'u përmirësuar dhe për të rritur besimin e publikut ILD, prej disa muajsh është vendosur një mënyrë direkte komunikimi, përmes një ankete të publikuar në faqen mbi punën e institucionit. Përgjigjet e marra janë një element shumë i çmuar për të orientuar punën tonë në vazhdim.</p> <p>Bazuar në përgjigjet e marra deri tani, ILD ka vendosur të rishikojë mënyrën e informimit të</p>

qytetarëve për mënyrën sesi mund të ankohen për shkeljet e gjyqtarëve e prokurorëve.

ILD po publikon në rubrikën e ankesave pyetjet të cilat drejtohen më shpesh nga qytetarët dhe media, së bashku me përgjigjet përkatëse, për të qartësuar në mënyrë sa më shteruese gjithë procesin e ankimit pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Linku: <https://ild.al/sq/2023/02/01/3-vjet-ild-me-shume-lehtesi-per-ankuesit>

Për O.S 2.4 janë përcaktuar tre tregues performance:

➤ **% e zvogëlimit të kohëzgjatjes mesatare të një çështje penale (vlera të ndara për shkallën e parë dhe shkallën e apelit, vetëm juridiksion i përgjithshëm)**

Të dhënat për këtë tregues nuk janë raportuar nga institucioni për shkak të specifikës së mënyrës së mbledhjes së të dhënave të nevojshme për këtë analizë. KLGJ mbledh të dhënat përkatëse nga gjykata të ndryshme në baza vjetore, zakonisht në tre muajt e parë të vitit pasardhës dhe i përpunon, analizon dhe ndan publikisht ato në muajt maj-qershor.

➤ **% e zvogëlimit të kohëzgjatjes mesatare të çështjes civile në shkallën e parë dhe në apel (vlera të ndara për secilin nivel)**

Të dhënat për këtë tregues nuk janë raportuar nga institucioni për shkak të specifikës së mënyrës së mbledhjes së të dhënave të nevojshme për këtë analizë. KLGJ mbledh të dhënat përkatëse nga gjykata të ndryshme në baza vjetore, zakonisht në tre muajt e parë të vitit pasardhës dhe i përpunon, analizon dhe ndan publikisht ato në muajt maj-qershor.

➤ **% e çështjeve gjyqësore për të cilat informacioni bazë është në dispozicion në internet dhe i përditësuar.**

Ashtu si në periudhat e mëparshme të vlerësimit, edhe për vitin 2023 KLGJ ka raportuar se informacioni bazë është i disponueshëm online dhe i përditësuar. Një informacion i tillë mund të merret nga platforma online e gjykatave (www.gjykata.gov.al) nga palët dhe avokatët/përfaqësuesit e tyre. Faqja e internetit ka gjithashtu një video ilustruese se si të lundroni në faqe për të marrë informacionin e kërkuar. Kështu, targeti i synuar në Pasaportën e Indikatorëve është arritur plotësisht.

Objektivi Specifik 2.5.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.5 parashikon 17 masa, prej të cilave **12 masa janë zbatuar plotësisht**, 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 2 masa rezultojnë të pazbatueshme (me ngjyrë të bardhë, shih metodologjinë). 80% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht.

OS 2.5: Aksesi efikas në drejtësi i siguar nëpërmjet ndihmës juridike, zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe tarifave gjyqësore të përshtatshme.	
2.5.1	<p><i>Informimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve të ligjit “Për ndihmën juridike falas” për të drejtat e tyre për ndihmë dhe akses në institucione, të cilat mund të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre. (pz maj 2024 - qershor 2024)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>DNJF, çdo fillim viti (edhe për vitin 2023) ka miratuar kalendarin e planit të aktiviteteve me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, ku parashikohet realizimi i tyre për një periudhë një vjeçare, për sa i përket aktiviteteve/ fushatave ndërgjegjesuese/promovuese, mbikëqyrje operative si dhe monitorimi i ofruesve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga Drejtoria e Ndiemes Juridike Falas).</p> <p>Në kuadër të realizimit të kësaj mase, DNJF ka bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet shtetërore për informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi shërbimet e ofruara nga DNJF përmes:</p> <ol style="list-style-type: none">1. përgatitjes dhe shpërndarjes së fletëpalosjeve dhe posterave “Ke nevojë për ndihmë juridike falas”;2. përgatitjes dhe shpërndarjes së manualeve të thjeshtëzuara lidhur me kategoritë e përfituesve të shërbimeve ligjore falas, ku mund të merret shërbimi dhe ofruesit e shërbimit;3. hartimit të Buletinit Mujor (newsletter) i cili përbën një risi për institucionin”;4. zhvillimit të fushatave sensibilizuese5. zhvillimit të webinarëve me fokus promovimin/informimin mbi ndihmen juridike falas.
2.5.2	<p><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të nevojave për trajnim të DNJF-së dhe hartimi i planit/kurrikulave/ programeve të trajnimit. (pz 2021-2021)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>DNJF ka parashikuar nevojat e trajnimit të punonjësve për t’u zhvilluar në vitin 2023. Më datë 10.10.2023, DNJF, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse i ka dërguar email zyrtar ASPA-s, me objekt "Kërkese për përfshirje në programin e trajnimit për vitin 2023".</p> <p>Nëpërmjet shkresës nr. 2059/1, prot., datë 01.11.2023 me lëndë “Planifikimi i nevojave për trajnim për vitin 2024, për punonjësit e Drejtorisë së Ndiemes Juridike Falas”, është përcjellë planifikimi i trajnimeve të punonjësve të DNJF-së, në kuadër të procesit të vlerësimit të këtyre nevojave që kanë si fokus përmbushjen e detyrave funksionale, arritjen e objektivave konkrete të punës, si dhe zhvillimin personal të punonjësve.</p>
2.5.3	<p><i>Trajnimi i punonjësve të DNJF në kuadër të forcimit të kapaciteteve të për kryerjen e funksioneve të caktuara nga kuadri ligjor për ndihmën juridike. (pz 2024-2024)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p>

	<p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>DNJF në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike kryejnë trajnimin e punonjësve të rinj që rekrutohen për herë të parë, por këta punonjës me trajnim të posaçëm trajnohen në vazhdimësi të nevojave në funksion të pritjes së parë të subjekteve përfituese sipas kategorive të veçanta të parashikuara në Ligjin nr.111/2017. Gjithashtu, DNJF në përmbushje të detyrave funksionale të saj në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë kryen trajnime të avokatëve të cilët lidhin kontratë shërbimi me DNJF-në, me afat një vjeçar, për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore.</p> <p>Në periudhën raportuese DNJF ka zhvilluar trajnimin e punonjësve me trajnim të posaçëm të Qendrave të Shërbimit Parësor të Ndhmës Juridike mbi legjislacionin në lidhje me ndihmën juridike falas dhe mekanizmat e aksesit në drejtësi nga subjektet e parashikuara në ligjin nr. 111/2017.</p>
2.5.4	<p><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të nevojave për trajnim të ofruesve të Ndhmës Juridike parësore dhe hartimi i planit/ kurrikulës/ programit të trajnimit.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Nëpërmjet shkresës nr. 2059/1, prot., datë 01.11.2023 me lëndë “Planifikimi i nevojave për trajnim për vitin 2024, për punonjësit e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”, është përcjellë planifikimi i trajnimeve të punonjësve të DNJF-së, në kuadër të procesit të vlerësimit të këtyre nevojave që kanë si fokus përmbushjen e detyrave funksionale, arritjen e objektivave konkrete të punës, si dhe zhvillimin personal të punonjësve.</p>
2.5.5	<p><i>Trajnimi i ofruesve të ndihmës juridike parësore në kuadër të rritjes së cilësisë së shërbimit të ofruar.</i> (pz 2024-2024)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>DNJF në përmbushje të detyrave funksionale të saj në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike kryejnë trajnimin e punonjësve të rinj që rekrutohen për herë të parë. Gjithashtu këto punonjës me trajnim të posaçëm trajnohen sipas nevojave në funksion të pritjes së parë të subjekteve përfitues sipas kategorive të veçanta të parashikuara në Ligjin nr.111/2017.</p> <p>Specifikisht DNJF ka realizuar aktivitetet si me poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trajnim për asistencë juridike për studentët e angazhuar në Klinikat Juridike; - Praktika pune për studentët e angazhuar në Klinikat Juridike; - Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta ndërgjegjësuese/informative. <p>Gjithashtu, më datë 17 Nëntor 2023, DNJF ka realizuar trajnimin me mbështetjen e OSBE-së , mbi "Udhëzuesin për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore mbi mënyrën e komunikimit dhe pritjes së qytetarëve pjesë e kategorisë së veçantë", referuar nenit 11 të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.</p>
2.5.6	<p><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të nevojave për trajnim të avokatëve për ofrimin e ndihmës juridike dytësore falas dhe hartimi i planit/kurrikulës/programit të trajnimit.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Duke patur parasysh natyrën e ndihmës juridike dytësore e cila konsiston kryesisht në përfaqësimin gjyqësor, DNJF nuk kryen analizë të vlerësimit të nevojave për trajnim të avokatëve për ofrimin e</p>

	<p>ndihmës juridike dytësore falas si dhe hartimin e planit/kurrikulës/programit të trajnimit. Sidoqoftë DNJF në përbushje të detyrave funksionale të saj në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë sipas Ligjit nr.111/2017 Për Ndhimen Juridike të Garantuar nga Shteti, kryen trajnime të avokatëve të cilët lidhin kontratë shërbimi me DNJF-në, me afat një vjeçar, për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore falas.</p>
2.5.7	<p><i>Trajnimi i avokatëve në kuadër të rritjes së cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike falas të ofruar.</i> (pz 2024-2024)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>DNJF në përbushje të detyrave funksionale të saj në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë sipas Ligjit nr.111/2017 Per Ndhimen Juridike te Garantuar nga Shteti, kryen trajnime të avokatëve të cilët lidhin kontratë shërbimi me DNJF-në, me afat nje vjeçar, për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore falas.</p> <p>Referuar udhëzimit të përbashkët nr.17, datë 5.8.2020 “Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në emërimin e avokatëve, të cilët do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative”, kreu II, pika 22, 23, Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë organizon trajnime të veçanta për avokatët në ato fusha ku specializimi është i nevojshëm, në rast se lista e miratuar e avokatëve, që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, në juridiksionin e një dhome, nuk ka avokatë me njohuri të specializuara. Dhoma Vendore e Avokatisë emëron avokatë nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në juridiksionin e dhomës, sipas renditjes në listë, sipas përcaktimeve të pikave 19 dhe 20 të këtij udhëzimi. Për çështjet që kërkojnë njohuri të specializuara, avokatët caktohen sipas përcaktimeve të pikave 21 dhe 22 të këtij udhëzimi.</p> <p>Për vitin 2023 është zhvilluar më datë 21 Nëntor 2023, trajnimi për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore me temë “Trajnimi i trajnerëve”, për avokatët ofruet të ndihmës juridike dytësore të Dhomës Avokatisë Durrës dhe Lushnje të përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë trajnim mbi legjislacionin e ndihmës juridike dhe problemet që lidhen me zbatimin e tij.</p>
2.5.8	<p><i>Krijimi i forumit të bashkëpunimit të DNJF-së me grupe të tjera të interesit në sektorin gjyqësor dhe përgatitja e planit për funksionimin dhe zhvillimin e tij.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Kjo masë është raportuar si plotësisht e zbatuar në vitin 2021.</p>
2.5.9	<p><i>Hartimi, konsultimi dhe miratimi i planit të komunikimit të DNJF-së me grupet e tjera të interesit në sektorin gjyqësor.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Kjo masë është raportuar si plotësisht e zbatuar në vitin 2021.</p>
2.5.10	<p><i>Kryerja e analizës për praktikat më të mira evropiane në përdorim të mekanizmave për zgjidhjen alternative dhe përgatitja e propozimeve për zbatim në Shqipëri.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve (DHKN)</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Për të analizuar praktikat më të mira evropiane në lidhje me mekanizmat e ndërmjetësimit për</p>

	<p>zgjidhje alternative, DHKN mori pjesë në seminaret e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 30 qershor 2023 në tryezën e rumbullakët me ndërmjetës shqiptarë dhe 2 ndërmjetës ndërkombëtarë, pasi dhanë praktikat më të mira, në funksion të kuadrit ligjor shqiptar, ata rekomanduan: <ul style="list-style-type: none"> ○ referenca nga gjyqësori, për të patur një lirim prej tij ○ Krijimi i Komitetit Kombëtar të Ndërmjetësimit me shumë aktorë ○ ngritjen e kapaciteteve të ndërmjetësve ○ afrimi i avokatëve • Në punëtorinë/workshop e datës 3 korrik 2023, me përfaqësues nga rajoni dhe BE, pas shkëmbimit të përvojave të ndryshme, u tregua se si funksionon procedura e ndërmjetësimit në këto vende. DHKN nxori konkluzionet e duhura për të ardhmen lidhur me përafrimin e legjislacionit, marrjen e praktikave më të mira dhe bashkepunimin rajonal <p>Për të rritur efektivitetin e shërbimit të ndërmjetësimit dhe për të patur profesionalizëm, nisur nga praktikat evropiane, janë organizuar (bazuar në urdherin nr. 89 datë 23.2.2021 të Ministrit të Drejtësisë) Trajnimin e vazhduar të anëtarëve të DHKN, në 27-29 dhjetor 2023, dhe u çertifikuan 37 ndërmjetës.</p>
2.5.11	<p><i>Kryerja e ndërhyrjeve në ligjet ekzistuese për përfshirjen e mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe hartimi i planeve të implementimit të tyre.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>DHKN raporton se në bazë të konkluzioneve të seminareve dhe për të pasur një shërbim efikas për qytetarët dhe për të ulur barrën e gjyqësorit, institucioni ka kërkuar ndryshime ligjore në Kodin e Familjes dhe në Ligjin e Ndërmjetësimit.</p>
2.5.12	<p><i>Zbatimi i sistemeve të mekanizmave alternativë të mosmarrëveshjeve dhe kryerja e analizës.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/ Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit.</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Gjatë periudhës së raportimit janë zbatuar mekanizmat për zgjidhje alternative sipas legjislacionit, për rastet e vetëreferimit dhe referimit nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, por asnjë rast i referuar nga Gjykatat dhe 6 raste të referuara nga Prokuroria, të Rrethit Gjyqësor Elbasan.</p> <p>Janë zgjidhur pozitivisht 798 lëndë në këto fusha:</p> <ul style="list-style-type: none"> • familja • pronë • marrëdhëniet e punës • civile • kriminale <p>Nga programi ADA, në Projektin EmPoMe u zgjidhën 60 raste ndërmjetësimi për personat vulnerabël në qytetet e Elbasanit, Vlorës, Gjirokastrës, Durrësit dhe Tiranës.</p> <p>DHKN po implementon një databazë për nxjerrjen e statistikave në kohe reale.</p>
2.5.13	<p><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të nevojave për trajnim të ndërmjetësve/ hartimi planit/kurrikulës/ programit të trajnimit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p>

	<p>Në Mbledhjen e Përgjithshme të ndërmjetësve, në dhjetor 2023, është kryer analiza e vitit 2023. Në zbatim të hartës së re gjyqësore dhe bazuar ne Statutitn e DHKN është analizuar hapja e dhomave të reja vendore dhe nevojat për trajnim të stafit.</p>
2.5.14	<p><i>Trajnimi i ndërmjetësve në kuadër të rritjes së cilësisë së shërbimit të ndërmjetësimit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • 1 Workshop me gjyqtarë, prokurorë, OJF, noterë dhe institucione në Vlorë; workshope me drejtorë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë; workshope me Dhomën e Biznesit, Durrë Vlorë dhe Lezhë; workshope me gjykatat, prokurorët e rrethit Elbasan; workshope me administratën gjyqësore të Tiranës. • Workshop për referimin e çështjeve në Gjykatën e Juridiksionit Durrës; Workshop për referimin e çështjeve në Gjykatën e Juridiksionit Lezhë; Workshop me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Krimit për të Mitur dhe Policinë e Komunitetit. • 12 seanca mentorimi <p>Trajnimet e vazhdueshme u zhvilluan, në datat 26-28 qershor 2023, në Pogradec me 25 pjesëmarrës.</p> <p>Trajnimi i ndërmjetësuesve dhe gjyqtarëve u zhvillua më 24 korrik 2023, në Durrës, ku morën pjesë 12 Ndërmjetësues të Qytetit të Durrësit.</p> <p>Trajnimi u zhvillua me 19 ndërmjetësues të rinj, në datat 22-24 tetor në Vlorë.</p> <p>Bazuar në Urdhërin e Ministrit nr 89 datë 21.2.2021, kemi zhvilluar Trajnimin e Vazhduar me anëtarët e Dhomës Kombëtare për periudhën 27-29 dhjetor 2023.</p> <p>Trajnimi i organizuar me Policine e Shtetit & Dhomen Kombëtare të Ndërmjetësve, për referim rastesh në zbatim të Kodit për të Mitur.</p>
2.5.15	<p><i>Përgatitja e një studimi në lidhje me përditësimin e tarifave gjyqësore duke përllogaritur tabelën e re të kostove me hartën e re gjyqësore dhe zbatimi i saj për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe ZAM.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Në lidhje me këtë masë, KLGJ miratoi vendimin nr. 641, datë 23.12.2020 “Për propozimin për llojet dhe masat e tarifave gjyqësore dhe procedurën e mbledhjes së tyre”. Ky vendim i është përcjellë për miratim Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.</p> <p>Megjithatë masa kërkon përditësimin e tarifave gjyqësore në përputhje me hartën e re gjyqësore.</p>
2.5.16	<p><i>Sigurimi i mjediseve, infrastrukturës, pajisjeve, mjeteve të transportit, të mjaftueshme dhe të përshtatshme, dhe mbështetje të qëndrueshme buxhetore për funksionimin efektiv të sistemit të DNJF-së.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>DNJF ka hartuar dokumentacionin financiar, për pagat, sigurimet dhe shpenzimet.</p> <p>DNJF ka marrë ambiente me qira për ushtrimin e veprimtarisë së saj nëpërmjet kontratës së qirasë, ndërsa për qendrat e dhënies së ndihmës parësore në rrethe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me gjykatat dhe bashkitë për shfrytëzim pa kompensim.</p> <p>Ne fillim të vitit 2023 u miratua me Urdhër të Kryeministrit, Struktura dhe Organika e Drejtorisë</p>


	<p>së Ndhimës Juridike Falas, u planifikua hapja e 6 (gjashtë) Qendrave Parësore të Shërbimit të Ndhimës Juridike (QSHNJP), në Tropojë, Mat, Pukë, Kurbin, Kavajë dhe Përmet, qytete në të cilat gjykatat e shkallës së parë janë të mbyllura dhe tashmë në ish - ambientet e tyre janë funksionale këto qendra si rrjedhojë e implementimit të hartës së re gjyqësore si dhe për garantimin e aksesit në drejtësi, nëpërmjet ofrimit të ndihmës juridike falas.</p> <p>12 QSHNJP janë nën administrimin e DNJF-se dhe financohen nga buxheti i shtetit, ndërsa 8 QSHNJP të tjera administrohen nga DNJF, por financohen nga UNDP. Këto qendra kanë një shtrirje territoriale që mbulojnë pothuajse gjithë territorin e RSH. Gjithashtu, ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore mbulohet nga OJF-të të cilat operojnë në të gjithë vendin si dhe nga Klinikat e Ligjit që operojnë në Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Durrës.</p>
2.5.17	<p><i>Sigurimi i burimeve të përshtatshme për operatorët dytësorë DNJF.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/DNJF</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas harton projekt-buxhetin afat mesëm për një periudhë 3- vjeçare.</p> <p>Shqyrtimi i dosjeve behet në përputhje me Urdhërin nr. 531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike” dhe me Udhëzimin e Përbashkët Nr.18, datë 05.08.2020 “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërbimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”. Sipas këtij udhëzimi pagesat e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore, kalojnë pasi bëhet vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit në bazë të dokumentacionit vërtetues të përcjellë prej tyre pranë DNJF-së sipas përcaktimit të udhëzimit të sipërcituar.</p>

Për OS 2.5 janë përcaktuar 2 tregues performance:

➤ **% e aplikimeve të pranuar për marrjen e ndihmës juridike parësore falas.**

Ndihma juridike falas e garantuar nga shteti është një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi. Format, kushtet, procedurat dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike falas të garantuar nga shteti përcaktohen në Ligjin për Ndhimën Juridike të miratuar në vitin 2017. Ndihma Juridike Falas Parësore përfshin konsultimin juridik dhe mbështetjen jashtë gjykatës dhe është u jepet njerëzve me të ardhura dhe prona të pamjaftueshme, si dhe grupeve të veçanta të përfituesve vulnerabël (viktima; fëmijë; persona të tjerë vulnerabël). Sipas informacionit në faqen përkatëse të internetit të DNJF, ndihma juridike ofrohet nga 12 qendra të shërbimit parësor të ndihmës juridike në të gjithë Shqipërinë; 15 OJF që operojnë në Tiranë, Vlorë, Berat, Elbasan, Shkodër; dhe 12 Klinika Ligjore që operojnë në Tiranë, Durrës dhe Shkodër.

Personat që kanë përfituar ndihmë parësore juridike falas



Vlera bazë për vitin 2020 për këtë tregues (aplikimet e pranuar për marrjen e ndihmës juridike parësore falas) ishte 4200 persona. Objektivat vjetore në pasaportën e treguesve synojnë rritjen 5% çdo vit të numrit të përfituesve. Objektivi është arritur dhe është tejkaluar në mënyrë të

konsiderueshme në 2021 dhe 2022 si edhe në 2023. Për vitin 2023 7008 persona kanë përfituar ndihmë juridike parësore falas, numër i cili tregon një rritje me 44% nga viti parardhës dhe tejkalon targetin e synuar.


➤ **% e aplikimeve të pranuar për marrjen e ndihmës juridike dytësore falas**

Ndihma Juridike Dytësore përfshin përfaqësimin nga një avokat në një procedurë gjyqësore dhe përjashtimin nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore dhe u jepet personave me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme, si dhe grupeve të veçanta të përfituesve vulnerabël (viktima, fëmijë, persona të tjerë vulnerabël). . Ndihma juridike dytësore ofrohet nga avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, me kërkesë të personit që ka të drejtë të përfitojë ndihmë juridike dytësore. Kërkesa i drejtohet gjykatës kompetente.

Vlera bazë për vitin 2020 për këtë tregues (kërkesat e pranuar për marrjen e ndihmës juridike dytësore falas) ishte 157 persona.

Objektivat vjetore në pasaportën e treguesve synojnë rritjen e numrit të përfituesve me 15% çdo vit (krahasuar me vitin paraardhës). Objektivat për ndihmën juridike dytësore gjithashtu janë arritur dhe janë tejkualuar shumë në vitin 2021 dhe 2022, si edhe në 2023. Në vitin 2023 729 persona kanë përfituar ndihme juridike dytësore falas, numër i cili tregon një 3-fishim të numrit të përfituesve nga viti i kaluar dhe e tejkalon targetin e synuar.

Personat që kanë përfituar ndihmë dytësore juridike falas




2.3. Qëllimi i Tretë i Politikës


Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit.

Qëllimi i Tretë i Politikës: 64 masa

53 masa të zbatueshme në 2023



- Plotësisht të zbatuara
- Pjesërisht të zbatuara
- Të pazbatuara



Është parashikuar një tregues në nivelin e Qëllimit të Tretë të Politikës:

- **% e ankesave të personave që vuajnë dënimin në IEVP, lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut**

Treguesi në nivelin e Qëllimit të Politikës synon të masë ndikimin e institucioneve që ekzekutojnë dënime penale dhe respektimin prej tyre të të drejtave dhe lirive themelore të personave të dënuar që vuajnë dënime pranë këtyre institucioneve (IEVP) – përqindja e ankesave duhet të jetë në rënie. Vlera bazë e targetit për vitin 2020 e vendosur në pasaportën e treguesve ishte 62% dhe vlera e synuar e vitit 2023 është 45%.

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) raporton se gjatë periudhës raportuese janë zgjeruar programet rehabilituese në sistemin e burgjeve. Korniza ligjore është e unifikuar me Rregullat Evropiane të Burgjeve. Lidhur me respektimin e të drejtave të të burgosurve DPB ka marrë vlerësim nga CCPT dhe partnerët ndërkombëtarë. Gjatë vitit 2023 DPB raporton se nga 967 ankesat e kryera, 225 prej tyre ose 23% kanë si objekt shkeljen e të drejtave të njeriut. Sidoqoftë treguesi do të rishikohet në strategjinë e re.

Objektivi Specifik 3.1.

Plani i Veprimit për Objektivin 3.1 parashikon parashikon 13 masa, prej të cilave **4 masa janë zbatuar plotësisht**, 4 masa janë zbatuar pjesërisht, dhe 5 masa rezultojnë të pazbatueshme (me ngjyrë të bardhë, shih metodologjinë). 50% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht.

OS 3.1: Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë përditësuar duke synuar një qasje të integruar të institucioneve të drejtësisë dhe një qasje restauruese të drejtësisë, ndërtuar mbi parandalimin, risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin duke zëvendësuar qasjen ndëshkuese ekzistuese.	
3.1.1	<p><i>Kryerja e studimit të analizës për ndërhyrjet e mundshme në Kodin Penal.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Masa është zbatuar në 2021.</p>
3.1.2	<p><i>Përgatitja e një studimi të detajuar për praktikën më të mira evropiane, në funksion të ndryshimeve të KP-së, konsultimi me institucionet përkatëse për praktikën më të mirë për parandalimin e krimit dhe shpërndarja e analizës.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Analiza për ndryshimet në legjislacionin penal përmban një studim të detajuar të praktikave më të mira ndërkombëtare, duke i kushtuar vëmendje të veçantë direktivave të Bashkimit Evropian. Megjithatë, mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë vazhdon me identifikimin e mëtejshëm të direktivave dhe rezolutave të BE-së në lidhje me Kodin Penal.</p>
3.1.3	<p><i>Përgatitja e paketës së propozimeve për ndryshimet në Kodin Penal bazuar në gjetjet e analizës.</i> (pz 2021-2022)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Paketa e propozimeve për ndryshimin e Kodit Penal nuk është finalizuar në tërësi. Ministria e Drejtësisë është në proces të hartimit të aktit dhe tabelave të përputhshmërisë me <i>acquis</i> të Bashkimit Evropian.</p> <p>Kompleksiteti i Kodit Penal, numri i madh i institucioneve të interesuara për zbatimin e Kodit Penal dhe numri i madh i akteve të Bashkimit Evropian që do të përafrohen me Kodin Penal kanë ndikuar në përgatitjen e paketës së propozimeve.</p>
3.1.4	<p><i>Konsultimi i paketës së propozimeve me grupet e interesit (ëorkshop) dhe hartimi i raporteve të konsultimit / finalizimi i paketës dhe miratimi.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>MD raporton se në kuadër të nismës për hartimin e Kodit të ri Penal, për të garantuar një proces gjithëpërfshirës, është zhvilluar një proces konsultimi paraprak, me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të institucioneve të pavarura, për veprat penale që lidhen me fushën e veprimtarisë së tyre, përfshirë këtu përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së</p>

	<p>Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimi Rural, Qendrës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Agjencisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Agjencisë së Mbikëqyrjes Financiare, Instat, etj. U zhvillua gjithashtu konsultimi me përfaqësues të OSBE, OPDAT, CRCA, UNICEF, JUSTAL.</p> <p>Prokuroria e Përgjithshme raporton që, në cilësinë e grupit të interesit, është kaluar për shqyrtim drafti me ndryshimet në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Ky draft i ka kaluar për shqyrtim edhe prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm të të gjitha niveleve, në mënyrë që prokuroria të përgatisë opinionin përfundimtar lidhur me këtë draft.</p>
3.1.5	<p><i>Kryerja e analizës dhe përgatitja e raporteve të monitorimit në lidhje me gjendjen e zbatueshmërisë së Kodit Penal, të ndryshuar.</i> (pz 2024-2024)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës</u></p> <p>Ministria nuk i ka dorëzuar ende Kuvendit propozimet për Kodin e ri Penal.</p>
3.1.6	<p><i>Informimi dhe rritja e kapaciteteve të grupeve të interesit në lidhje me unifikimin e praktikës dhe zbatimin e Kodit të ri Penal (trajnime/seminare).</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p>
3.1.7	<p><i>Kryerja e studimit të status quo-së dhe analizës së ndërhyrjes për Kodin e Procedurës Penale (KPP).</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Zbatuar në vitin 2021.</p>
3.1.8	<p><i>Përgatitja e një studimi të detajuar për praktikën më të mira evropiane, në funksion të ndryshimeve të KPrP, konsultimi me institucionet përkatëse për praktikën më të mirë për parandalimin e krimit dhe shpërndarja e analizës.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Është raportuar se është zbatuar plotësisht në vitin 2021. Megjithatë, në periudhën raportuese MD sqaroi se analiza për ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale bazohet në përafrimin e Kodit me direktivat e Bashkimit Evropian.</p>
3.1.9	<p><i>Përgatitja e paketës së propozimeve për ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale bazuar në gjetjet e analizës.</i> (pz 2021-2022)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Përgatitja e paketës së propozimeve ka përfunduar pjesërisht. Ministria e Drejtësisë vijon procesin për përgatitjen e projektligjit dhe tabelave të përputhshmërisë me <i>acquis</i> të Bashkimit Evropian. Komplexiteti i Kodit të Procedurës Penale si dhe numri i lartë i akteve të Bashkimit Evropian të cilat do të përafrohen në Kod ka ndikuar në përgatitjen e paketës së propozimeve.</p>
3.1.10	<p><i>Konsultimi i paketës së propozimeve me grupet e interesit (ëorkshop) dhe hartimi i raporteve të konsultimit/finalizimi i paketës dhe miratimi.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p>

	<p><u>Përmbledhja e veprimeve:</u></p> <p>Projekt akti nuk është ende në fazën e konsultimit të propozimit. Finalizimi i projektaktit dhe konsultimi me institucionet e interesuara dhe konsultimin publik do të jetë pjesë e procesit vijues.</p>
3.1.11	<p><i>Kryerja e analizës dhe përgatitja e raporteve të monitorimit në lidhje me zbatueshmërinë e Kodit të Procedurave Penale, të ndryshuar.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Projekt akti nuk është miratuar ende. Megjithatë, kjo masë paraqitet në progres e sipër në çdo rast, në kushtet kur zbatimi i Kodit të Procedurës Penale nuk bëhet nga DPKHL-ja, por nga gjykatat, prokuroritë dhe subjektet e tjera të cilëve u adresohen rregulla për procedimet dhe gjykimet penale, sipas rregullave të përcaktuara në Kod.</p> <p>Në çdo rast, analiza nuk mund të kryhet ex officio nga DPKHL-ja pa administruar kërkesa apo informacion nga subjektet e zbatimit të ligjit për mënyrën e implementimit të tij, problematikat e evidentuara gjatë zbatimit në veprimtarinë e përditshme etj, të cilat nxjerrin në pah efikasitetin përgjatë zbatimit dhe nevojën për marrjen e masave me karakter ligjor a administrativ/praktik për adresimin e tyre.</p>
3.1.12	<p><i>Informimi dhe rritja e kapaciteteve të grupeve të interesit në lidhje me unifikimin e praktikës dhe zbatimin e Kodit të Procedurës Penale (trajnime/seminare).</i> (pz 2024-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p>
3.1.13	<p><i>Ngritja dhe funksionimi i Grupit Tematik për Drejtësinë Penale.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Krijimi i Grupit Tematik në mbështetje të Komitetit Drejtues Sektorial për zbatimin e “Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025, Planit të Veprimit të saj dhe Pasaportës së Treguesve me Shkresën Nr. 986 prot., datë 16.02.2022 dërguar me shkresë institucioneve përkatëse.</p> <p>Në 13 Prill të vitit 2023 Ministria e Drejtësisë me asistencën e JUSTAL ka organizuar një takim me anetarët e Grupit Tematik për Drejtësinë Penale me qëllim rritjen e kapaciteteve në kuadër të zbatimit të SND.</p> <p>Sipas Urdhërit Nr.90 datë 01.08.2023 të Kryeministrit “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe riorganizimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar” mekanizmat ndërsektorial tanimë funksionojnë mbi bazën e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës(GNP).</p>

Për OS 3.1 është përcaktuar një tregues performance:

- **Shkalla e ndryshimeve në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale që reflektojnë standardet ndërkombëtare të drejtësisë penale**

Treguesi matet nëpërmjet një analize nga MD në lidhje me vlerësimin e ndryshimeve të Kodit Penal (KP) dhe Kodit të Procedurës Penale (KPrP).

Gjatë vitit 2023, grupi i punës për hartimin e Kodit Penal ka zhvilluar takime intensive me synimin për të përfunduar hartimin e Kodit, me qëllim harmonizimin e tij me standardet

ndërkombëtare. Kodi është konsultuar hap pas hapi me përfaqësues të institucioneve publike dhe organizatave jofitimprurëse, por ende nuk ka një version përfundimtar.

Objektivi Specifik 3.2.

Plani i Veprimit për Objektivin 3.2 parashikon parashikon 15 masa, prej të cilave **9 masa janë zbatuar plotësisht**, 2 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 4 masa rezultojnë të pazbatueshme (me ngjyrë të bardhë, shih metodologjinë). 81.8% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht.

OS 3.2: Një sistem prokurorie efikas dhe proaktiv që funksionon sipas standardeve evropiane me qëllim hetimin dhe ndjekjen efikase të korrupsionit dhe krimit të organizuar.	
3.2.1	<p><i>Përmirësimi i menaxhimit strukturor dhe administrimit të prokurorisë nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit eficient të burimeve njerëzore dhe buxhetit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Prokuroria e Përgjithshme</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Në zbatim të hartës së re gjyqësore dhe me qëllim riorganizimin e prokurorive, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzimin e përgjithshëm nr.1, datë 26.01.2023 "Për masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apelit të juridiksionit të përgjithshëm " si dhe urdhërin nr.19, datë 18.01.2023 për caktimin e strukturës organike të prokurorisë së Apelit të juridiksionit të përgjithshëm, sipas të cilit 17 prokurorë të prokurorive të apelit nga data 01.02.2023 do ushtrojnë funksionin në Prokurorinë e Apelit Tiranë dhe urdhërin nr.54, datë 18.04.2023 për caktimin e strukturës organike të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, sipas të cilit prokurorët e prokurorive që do pushojnë së funksionuari, do të ushtrojnë funksionin në prokuroritë me të cilat do bashkohen. Në strukturën e re të prokurorive, për shkak të ndryshimit të hartës së re gjyqësore, janë pasqyruar edhe lëvizjet e stafit administrativ, duke plotësuar njëkohësisht edhe nevojat e prokurorive.</p> <p>Gjithashtu në vitin 2023, në kuadër të rritjes së kapaciteteve njerëzore në ndihmë të prokurorëve, janë emëruar 16 oficerë të policisë gjyqësore në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 25/2019 "Për policinë gjyqësore". Këto ndryshime strukturore janë shoqëruar edhe me kalimin e buxhetit në prokuroritë me të cilat janë bashkuar prokuroritë e suprimuara. Gjatë 6-mujorit të dytë Prokuroria e Përgjithshme nuk ka raportuar aktivitete shtesë në lidhje me zbatimin e masës.</p>
3.2.2	<p><i>Kryerja e studimit të status quo-së dhe analizës së ndërhyrjes në ligjin organik të prokurorisë.</i> (pz 2021-2022)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Prokuroria e Përgjithshme</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Raportuar si e implementuar në vitin 2022.</p>
3.2.3	<p><i>Përgatitja e paketës së propozimeve për ndryshimet në ligjin organik të prokurorisë bazuar në gjetjet e analizës.</i> (pz 2021-2022)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Prokuroria e Përgjithshme</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p>

	Raportuar si e implementuar në vitin 2022.
3.2.4	<p><i>Konsultimi i paketës së propozimeve me grupet e interesit (ëorkshop) dhe hartimi i raporteve të konsultimit/finalizimi i paketës dhe miratimi I ligjit organik të prokurorisë, të ndryshuar. (pz 2021-2022)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Prokuroria e Përgjithshme</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Raportuar si e implementuar në vitin 2022.</p>
3.2.5	<p><i>Kryerja e analizës në lidhje me gjendjen e zbatueshmërisë së ligjit organik të prokurorisë, të ndryshuar. (pz 2023-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Prokuroria e Përgjithshme</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Prokuroria e Përgjithshme raporton që nuk janë miratuar akoma ndryshimet në ligjin për prokurorinë ndaj analiza në lidhje me gjendjen e zbatueshmërisë së ligjit organik të prokurorisë do të hartohet pas miratimit të ndryshimeve ligjore, të cilat janë paraqitur në Kuvend..</p>
3.2.6	<p><i>Kryerja e analizës në lidhje me nevojën për rishikim të akteve nënligjore, pas ndryshimeve në ligjin organik të prokurorisë. (pz 2023-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Prokuroria e Përgjithshme</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Prokuroria e Përgjithshme raporton që nuk janë miratuar akoma ndryshimet në ligjin për prokurorinë ndaj analiza në lidhje me nevojën për rishikim të akteve nënligjore do të hartohet pas miratimit të ndryshimeve ligjore.</p>
3.2.7	<p><i>Përgatitja, konsultimi dhe miratimi i paketës së akteve nënligjore të nevojshme. (pz 2023-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Prokuroria e Përgjithshme</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Prokuroria e Përgjithshme raporton që nuk janë miratuar akoma ndryshimet në ligjin për prokurorinë ndaj këto procese do të kryhen pas miratimit të ndryshimeve ligjore.</p>
3.2.8	<p><i>Kryerja e analizës së nevojave për trajnim për rritjen e kapaciteteve të magjistratëve prokurorë/OPGJ për kuadrin ligjor dhe nënligjor/ hartimi i moduleve të trajnimit. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Në vitet e fundit, Shkolla e Magjistratures ka kryer në bazë vjetore analizën e nevojave për trajnim, e cila fillon në periudhën janar-mars dhe përfundon në shtator-tetor, që përkon me fillimin e vitit të ri akademik në të cilin do të zhvillohen trajnimet. Analiza merr parasysh burime të ndryshme si plane strategjike kombëtare të institucioneve, raporte ndërkombëtare, dhe kërkesat e magjistratëve dhe subjekteve të tjera që trajnohen.</p> <p>Në vitin 2023, Shkolla e Magjistratures përmiresoi metodologjinë e vlerësimit të nevojave për trajnim përmes kërkimit, analizës së gjetjeve dhe propozimeve konkrete për orientimin e moduleve të trajnimit drejt specializimit dhe për orientim të moduleve edhe lidhur me subjektin që po trajnohet. Sipas kesaj metodologjie u konkludua se është e nevojshme të ketë: a) module trajnimi per magjistratet që kane deri në 5 vite pune në sistem, b) module trajnimi të thelluara/specializuara në tema specifike të rëndësishme për punën e magjistratit dhe c) module trajnimi për kategoritë e tjera të subjekteve që trajnohen nga SHM.</p>

	<p>Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 ka vijuar pjesmarrja në trajnimin vazhdues nga ana e prokurorëve sipas temave të zgjedhura prej tyre, bazuar në detyrimin ligjor të parashikuar në ligjin nr.96/2016 "Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në RSH". Në total janë ndjekur 1074 trajnime nga prokurorët dhe 572 nga oficerët e policisë gjyqësore (OPGJ). Gjithashtu ka perfunduar trajnimi fillestar i 16 OPGJ të emëruar në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.</p>
3.2.9	<p><i>Informimi dhe rritja e kapaciteteve të grupeve të interesit në lidhje me ligjin organik të prokurorisë dhe aktet nënligjore (trajnime/seminare).</i> (pz 2023-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Shkolla e Magjistraturës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Kjo masë do të zbatohet pas miratimit të ndryshimeve ligjore përkatëse.</p>
3.2.10	<p><i>Përgatitja e analizave të rregullave ndërinstitucionale mbi efikasitetin e hetimeve ndaj pastrimit të parave, hartimi i raporteve të analizës mbi evidentimin e problematikave dhe përgatitja e paketës së rekomandimeve.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Prokuroria e Përgjithshme</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Edhe përgjatë vitit 2023 ka vazhduar zbatimi i i udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, nr.10, datë 17.07.2020 “Masat administrative dhe proceduriale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare etj.”, i ndryshuar, si dhe i tre qarkoreve të nxjerra gjatë vitit 2022. Në vijim të masave për zbatimin e këtij udhëzimi, në vitin 2023 prokuroritë janë udhëzuar edhe nëpërmjet një qarkoreje tjetër. Po kështu është përditësuar progresi raporti për zbatimin e planit të veprimit ICRG/FATF me treguesit përkatës sipas periudhave të raportimit, është shkëmbyer informacion e janë zhvilluar takime ndërinstitucionale të përbashkëta sipas parashikimeve të Memorandumit të Bashkëpunimit të korrikut 2020, si dhe janë zhvilluar takime pune e analiza në nivel qendror dhe vendor me institucionet e përfshira. Në këtë kuadër, veçojmë takimin ndërinstitucional në datën 17.07.2023, organizuar nga Prokuroria e Përgjithshme me objekt diskutimesh masat institucionale për përmbushjen e detyrimeve për realizimin e Planit të Veprimit ICRG/FATF, rritjen e bashkëpunimit nëpërmjet masave monitoruese dhe koordinuese, analizave të përbashkëta dhe shkëmbimit të informacionit, rritjen e bashkëpunimit në drejtim të shtimit të numrit të hetimeve proaktive.</p> <p>Rezultat i masave tre vjeçare të finalizuara në vitin 2023 është progresi në zbatimin e rezultateve immediate të planit të veprimit, ku vlejné për t’u theksuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) plotësimi dhe konsolidimi i sistemit elektronik e-tracking PRESTO i menaxhimit të çështjeve të pastrimit të parave me të dhëna të përditësuara të të gjithë prokurorive, në zbatim të [rezultatit imediat (IO.7 pika 1)] të planit të veprimit. Këta tregues janë vlerësuar vazhdimisht nga grupi i ekspertëve të FATF/ICRG gjatë të gjithë periudhës raportuese dhe janë konsideruar të adresuara gjerësisht; 2) rritje dukshëm e efektivitetit në hetimin, ndjekjen penale, sekuestrimin e pasurive, dhe numrin e akuzave të ngritura me kërkesat për gjykim për pastrimin e parave të dërguara në gjykatë, si dhe rritja dukshëm e dënimeve penale dhe konfiskimeve të pasurive në zbatim të rezultateve (immediate IO.7 pika 2) të planit të veprimit; 3) rritje dukshëm e hetimeve financiare paralele ose procedime/hetime pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve kriminale, sipas tipologjive me vepra penale të huaja, bazuar në rrethana fakti objektive, në zbatim të (rezultatit imediat IO.8) të planit të veprimit.

3.2.11	<p><i>Konsolidimi i burimeve njerëzore për funksionimin e plotë të SPAK-ut.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> SPAK</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) raporton se gjatë vitit 2023, me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe funksionalitetin e saj, ka vijuar me procesin e plotësimit të stafit, ku gjatë vitit 2023 kanë ushtruar detyrën gjithsej 105 punonjës, nga të cilët 17 (shtatëmbëdhjetë) Prokurorë të emëruar, 1 (një) Prokuror i transferuar, 12 (dymbëdhjetë) Hetues Financiar, 77 (shtatëdhjetë e shtatë) punonjës administrativë dhe 1 (një) punonjës me kontratë.</p> <p>Ndërkohe vijon procesi i rekrutimit për 3 prokurorë të tjerë nga KLP, sipas kërkesës së SPAK për plotësimin e vendeve vakante.</p>
3.2.12	<p><i>Konsolidimi i burimeve njerëzore për funksionimin e plotë të BKH-së.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> BKH</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Procesi administrativ për përzgjedhjen e kandidateve vijon. Rekrutimi i Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe nëpunësve civilë është në masën 54%. Për vitin 2023 për shkak të mungesave organike buxheti i parashikuar nuk është shfrytëzuar plotësisht. Nga ana e kësaj strukture janë paraqitur synime për struktura më efikente, të kompletuara me njësi të analizës së riskut, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe operacionale, si dhe rekrutimi i kapacitetit njerëzor cilësor.</p>
3.2.13	<p><i>Kryerja e analizës së nevojave për trajnim për rritjen e kapaciteteve të prokurorëve të SPAK-ut, hetuesve BKH-së, përgatitja e kurrikulave dhe moduleve të trajnimit</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> SPAK</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Në kuadër të forcimit të kapaciteteve institucionale, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjatë vitit 2023 ka realizuar me sukses objektivat e saj në përfundimin e kuadrit rregullator të institucionit, duke hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore për mirëfunksionimin e veprimtarisë institucionale, në përbushje të misionit kryesor të Prokurorisë së Posaçme, sic janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e sjelljes dhe Standardeve të Etikës, në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. • Plani i trajnimit të personelit administrativ sipas kategorive 2023-2026. • Strategjia e Burimeve Njerëzore për vitin 2024-2026, në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e cila implementon në vetvete politika të përbushjes së planit të integritetit, përgatitjes së kurrikulave dhe moduleve të trajnimit.
3.2.14	<p><i>Zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve institucionale të SPAK-ut (trajnime/seminare).</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> SPAK</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Për ngritjen e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore, lidhur me trajnimet, gjatë vitit 2023, Prokurorët pranë Prokurorisë së Posaçme i janë nënshtruar trajnimit të vazhdueshëm nga Shkolla e Magjistraturës.</p> <p>Për vitin 2023, përveç takimeve koordinuese në kuadër të skuadrave të përbashkëta nga prokurorët janë kryer 22 trajnime / vizita studimore, janë mbajtur 47 takime / konferenca / forume jashtë vendit, kryesisht në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.</p>

	<p>Hetuesit Financiar pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar i janë nënshtruar trajnimeve të ndryshme të ofruara nga partnerët ndërkombëtare, në kuadër të detyrave të tyre funksionale të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trajnim në kuadër të ndjekjes penale në luftën kundër terrorizmit. - Trajnim mbi luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit <p>Ne lidhje me këtë komponent referojme se, rreth 43 punonjës nga administrata e Prokurorisë së Posaçme kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, rreth 7 (shtatë) punonjës kanë marrë pjesë në trajnime të ofruara nga Komisioni Europian dhe Organizata të tjera Ndërkombëtare, dhe rreth 4 (katër) punonjës kanë marrë pjesë në trajnime të ofruara nga institucione trajnuese private. Në total, 58 punonjës të Prokurorisë së Posaçme kanë ndjekur rreth 27 tema të ndryshme trajnimi.</p> <p>Gjithashtu gjatë vitit 2023 në bashkëpunim me ASPA, ILDKPIK, AKSIK dhe institucione të tjera, janë kryer on-line një pjesë e mirë e trajnimeve të planifikuara.</p>
3.2.15	<p><i>Zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve institucionale të BKH-së (trajnime/seminare).</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> BKH</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Përgjatë vitit 2023 hetuesit e BKH-se kanë marrë pjesë në 47 trajnime brenda vendit dhe 25 trajnime jashtë vendit, të financuara 100% nga agjensite ligjzbatuese rajonale dhe më gjerë, Shkolla Magjistratures dhe organizata/donatore ndërkombëtare.</p>

Për OS 3.2 është përcaktuar një tregues performance:

➤ **Përqindja e çështjeve që shkojnë në gjyq në të cilat i pandehuri është lënë i lirë.**

Në kuadrin e një sistemi të drejtësisë penale të bazuar në parimet moderne evropiane që garantojnë respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, treguesi synon të masë raportin midis numrit të të pandehurve që janë shpallur të pafajshëm ose për të cilët është pushuar çështja./përfunduar, dhe numri i përgjithshëm i të pandehurve para gjykatave në një vit.

Në bazë të të kuptuarit të treguesit, Prokuroria e Përgjithshme raportoi se treguesi duhet të matet vetëm në baza vjetore. Për vitin 2023, nga çështjet e gjykuara në shkallë të parë, vetëm në 4.3% është vendosur pafajësi ose është pushuar çështja/akuza dhe në 95.7% të çështjeve të pandehurit janë deklaruar fajtorë (nga 4607 procedime të gjykuara, në 199 është vendosur pafajësi).

Siç vihet re në raportin vjetor të monitorimit të SND 2022, PP ka sugjeruar që ky tregues të rishikohet në mënyrë që të pasqyrojë më mirë zbatimin e masave të parashikuara për OS 3.2.

Objektivi Specifik 3.4.⁴

Plani i Veprimit për Objektivin 3.4 parashikon 19 masa, prej të cilave **8 masa janë zbatuar plotësisht**, **6 masa janë zbatuar pjesërisht**, **3 masa rezultojnë të pazbatuara** dhe 2 masa rezultojnë të pazbatueshme (me ngjyrë të bardhë-shih metodologjinë). 47% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht.

SO3.4: Një shërbim prove efektiv dhe efikas që përdor standardet operationale, metodologjitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimin e individualizuar të çështjeve, mbështet risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin dhe punon në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira të BE-së.	
3.4.1	<p><i>Kryerja e analizës në lidhje me nivelin e zbatueshmërisë dhe nevojën për ndryshime të kuadrit ligjor në lidhje me DPSHP-në dhe strukturën organizative të saj për t'u përshtatur me standardet evropiane (pz 2021-2021)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Masa është implementuar në vitin 2022. Legjislacioni për rregullimin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës është miratuar në vitin 2020, dhe aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 79/2020 janë miratuar përgjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022.</p>
3.4.2	<p><i>Përgatitja e paketës së ndërhyrjeve ligjore në kuadrin nënligjor të DPSHP-së, konsultimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve ligjore e nënligjore. (pz 2022-2022)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Masa është implementuar në vitin 2022, dhe paketa e akteve ligjore është elaboruar dhe adoptuar në vitin 2020-2022 (Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore janë të përmendura në Planin e Veprimit).</p>
3.4.3	<p><i>Kryerja e analizës së nevojave për trajnim të burimeve njerëzore pranë DPSHP-së dhe përgatitja e planit të trajnimit / kurrikulave dhe programeve të trajnimit (trajnimi bazë dhe vazhdues). (pz 2021-2021)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Masa është zbatuar në vitin 2022 pasi plani i trajnimit dhe modulet e punonjësve të Shërbimit të Provës është miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 80, date 22.02.2022.</p> <p>Institucioni raporton se është hartuar dhe miratuar metodologjia e trajnimit fillestar nga ana e grupit të punës të ngritur me anë të urdhërit nr. 22, datë 21.03.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.</p>
3.4.4	<p><i>Trajnimi i nëpunësve të DPSHP-së për rritjen e performancës në kryerjen e funksioneve (trajnim bazë dhe vazhdues). (pz 2021-2023)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p>

⁴ Objektivi 3.3 nuk është i përfshirë në Planin e Veprimit të SND 2021-2025 për të shmangur mbivendosjen me masat e parashikuara në Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur.

	<p>Programet e trajnimit fillestar dhe vazhdues janë përcaktuar në Urdhrin nr. 80/2022 të Ministrit të Drejtësisë. Në vitin 2023 është implimentuar trajnimi fillestar për të gjithë nëpunësit në periudhë prove. Ndërkohë, trajnimi vazhdues nuk është implementuar akoma për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe ambienteve të nevojshme për zhvillimin e këtij trajnimi nga ana e specialistëve më të vjetër të Shërbimit të Provës.</p> <p>Për trajnimin fillestar janë hapur thirrje për ekspertë trajnues dhe janë kualifikuar vetëm tre ekspertë për pesë tematika nga 12 tematika në total.</p>
3.4.5	<p><i>Konsolidimi dhe finalizimi i marrëveshjeve të binjakëzimit/bashkëpunimit me partnerët institucionalë evropianë.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Ministria e Drejtësisë ka miratuar marrëveshje në fushën e mbikëqyrjes së dënimeve alternative me Republikën e Kosovës.</p> <p>Marrëveshjet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për dënimet alternative në shtetet e tjera duhet të bëhen sipas Konventës ose nëpërmjet marrëveshjeve të ratifikuara nga Kuvendi. Kohëzgjatja e këtyre procedurave ngadalëson procesin për lidhjen e marrëveshjeve</p>
3.4.6	<p><i>Kryerja e analizës së funksionimit të sistemit të administrimit të çështjeve dhe përgatitja e rekomandimeve për përmirësimin.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Masa raportohet se është zbatuar pjesërisht. Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës, nr. 27, datë 18.03.2022, është hartuar rregullorja për administrimin dhe përcaktimin e roleve që kanë të drejta akses në bazën e të dhënave të personave nën mbikëqyrje në sistemin e Shërbimit të Provës.</p> <p>Mirëmbajtja e Sitemit të Shërbimit të Provës kryhet nga AKSH-i, institucion i cili kryen lidhjen e kontratave të mirëmbajtjes së Sistemit dhe Shërbimi Provës është institucioni përfitues i shërbimit. Ndrëkohë që nga data 25.02.2023 ka përfunduar kontrata e mirembajtjes së sistemit dhe pritet një infomacion nga ana e AKSHI-it se si do vijohet me mirëmbajtjen e këtij sistemi.</p>
3.4.7	<p><i>Dizenjimi dhe instalimi i teknologjisë së informacionit bashkëkohor si dhe sistemit të administrimit të çështjeve, duke krijuar lidhje me sistemin e integruar të drejtësisë elektronike.</i> (pz 2021-2022)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Dizenjimi dhe instalimi i teknologjisë së informacionit varet nga QTI. Shërbimi i Provës është një nga hallkat e zinxhirit të institucioneve në fushën e drejtësisë penale dhe realizimi i kesaj mase varet nga të gjithë institucionet e tjera të Drejtësisë.</p>
3.4.8	<p><i>Përmirësimi i infrastrukturës dhe pajisjeve për funksionimin e plotë të zyrave rajonale të DPSHP-së në përputhje me standardet evropiane.</i> (pz 2022-2022)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Drejtoria e Shërbimit të Provës raporton se nga tërësia e Degëve Territoriale të Shërbimit të Provës, tetë prej tyre janë të vendosura në ambiente private të marra me qira dhe pjesa tjetër janë ambiente shtetërore. Shërbimi i Provës i është drejtuar me shkresë Ministrisë së Drejtësisë duke i kërkuar hapësira shtesë për Degët Territoriale që ndodhen në ambiente shtetërore, me qëllim krijimin e</p>

	<p>ambienteve të përshtatshme për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin dhe ambienteve për përpunimin dhe arkivimin e dosjeve të personave nën mbikëqyrje. Sigurimi i ambienteve funksionale dhe të përshtatshme për degët territoriale të Shërbimit të Provës është në vëmendje të vazhdueshme nga Ministria e Drejtësisë.</p>
3.4.9	<p><i>Kryerja e analizës mbi rishikimin e akteve nënligjore specifike, rregulloreve, udhëzimeve, standardeve përfshirë afatet kohore dhe formatet për punën para dënimit.</i> (pz 2022-2022)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> E pazbatuar.</p>
3.4.10	<p><i>Hartimi i paketës së akteve nënligjore specifike, rregulloreve, udhëzimeve, standardeve/ konsultimi i paketës dhe miratimi.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Legjislacioni për rregullimin e funksionimit të Shërbimit të Provës është miratuar në vitin 2020. Aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 79/2020 janë miratuar gjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022.</p>
3.4.11	<p><i>Hartimi i metodologjive (udhëzime, standarde) të reja lidhur me (i) mbikëqyrjen (menaxhimi i çështjeve individuale dhe mbikëqyrja elektronike); (ii) lirimimin me kusht.</i> (pz 2022-2022)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Zbatuar në vitin 2022.</p>
3.4.12	<p><i>Përgatitja e programeve të pilotimit të metodologjive të reja të mbikëqyrjes dhe pilotimi i tyre në dy zona.</i> (pz 2022-2023)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Nuk është zbatuar.</p>
3.4.13	<p><i>Kryerja e analizës në lidhje me vlerësimin e përvojës së përdorimit të metodologjive të reja të mbikëqyrjes në zonat pilot dhe përgatitja e programit kombëtar të mbikëqyrjes elektronike dhe lirimimit me kusht.</i> (pz 2024-2024)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Zbatimi i kësaj mase fillon zbatimin në vitin 2024.</p>
3.4.14	<p><i>Konsolidimi i metodologjive të mbikëqyrjes e protokolleve dhe funksionimi i tyre në të gjithë territorin.</i> (pz 2024-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u> Zbatimi filloi gjatë periudhës raportuese dhe është në proces. Në zbatim të planeve vjetore të inspektimit, Drejtoria e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare në përfundim të inspektimit të Degëve të Territorit, bazuar në problematikat e konstatuara, dha rekomandimet përkatëse me qëllim konsolidimin e metodologjive të mbikëqyrjes dhe unifikimin e praktikave në të gjitha Degët Territoriale.</p>

3.4.15	<p><i>Kryerja e analizës në lidhje me nevojën për bashkëpunim të DPSHP-së me institucionet përkatëse të drejtësisë dhe hartimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit për punën në shërbimin e provës në fazën para dënimit.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Shërbimi i Provës raporton se për periudhën raportuese ka kryer një analizë në bazë të së cilës konsideron të nevojshme arritjen e marreveshjeve të bashkëpunimit me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Shërbimin Social të Bashkive. Nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe Kryetarit të Bashkisë Tiranë është nënshkruar marreveshja e bashkëpunimit për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin, në fazën para dënimit.</p> <p>Shërbimi i Provës ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi, përkatësisht me: Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Shoqatën Community Aid, Shoqatën Antigonea, dhe me 62 Bashki në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu Shërbimi i Provës ka bashkëpunime të vazhdueshme me Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, gjykatat, prokuroritë dhe organet e pushtetit qëndror e vendor, si dhe me OJF të ndryshme sipas marrëveshjeve që janë lidhur mbi trajtimin e rasteve të mbikqyrjes për të dënuarit me dënime alternative.</p> <p>Në përmbushje të misionit të Shërbimit të Provës, për rehabilitimin dhe riintegrimin e personave nën mbikqyrje (pas dënimit), por edhe për aplikimin e dënimeve alternative nga gjykatat (para dënimit), ShP ka hartuar dhe zbaton që prej vitit 2022 dhe në vazhdim planin vjetor të aktiviteteve, në kuadër të së cilit mbahen takime me institucione për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me qëllim riintegrimin e personave nën mbikqyrje apo kryerjen e një pune në interes publik, si dhe janë mbajtur takime me gjyqtarë të gjykatave dhe prokurorive të rrethit gjyqësor me qëllim promovimin e aplikimit të dënimeve alternative / masave alternative dhe diskutimin e problematikave të hasura lidhur me zbatimin e dënimeve alternative / masave alternative.</p>
3.4.16	<p><i>Forcimi i bashkëpunimit me institucionet përkatëse të drejtësisë (gjykatat, prokuroria, sistemi penitenciar) për punën e shërbimit të provës (trajnime/ëorkshop-e).</i> (pz 2022-2024)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Shërbimi i Provës ka bashkëpunuar vazhdimisht me Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, gjykatat, prokuroritë dhe organet e pushtetit qëndror e vendor, si dhe me OJF të ndryshme sipas marrëveshjeve që janë lidhur mbi trajtimin e rasteve të mbikqyrjes për të dënuarit me dënime alternative.</p> <p>Për vitin 2022 dhe 2023 Shërbimi i Provës ka dakordësuar me Shkollën e Magjistraturës zhvillimin e trajnimeve mbi tematika të nevojshme për punonjësit të Shërbimit të Provës.</p> <p>Në vitin 2023 Shkolla e Magjistraturës ka përgatitur trajnime me temat e mëposhteme:</p> <ul style="list-style-type: none"> · Lirimi me kusht; · Kushtet e lejimit, kriteret ligjore që duhen përmbushur; · Dënimi me burgim të përjetshëm dhe përlllogaritjet e kohës së vuajtjes së dënimit; · Periudha e sigurisë dhe lirimi me kusht. · Përsëritja në krim, sjellja e të dënuarit në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe marrëdhënies autorë-viktimë si elemente thelbësore të raportit të vlerësimit të Shërbimit të Provës. <p>Megjithatë vihen re disa problematika lidhur me dërgimin me vonesë të urdhrave të ekzekutimit nga Prokuroria dhe moskthimin e përgjigjeve të kërkesave drejtuar Prokurorive, duke përfshirë kërkesat</p>

	<p>për informacion, raportet e mospërmbushjes, raportet përfundimtare, të cilat sjellin vështirësi në zbatimin e detyrave funksionale nga Shërbimi i Provës. Gjithashtu vihet re vendosja e adresave të pasakta nga gjykatat dhe prokuroritë, të cilat nuk bëjnë të mundur njoftimin e të dënuarit për t'u paraqitur pranë Degëve Territoriale.</p>
3.4.17	<p><i>Përgatitja e një programi të përbashkët komunikimi me popullatën e gjerë.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Plani i Aktiviteteve të parashikuara për vitin 2023 është miratuar dhe mund të gjendet lehtësisht në faqen zyrtare të Shërbimit të Provës. Në zbatim të këtij plani janë organizuar gjithësej 191 aktivitete nga 22 Dege Territoriale ku përfshihen takime midis degëve territoriale, prokurorive, universiteteve, shkollave 9-vjecare, shkollave të arsimit të mesëm, etj .</p>
3.4.18	<p><i>Përgatitja e programeve të bashkëpunimit me KLGJ-në, KLP-në, PP-në, SHM-në për të informuar për qasjet e reja dhe mundësitë e një shërbimi modern prove sipas standardeve europiane.</i> (pz 2021-2022)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>E pazbatuar.</p>
3.4.19	<p><i>Rritja e kapacitetit të stafit për të siguruar një normë prej 50 stazhierësh për staf në përputhje me standartet evropiane dhe për të siguruar stafin e duhur për zyrat vendore, si dhe struktura e pagave u rishikua për të siguruar pagesën e duhur në të gjithë organizatën sipas aftësive dhe përgjegjësi në përputhje me skemën zyrtare të pagave.</i> (pz 2021-2022)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Provës</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Shërbimi i Provës mirëpret çdo vit studentë për kryerjen e praktikave mësimore. Në kuadër të praktikave Kombëtare të Punës, SHP kërkon vazhdimisht praktikantë për Degët Territoriale. Me ndryshimet e VKM-së së pagave, përveç rritjes që përfituan kategoritë e specialistëve dhe drejtorëve të Degeve Territoriale, u aplikua edhe shtesa për kushte të veçanta pune. Ndërkohe me kërkesën për ristrukturim, është kërkuar unifikim i pagave për të gjithë specialistët e Degëve Territoriale. Institucioni raporton se mbetet problematikë mungesa e burimeve njerëzore në disa degë territoriale të Shërbimit të Provës.</p>

Për OS 3.4 janë përcaktuar dy tregues performance:

- **% e numrit të vendimeve penale për vepra të dënueshme deri në 5 vjet, të cilat përfshijnë dënime alternative.**

Vlera e synuar për vitin 2023 për këtë tregues të performancës është 67%, dhe llogaritet si raporti i numrit të vendimeve penale për vepra të dënueshme deri në 5 vjet, të cilat përfshijnë dënime alternative, me numrin total të vendimeve penale për vepra të dënueshme deri në 5 vjet. Megjithatë, DPSHP ka raportuar se nuk mban të dhëna mbi gjithë vendimet penale për vepra të dënueshme deri në 5 vjet, dhe mund të raportojë vetëm për numrin e vendimeve penale ku vendoset një dënim alternativ.

Gjatë vitit 2023, DPSHP raportoi se 6679 vendime penale për vepra të dënueshme deri në 5 vjet kanë përfshirë dënime alternative. Këto janë ndarë sipas llojit në tabelën e mëposhtme:

Lloji i dënimeve alternative	Janar - Dhjetor 2023
Neni 59 i KP, Pezullimi	5457
Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi	34
Neni 64 i KP, Lirimi me kusht	89
Neni 63 i KP, Punë në interes publik	1097
Neni 58 i KP, Gjysmëliria	2
Totali	6679

- **Raporti i personave nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës të liruar me kusht (ose forma të tjera të lirimit me kusht), të cilët kanë shërbyer me sukses në shërbimin e provës.**

Ky tregues është i rëndësishëm për matjen e cilësisë së punës së Shërbimit të Provës. Vlera e synuar për vitin 2023 për këtë tregues të performancës është 99%. Për vitin 2023, Shërbimi i Provës raportoi shifrat e mëposhtme në lidhje me të paraburgosurit nën mbikëqyrjen e tyre, të liruar me kusht (ose forma të tjera të lirimit me kusht), të cilët kryen me sukses Shërbimin e Provës. Shifrat u ndanë gjithashtu sipas llojit të lirimit me kusht.

Lloji i dënimeve alternative	Janar - Dhjetor 2023
Neni 59 i KP, Pezullimi	4402
Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi	48
Neni 64 i KP, Lirimi me kusht	187
Neni 63 i KP, Punë në interes publik	1090
Neni 58 i KP, Gjysmëliria	2
Totali	5729

Objektivi Specifik 3.5

Plani i Veprimit për Objektivin 3.5 parashikon 17 masa, prej të cilave **13 masa janë zbatuar plotësisht** dhe 4 masa janë zbatuar pjesërisht. 76.5% e masave janë zbatuar plotësisht.

OS 3.5: Zhvillimi i sistemit penitenciar bazuar në standardet evropiane, që siguron respekt të plotë për burimet njerëzore dhe përdor plane zhvillimi individualë	
3.5.1	<p><i>Kryerja e analizës në lidhje me nevojën për hartimin e legjislacionit/ akteve nënligjore/ rregulloreve sipas ndryshimeve të paketës legjislativive penitenciare. (pz 2021-2021)</i></p> <p>Institucioni raportues: Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p>Informacion mbi zbatimin e masës:</p> <p>Pas kryerjes së analizës, janë hartuar dhe dërguar në Drejtorinë e Kodifikimit të MD, disa akte në zbatim të Ligjit Nr.39/2023, "Për disa ndryshime në Ligjin Nr.80/2020 "Për Policinë e Burgjeve" në lidhje me mbajtjen e armëve të zjarrit në përdorim jashtë orarit të shërbimit dhe për njësimin e gradave në policinë e burgjeve.</p> <p>Gjithashtu, Drejtoria e Kodifikimit ka raportuar se për sa i përket paketës së akteve nënligjore në sistemin penitenciar janë edhe 3 akte nënligjore të pamiratuara në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financat dhe ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë. Kompleksiteti i ofrimit të shërbimit shëndetësor dhe edukimit arsimor në IEVP ka qenë pengesë për miratimin e projektakteve.</p>
3.5.2	<p><i>Hartimi/konsultimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe rregulloreve specifike (Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve/ Kodi i Etikës/Shërbimi i sigurimit/policia e burgjeve/punësimi i të burgosurve) (3 konsultime). (pz 2021-2021)</i></p> <p>Institucioni raportues: Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p>Informacion mbi zbatimin e masës:</p> <p>Zbatuar në vitin 2021 dhe 2022.</p>
3.5.3	<p><i>Përgatitja, konsultimi dhe miratimi i paketës ligjore për kriteret e përzgjedhjes, autorizimin, llogaridhënia dhe detyrimi i drejtuesve të burgjeve dhe menaxherëve të lartë mbështetur në rekomandimet e KE. (pz 2023-2023)</i></p> <p>Institucioni raportues: Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p>Informacion mbi zbatimin e masës:</p> <p>Rregullorja e Personelit e Policisë së Burgjeve është miratuar me VKM Nr.403, datë 09.06.2022, si dhe akte të tjera për rekrutimin e stafit civil. Përzgjedhja e drejtuesve të IEVP-ve parashikohet në Ligjin Nr.81/2020 Për të drejtat dhe trajnimin e të dënuarve me burgim si dhe në Rregulloren e Përgjithshme.</p>
3.5.4	<p><i>Hartimi dhe miratimi i skemës dhe standardeve për (i) mbikëqyrjen e rregullt psikologjike për të gjithë stafin (ii) vlerësimin e performancës për IEVP dhe pilotimi I skemave në 4 IEVP. (pz 2021-2021)</i></p> <p>Institucioni raportues: Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p>Informacion mbi zbatimin e masës:</p> <p>DPB ka hartuar dhe miratuar 3 instrumente për zhvillimin e komponentit të përkujdesjes për mirëqenien e stafit në sistemin penitenciar. Konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none">- "Stresi - ky faktor i heshtur - pjesa I";- "Stresi - ky faktor i heshtur - pjesa II";- "Menaxhimi i Çrregullimit të Stresit Post Traumatik".

	<p>Drejtoria e Çështjeve Sociale në DPB do të vijojë me implementimin e këtyre instrumenteve në nivel sistemi. Janë trajnuar 150 punonjes pjese e stafit të sigurisë.</p> <p>Nuk janë raportuar informacione të tjera mbi vlerësimin e performancës për IEVP.</p>
3.5.5	<p><i>Trajnime të nëpunësve të burgjeve në lidhje me paketën ligjore/nënligjore të miratuar/ skemat dhe standardet e miratuara.</i> (pz 2024-2024)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p><u>Përmbledhja e veprimeve:</u></p> <p>DPB ofron trajnim bazë, për punonjësit e rinj, trajnim në detyrë, trajnim për zhvillim karriere dhe trajnime të tjera specifike. Edhe pse masa do të fillojë zbatueshmerinë në vitin 2024, Drejtoria ka zhvilluar disa trajnime ndaj kjo masë do të konsiderohet si e zbatuar për vitin 2023. Institucioni ka raportuar se gjate vitit 2023 janë trajnuar 40% e punonjësve në detyrë.</p>
3.5.6	<p><i>Përgatitja e një raporti analitik për kushtet e punës në burgje/ identifikimi i problemeve dhe nevojave për përmirësim dhe hartimi i një plani operacional masash në zbatim të gjetjeve të raportit analitik.</i> (pz 2022-2024)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Masa është raportuar si plotësisht e zbatuar në vitin 2022. Nisur nga nevojat, në vitin 2023, është bërë progres në disa çështje që kanë të bëjnë me mbështetjen e punonjësve të policisë së burgjeve në lidhje me transportin (janë shtuar 95 automjete, disa prej të cilave janë vënë në dispozicion të transportit të punonjësve) dhe mbështetjen ekonomike (rritje page për të gjitha nivelet dhe akses në kredi lehtësuese).</p>
3.5.7	<p><i>Përgatitja e moduleve të programeve për parandalimin e recidivizmit (i) për kriminelët seksualë dhe kriminelët e dhunshëm (ii) për personat e varur nga droga,alkooli dhe pilotimi në 8 IEVP.</i> (pz 2021-2021)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Programet e trajnimit për parandalimin e recidivizmit, janë pjesë e kurrikulave të trajnimit. Është kryer një studim me mbështetjen e UNODC dhe strategjitë e reduktimit të recidivizmit të përgatitura do të prezantohen në një konferencë ndërkombëtare në 2024.</p> <p>Në bashkëpunim me organizatën ACCI LifeSkills dhe SHKBSH në kuadër të jetësimit të "Shkolla - Aftësitë për jetën", janë miratuar modulet kognitiv-biheviorale "Dhuna në familje", "Punësimi", "Shkelësit Seksualë" dhe "Ndërgjegjësimi Kognitiv", dhe "Varësia e individëve nga lëndët narkotike". Gjithashtu është miratuar programi social "URA - Drejtësia Restauruese" dhe është hapur "Shkolla - Aftësi për Jetën", me kurrikulen dedikuar për këto target grupe. Implementimi po vijon në burgjet e përzgjedhura.</p>
3.5.8	<p><i>Trajnimi i stafit në lidhje me programet për parandalimin e recidivizmit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Në bashkëpunim me partnerët tanë strategjikë, stafi është trajnuar sipas disiplinave përkatëse në lidhje me programet psiko-edukative për parandalimin e recidivizmit, si dhe metodologjitë relevante që fuqizojnë stafin në këtë kuadër si intervistimi motivues, etj. Fokus të veçantë kanë patur programet për të rinjtë 18-21 vjec, ish-përdorues të lëndëve narkotike, puna mbi parandalimin e radikalizmit, menaxhimin e ekstremistëve të dhunshëm, krimet në familje, dhuna seksuale, etj. Trajnimi i stafit vijon</p>

	<p>dhe institucioni ka raportuar deri në nëntor janë trajnuar 1925 punonjës sipas disiplinave përkatëse.</p> <p>Stafi është trajnuar nga CEO i Institutit ACCI si dhe nga vetë Drejtoria e Çështjeve Sociale si dhe janë trajnuar të gjithë përgjegjësit e sektorit social (dhe jo vetëm), në gjithë sistemin. .</p> <p>Gjithashtu, stafi po trajnohet në lidhje me dhunën në familje, krimet seksuale, lëndet narkotike.</p>
3.5.9	<p><i>Dizenjimi dhe konsolidimi i koncept dokumentit për Strategjinë për përmirësimin e funksionimit të sistemit të burgjeve (plani i masave për arsimimi i të burgosurve/shërbime sociale / planifikimi paralirimi / mbështetje pas lirimit).</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>DPB ka miratuar dokumentin strategjik 'Asistenca post - penale' si një udhërrëfyes mbi procesin e riintegritimit të të burgosurve që lirohen dhe ka miratuar modulën programatik 'Punësimi', për punën ndërmjetesuese të stafit të sektorit social me të burgosur në prag lirim. Gjithashtu është miratuar MoU me bashkinë Tiranë në kuadër të implementimit dhe ekzekutimit të shërbimeve sociale, si dhe materiali procedural "Mekanizmi i Sistemit të Referimit për gratë dhe vajzat në konflikt me ligjin". Ndërkohë është në proces miratimi i marrëveshjes ndër-institucionale që do të ofrojë strukturën e duhur për rritjen e numrit të IEVP-ve ku do të zbatohet arsimi dhe aftësimi profesional. DPB ka hartuar të gjithë dokumentet përkatës në këtë kuadër, pra projekt udhëzimin mbi MoU, projekt MoU, projekt relacionin.</p> <p>Hartimi i projektit “Master Plani i Burgjeve” është finalizuar.</p>
3.5.10	<p><i>Konsultimi/ finalizimi dhe miratimi i planit të veprimit strategjik dhe prezantimi në një tavolinë të rrumbullakët.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës</u></p> <p>DPB dhe MD kanë finalizuar hartimin e projektit “Master Plani i Burgjeve 2023-2028” i cili është prezantuar edhe për partnerët.</p>
3.5.11	<p><i>Hartimi, Konsolidimi dhe finalizimi i memorandumit të bashkëpunimit me MSHMS për kujdesin dhe trajtimin e shkelësve të papërgjegjshëm dhe në kujdesin e pacientëve të dënuar me probleme mendore dhe të atyre në paraburgim dhe memorandum me institucionet e tjera.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>DPB raporton se është miratuar një plan veprimi dhe një urdhër i përbashkët ndërmjet dy ministrive (MD dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale), të cilat janë në zbatim. Memorandumi i bashkëpunimit të MD-së me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për trajtimin e personave me probleme shëndetësore është hartuar në bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i është dërguar për miratim Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Prill 2023.</p>
3.5.12	<p><i>Hartimi, konsultimi dhe miratimi i protokollit për funksionimin e njësive të kujdesit të veçantë në burgje, për sigurimin e një mjedisi më të përshatshëm dhe përgatitjen e udhëzimeve të nevojshme për zbatimin e tij.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Stafi i burgut ka në dispozicion protokolle (udhëzime administrative) në lidhje me menaxhimin e të burgosurve me probleme mendore, procedurat disiplinore, procedurat e mjekimit të detyruar, kufizimet</p>

	<p>fizike etj. Me mbështetjen e Këshillit të Evropës po pilotohet projekti në zbatimin e procedurave standarde të veprimit për të burgosurit me probleme të shëndetit mendor.</p> <p>Udhëzimet administrative për trajtimin e personave me probleme mendore që janë miratuar në vitin 2011, janë në proces rishikimi.</p>
3.5.13	<p><i>Kryerja e analizës së vlerësimit të kuadrit legjislativ, menaxhimit të çështjeve dhe kapaciteteve institucionale për të identifikuar fushat e riskut dhe për të kuptuar dobësitë e sistemit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Në bazë të Urdhërit Nr.1990, datë 21.02.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm është parashikuar hartimi i regjistrimit të riskut, bazuar në burimet e riskut që kërcënojnë sigurinë, të drejtat e të burgosurve, rendin, shëndetin, menaxhimin. Bazuar në regjistrin e riskut janë hartuar planet e veprimit.</p> <p>Aktualisht po kryhet një vlerësim, bazuar në faktorët e riskut dhe të dhënat e tjera me qëllim funksionimin e “burgut të hapur”, si dhe të burgut të sigurisë së ulët.</p>
3.5.14	<p><i>Identifikimi i mjetit të vlerësimit të riskut për tu miratuar në sistemin e burgjeve në Shqipëri dhe pilotimi në 4 IEVP.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Në bashkëpunim të ngushtë me Këshillit të Evropës, DPB është angazhuar në zbatimin e projektit pilot në lidhje me hartimin dhe zbatimin e dokumentit të nevojave dhe vlerësimit të rrezikut i cili tanimë është miratuar. Pilotimi është shtrirë në tre IEVP: "Ali Demi", Fier dhe Peqin dhe procesi do të përfundojë së shpejti. Në vijim të këtij angazhimi, zbatimi i këtij instrumenti do të vijojë në të gjitha IEVP-të dhe stafi do të trajnohet për përdorimin e tij. Masa do të vijojë dhe pritet të përfundojë në periudhën 2024-2025.</p>
3.5.15	<p><i>Konsolidimi dhe finalizimi i dokumentit operacional të brendshëm për procedurat që do të ndiqen në lidhje me regjimet e brendshme, trajtimi individual, programet e disponueshme ose programet që duhet të zhvillohen në kohën kur këta të burgosur do të dërgohen në institucionin e vuajtjes së dënimit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Veprimet operative janë finalizuar me instrumentet përkatëse. Është e nevojshme vetëm integrimi i tyre në një dokument të vetëm për të lehtësuar veprimtarinë në institucion. Në kuadër të projektit, ekspertët e KiE kanë hartuar disa instrumente dhe dokumente të rëndësishme, të cilat përfshijnë: Inventarin e Vlerësimit Dinamik të Riskut dhe Nevojave (për qëllim të planifikimit të individualizuar të Programit të Rehabilitimit dhe jo vlerësimit të rrezikut për arsye sigurie);</p> <p>Dinamik të Riskut dhe Nevojave (me qëllim planifikimin e individualizuar të Programit të Rehabilitimit dhe jo vlerësim risku për arsye sigurie);</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Formulari i Referimit (për shërbimet, në varësi të nevojave të identifikuara gjatë procesit të vlerësimit); ● Formulari i planit të dënimit (veprimet që duhen ndërmarrë, pëlqimi i të dënuarit, aktorët që do të përfshihen, afatet kohore, shpeshësia e shqyrtimit); ● Formulari i rishikimit të planit të dënimit (statusi i veprimeve të planifikuara në planin aktual të dënimit, shqyrtimi i planit/veprimit duke ndjekur të njëjtën procedurë si hartimi fillestar i tyre); ● Raporti i Progresit për Rishikimin e Planit të Dënimit nga agjencitë mbështetëse të shërbimit që

	<p>ofrojnë shërbime për punonjësin psiko-social të burgut;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Urdhëri Nr.109/2024 Per rikategorizim dhe riklasifikimin e te burgosurve te sigurise se larte ne tre nivele, baze, standart dhe te zgjeruar, me qellim pershtatjen e regjimeve sipas nivelit te sigurise. • Raportimi i personelit psiko-social mbi sjelljen e të dënuarit në njësinë akomoduese. <p>Dokumentet e sipërpërmendur janë miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm dhe janë ndarë me stafin për zbatim.</p>
3.5.16	<p>Trajnime të nëpunësve të sistemit të burgjeve për të rritur performancën e tyre në sistem lidhur me (i) Funksionimi e njërive të kujdesit të posaçëm në rrugë(ii) analizën / vlerësimin e rrishtut (iii) kuadrin ligjor/nënligjor në fuqi. (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Trajnimi i punonjësve konsiderohet si prioritet nga DPB-ja, për rritjen e standardeve të shërbimit ndaj shkelësve dhe publikut, si dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Gjatë vitit 2023 janë trajnuar 905 punonjës të të gjitha niveleve mbi tema të ndryshme. Një nga trajnimet e zhvilluara ishte edhe drejtimi i regjimit special, ku u trajnuan 25 punonjës të IEVP-së, me një program një javor me mbështetjen e OSBE-së dhe ekspertëve italianë të lidhur me regjimin special.</p> <p>Seksionet e Kujdesit të Veçantë do të rinovohen dhe strukturohen sipas edhe kapaciteteve të burimeve njerëzore të shërbimit shëndetësor. Janë ndërmarre disa trajnime lidhur me rritjen e kapaciteteve me mbështetjen e KE dhe këtë vit jane planifikuar trajnime të tjera.</p>
3.5.17	<p>Konsolidimi dhe përmirësimi i mekanizmave ndërinstitutional për adresimin e Shkelësve Ekstremist të Dhunshëm (1-7 mbledhje koordinimi). (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me mbështetjen/ekspertizën e siguruar nga Këshilli i Evropës në kuadër të projektit rajonal për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm në sistemin penitenciar të vendeve të Ballkanit Perëndimor - “Rritja e kapaciteteve të sistemit penitenciar në adresimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në burgje në vendet e Ballkanit Perëndimor” ka miratuar përmes Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 829 Prot, datë 26.05.2023 “Për fuqizimin e shërbimit psiko-social në kuadër të punës rehabilituese me të burgosur të radikalizuar dhe ekstremistë të dhunshëm”, dokumentet si vjon:</p> <p>Instrumenti Nr.1: Metodologjia për rehabilitimin e të burgosurve të radikalizuar në Shqipëri,</p> <p>Instrumenti Nr. 2: Vlerësimi dhe klasifikimi i nevojave për rrezikun terrorist dhe ekstremist,</p> <p>Instrumenti Nr. 3: Udhëzues përdorimi - Vlerësimi dhe klasifikimi i nevojave për rrezikun terrorist dhe ekstremist.</p> <p>Instrumenti Nr. 4: Udhëzimet e praktikuesve për parandalimin e radikalizmit në shërbimin e burgjeve në Shqipëri,</p> <p>Instrumenti Nr. 5: Mjeti bazë i shqyrtimit për identifikimin e sjelljes ekstremiste të dhunshme,</p> <p>Instrumenti Nr. 6. Instrumenti për vlerësimin e rrezikut dhe Nevojave specifike të VEP.</p> <p>Instrumenti Nr.7: Lista e kontrollit të shenjave të radikalizmit,</p> <p>Gjithashtu, DPB në bashkëpunim me CVE dhe Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social – ka zhvilluar forume ndërinstitutionale me pjesëmarrës nga agjenci të ndryshme, në kuadër të nxitjes së bashkëpunimit me qëllim rintegrimin e këtij target grupi.</p> <p>Në vijim në bashkëpunim me Këshillin e Evropës do të vijohet me hartimin e tërë gamës së</p>

	instrumenteve dhe procedurave standarde të veprimit dhe ndërverimit ndërinstitucional për këtë target grup.
--	---

Për OS 3.5 është përcaktuar një tregues performance:

➤ **Raporti i personave me numrin e shtretërve, p.sh. si masë e mbipopullimit të burgjeve.**

Në kuadër të zhvillimit të një sistemi penitenciar të bazuar në standardet evropiane, që garanton respektimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe zbaton plane individuale zhvillimi, treguesi mat nivelin e mbipopullimit në burgje. Ai synon uljen graduale të raportit të numrit të personave që vuajnë dënimin në I EVP dhe numrit të shtretërve, i cili në çdo rast duhet të jetë më i ulët se 100% (tregues me trend në rënie).


Vlera e synuar për këtë tregues të performancës në 2023 është 82%, e cila kërkon që 18% të shtretërve të jenë të lirë, për të akomoduar hyrjet e reja. Për vitin 2023, DPB-ja raportoi se aktualisht janë 2.6 % mbi kapacitetin e tyre, gjë e cila është shqetësuese sepse sistemi është në mbipopullim. Megjithatë, duhet konsideruar se ky tregues ndryshon vazhdimisht dhe është i lidhur ngushtë me hyrjet e reja në institucione dhe infrastrukturën aktuale të sistemit. Staf i përkushtuar menaxhon vazhdimisht çështjen e mbipopullimit nëpërmjet masave organizative dhe proceseve të transferimit.

2.4. Qëllimi i Katërt i Politikës


Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucionet e sektorit.

Qëllimi i Katërt i Politikës: 39 masa

36 masa të zbatueshme në 2023



- Plotësisht të zbatuara
- Pjesërisht të zbatuara
- Të pazbatuara



Është parashikuar një (1) tregues në nivelin e Qëllimit të Katërt të Politikës:

➤ ***Numri i akteve ligjore të BE-së të harmonizuara siç duhet me *acquis* (kapitulli 23)***

Vlera e synuar e treguesit të performancës për vitin 2023 është 5 akte të harmonizuara me *acquis* të BE-së. Nga informacionet e raportuara nuk ka pasur akte të harmonizuara në periudhën raportuese. Procesi i harmonizimit të KP dhe KPrC është në vazhdim.

Objektivi Specifik 4.1.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.1 parashikon 15 masa, prej të cilave 12 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 3 masa rezultojnë të pazbatueshme (me ngjyrë të bardhë, shih metodologjinë). 50% e masave (të zbatueshme) janë zbatuar plotësisht.

OS 4.1: Zhvillimi i plotë i sistemit të integruar të drejtësisë elektronike (e-drejtësia) me identifikues të unifikuar, i sistemeve të menaxhimit të çështjeve të përditësuara, regjistrimit elektronik të bazuar në internet për të treja fushat (penale, administrative, civile) dhe lidhjeve me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare.

4.1.1	<p><i>Dizenjimi i programit të digjitalizimit të institucioneve të drejtësisë.</i> (pz 2021-2022)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Me vendimin nr. 5, datë 15.06.2023, Bordi drejtues i QTI-së miratoi ngritjen e grupit ndërinstitutional të punës për hartimin e Udhërrëfyesit, për Digjitalizimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri. Udhërrëfyesi do të përcaktojë kostot, afatet kohore dhe hapat konkrete për finalizimin e sistemit të ri të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve si dhe ndërveprimin midis komponentëve të sistemit të drejtësisë dhe sistemeve të institucioneve qeveritare dhe të tjera publike dhe private në shërbim të publikut.</p> <p>Afati i dorëzimit të këtij dokumenti ishte dhjetor 2023, por për shkak të volumit të draftit paraprak, rëndësisë dhe marrjes së kontributit dhe dakordësisë nga të gjithë aktorët e përfshirë në këtë grup pune (QTI, KLGJ, KLP, ILD, PP, SHM, përfaqësues nga UNOPS dhe ekspert të jashtëm), ky afat është shtyrë në shkurt 2024.</p> <p>Gjatë vitit 2023, KLGJ ka paraqitur informacion të detajuar për sistemin dhe dokumente mbështetëse pranë MFE-së si dhe Këshillit të Ministrave, duke kërkuar lirim të fondeve buxhetore dhe pasqyrimin e tyre në sistemin e thesarit, për grupin buxhetor "KLGJ". Në lidhje me këtë situatë MEF-i nuk i është përgjigjur kërkesës sonë dhe fondet për periudhën e raportimit janar - dhjetor kanë qënë të bllokuara. KLGJ në kuadër të krijimit të një ICMIS të ri për sistemin gjyqësor, ka rënë dakord për një projekt-marrëveshje (ndërinstitutionale) me Qeverinë Suedeze të përfaqësuar nga Agjencia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar (SIDA). Sipas kësaj Marrëveshjeje, SIDA do të mbështesë duke financuar pjesërisht (nëpërmjet një granti) zbatimin e një ICMIS të ri, i cili plotëson vlerën e plotë të projektit ICMI. Për këtë qëllim, në përputhje me kornizën ligjore, kjo Marrëveshje Projekti duhet të vlerësohet nga Ministria për Evropën dhe Punë të Jashtme (MEP) dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MEF). Deri më sot nuk ka ende një përgjigje nga MFE-ja, përkundër rikujtesave të vazhdueshme të dërguara nga KLGJ.</p>
4.1.2	<p><i>Ngritja dhe zbatimi i programit të sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykata/KLGJ/KLP/ILD.</i> (pz 2021-2023)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>KLGJ raporton se ka përmbushur me sukses, fazën e parë të zhvillimit të sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve, duke finalizuar miratimin e akteve rregullatore nga Bordi Drejtues i QTI, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none">- Udhërrëfyesi për zhvillimin e Sistemit të ri të Menaxhimit të Çështjeve;- Kërkesat e Biznesit për zhvillimin e Sistemit të ri të Menaxhimit të Çështjeve;- Kërkesat për ngritjen e infrastrukturës mbështetëse për hostimin e Sistemit të ri të

	<p>Menaxhimit të Çështjeve ICMIS;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dokumenti teknik për standardet e dizenjimit dhe standartet për specifikimet teknike të sistemit të ri informatik ICMIS. <p>KLGJ ka ngritur infrastrukturën e re fizike (implementimi i serverit dhe storage).</p> <p>Ndërkohë, lidhur me institucionet e tjera objekt raportimi, gjatë kësaj periudhe, QTI nuk ka administruar kërkesa për ngritjen dhe zbatimin e sistemeve të reja nga këto institucione. Këshilli i Lartë Gjyqësor shpreh angazhimin për të vijuar zbatimin e kësaj mase.</p>
4.1.3	<p><i>Përmirësimi i qendrës së përpunimit të të dhënave.</i> (pz 2022-2022)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>QTI, në bazë të pikës 5, të VKM nr. 972, datë 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”, nuk ka akses të drejtpërdrejt në sistemet e teknologjisë së informacionit të institucioneve të sistemit të drejtësisë. Në këto kushte nuk disponon qendër për përpunimin e të dhënave. Masa është e pazbatueshme për këtë institucion.</p>
4.1.4	<p><i>Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në gjykata.</i> (pz 2022-2023)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>QTI dhe KLGJ raportojnë se gjatë periudhës së raportimit, janë kryer zhvillimet e nevojshme në sistemin e menaxhimit të çështjeve ICMIS ekzistues, dhe ka përfunduar migrimi ose transferimi i të gjithë bazës së të dhënave të gjykatave të riorganizuar në kuadër të hartës së re gjyqësore, në zbatim të VKM-së Nr. 495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” është ngritur infrastruktura e re fizike (implementimi i serverit dhe storage). Gjithashtu, janë kryer konfigurimet në portalin www.gjykata.gov.al, me qëllim pasqyrimin e informacioneve që lidhen me veprimtarinë e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të cilat janë online nga data 01.02.2023.</p>
4.1.5	<p><i>Përshtatja e politikave dhe procedurave të teknologjisë së informacionit dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit të teknologjisë së informacionit në organet e sistemit të drejtësisë.</i> (pz 2022-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>KLGJ raporton se gjatë vitit 2023, QTI ka vazhduar të plotësohet me specialistë dhe mbeten për t’u rekrutuar edhe 2 specialistë të tjerë, për të finalizuar në këtë mënyrë plotësimin e strukturës së Qendrës. Ndërkohë për çdo projekt zhvillimi, çdo institucion i sistemit të drejtësisë harton programe trajnimi dhe garanton dokumentimin e këtyre kurrikulave në manuale përdorimi të brendshëm. Konkretisht gjatë vitit 2023 KLGJ ka kryer programe trajnimi periodike për të gjithë përdoruesit e gjykatës si dhe ka përgatitur manuale përdorimi konkrete për rastet e nevojshme. Me qëllim përmbushjen e kësaj pike nga stafi i Qendrës, nevojitet pikë së pari miratimi i Udhërrëfyesit ndërinstytucional për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë. Ky Udhërrëfyes përcakton Plan Veprimin dhe hapat administrativë dhe teknik, për një zhvillim gradual dhe udhëheqje eficiente të projektit.</p> <p>Prokurori i Përgjithshëm raporton që janë hartuar specifikime teknike të pajisjeve informatike, dheb politika sigurie për dhomat e serverave.</p>
4.1.6	<p><i>Projektimi, zhvillimi dhe instalimi i bazës së të dhënave.</i> (pz 2021-2023)</p>

	<p><u>Institucioni raportues:</u> Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Duke marrë parasysh që Udhërrëfyesi Ndërinstitucional për Digjitalizimin e Sistemit të Drejtësisë nuk është miratuar ende, zbatimi i kësaj mase lidhur me bazën e të dhënave për sistemin e ri të integruar të menaxhimit të çështjeve, pritet të nisë në një fazë të mëvonshme.</p> <p>Për sa i përket projektimit, zhvillimit dhe instalimit të bazës së të dhënave për sistemin e Organizatave Jo Fitimprurëse (OJF), Këshilli i Lartë Gjyqësor raporton se i ka zbatuar këto faza me sukses. KLGJ ka përfunduar transferimin e sistemeve të instaluar në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe ka kryer konfigurimet e nevojshme të këtyre sistemeve dhe bazave të të dhënave në infrastrukturën e Disaster Recovery. Ky proces është kryer pa e ndërprere aksesin në portalet dhe sistemet online me të cilat operojnë gjykatat. Procesi i digjitalizimit të dosjeve të OJF-ve ka përfunduar në masën 80%.</p> <p>Ndërkohë institucionet e tjera objekt raportimi nuk kanë zhvilluar ende sisteme të reja. Gjithashtu raportohet se regjistri i OJF-ve i hostuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është funksional nga pikëpamja teknike dhe është duke u përditësuar me materialet e digjitalizara, të arkivës së regjistrit kombëtar të Organizatave Jo Fitimprurëse.</p> <p>KLJGJ gjatë vitit 2023 ka kryer zhvillimet e nevojshme me qëllim garantimin e procesit të ndërveprimit me institucionet të përfshira në proces, dhe është në pritje të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për miratimin e protokollit të komunikimit midis regjistrit elektronik të OJF-ve dhe QKB.</p>
4.1.7	<p><i>Ngritja e sistemit të menaxhimit të çështjeve të prokurorisë me standardet aktuale teknologjike e legjislative dhe mirëmbajtja e softëare-t të sistemit.</i> (pz 2021-2023)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Për realizimin e kësaj mase, QTI miratoi vendimin nr. 5 datë 15.06.2023 me anë të të cilit u krijua grupi ndërinstitucional i punës që do të hartojë udhëzuesin për dixhitalizimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Gjatë 6-mujorit të dytë të 2023 QTI ka draftuar Udhërrëfyesin ndërinstitucional për menaxhimin e çështjeve, ku ndër të tjera është parashikuar ngritja e një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve për prokuroritë. Në Udhërrëfyes, prokuroritë (aty të përfaqësuara nga Prokuroria e Përgjithshme) janë projektuar si përdorues të brendshëm të sistemit të integruar ICMS.</p>
4.1.8	<p><i>Mirëmbajtja për sistemin e menaxhimit të çështjeve për gjykatat/PP/KLP/KLGJ/ILD.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Gjatë periudhës së raportimit, nuk ka patur zhvillime të sistemeve të reja të menaxhimit të çështjeve nga institucionet objekt raportimi. Ndërkohë, institucionet, kryejnë mirëmbajtjen e sistemeve ekzistuese çdo vit, nëpërmjet kontratave të mirëmbajtjes.</p> <p>Mirëmbajtja e sistemit CAMS do të trajtohet gjatë fazës së zhvillimit të këtij sistemi, duke marrë në konsideratë modulet që do përfshijë, gjuhën e programimit etj.</p>
4.1.9	<p><i>Përgatitja e paketës ligjore të nevojshme për funksionimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Lidhur me këtë masë, nuk janë propozuar ndryshime ligjore të nevojshme për funksionimin e</p>

	Qendrës së Teknologjisë së Informacionit.
4.1.10	<p><i>Ngritja e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit të Sistemit të Drejtësisë dhe sigurimi i mbështetjes së nevojshme për funksionalizimin e veprimtarisë së saj.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Gjatë gjithë periudhës raportuese, Bordi Drejtues i QTI miratoi gjithsej 5 vendime që i nënshtrohen kësaj mase. Konkretisht:</p> <p>Vendimi nr.1, datë 30.01.2023 “Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit Drejtues të Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”</p> <p>Vendimi nr.2, datë 26.04.2023 “Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”</p> <p>Vendimi nr.3, datë 26.04.2023. “Për miratimin e kërkesave buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024 - 2026 të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë (Faza e Parë)”</p> <p>Vendimi nr.4, datë 15.06.2023 “Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes. i Bordit Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”</p> <p>Vendimi nr.5, datë 15.06.2023 “Për krijimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës, për hartimin e Udhëzuesit për Dixhitalizimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”.</p> <p>Në vijim të VKM-së Nr. 972, datë 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”, KLGJ ka rekrutuar 3 (tre) specialistë, nga 5 (pesë) vakanca në strukturën e Qendrës, pas vendimit të Bordit të QTI për strukturën dhe emërimin e Drejtorit Ekzekutiv në vitin 2021.</p>
4.1.11	<p><i>Trajnimi i trupës gjyqësore/prokurorë/inspektorë dhe i stafit administrativ mbi përdorimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Kjo masë aplikohet pas prokurimit dhe implementimit të sistemit të ri ICMS.</p>
4.1.12	<p><i>Hartimi dhe miratimi i planit strategjik për teknologjinë e informacionit në gjykata dhe institucionet e drejtësisë.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>KLJGJ raporton se zbatimi i kësaj mase pritet të nisë në një fazë të mëvonshme pas miratimit të Udhërrëfyesit Ndërinstitucional për Digjitalizimin e Sistemit të Drejtësisë.</p>
4.1.13	<p><i>Investime dhe mirëmbajtje për sistemin e menaxhimit të çështjeve dhe pajisjet dhe software-t respektive për gjykatat /KLP-në/KLGJ-në/ILD-në.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Mirëmbajtja e sistemeve dhe pajisjeve në institucionet e sistemit të drejtësisë kryhet nga institucioni që zotëron aktualisht sistemet. Marrëveshjet e mirëmbajtjes respektojnë afatet e përcaktuara në kontratat ekzistuese.</p>
4.1.14	<p><i>Investime dhe mirëmbajtje për sistemin e menaxhimit të çështjeve dhe pajisjet dhe softuerin</i></p>

	<p><i>përkatës për Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet në varësi të saj. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Masa do të konsiderohet e zbatuar pjesërisht edhe pse sistemi i ri i menaxhimit të çështjeve nuk është krijuar ende. Megjithatë, është siguruar investimi për mirëmbajtjen e sistemeve ekzistuese të menaxhimit të çështjeve.</p>
4.1.15	<p><i>Mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të çështjeve të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Kjo masë do të nisë të zbatohet në një fazë të mëvonshme, pasi të miratohet Udhërrëfyesi Ndërinstitucional për Digjitalizimin e Sistemit të Drejtësisë. Sidoqoftë masa konsiderohet e zbatuar pjesërisht pasi është garantuar mirëmbajtja e sistemeve ekzistuese të menaxhimit të çështjeve.</p>

Për OS 4.1 janë përcaktuar dy tregues performance:

➤ **% e gjykatave/prokurorive për të cilat sistemi i ri i menaxhimit të çështjeve është ngritur dhe funksionon me kapacitet të plotë**

QTI raportoi se kishte arritur objektivin e përcaktuar në Pasaportën e Indikatorëve prej 5% në vitin 2023. Në veçanti, QTI i referohet Vendimit Nr. 5, datë 15.06.2023, ku Bordi Drejtues i QTI miratoi krijimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e Udhërrëfyesit për dixhitalizimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Udhërrëfyesi do të përcaktojë kostot, afatet kohore dhe hapat konkretë për finalizimin e Sistemit të ri të Menaxhimit të Integruar të Çështjeve (ICMS), si dhe ndërveprimin ndërmjet komponentëve të sistemit të drejtësisë dhe sistemeve të qeverisë dhe institucioneve të tjera publike dhe private në shërbimin publik. Ky dokument pritet të finalizohet në 6-mujorin e parë të vitit 2024.

➤ **% e trupës gjyqësore/prokurorë/inspektorë dhe i stafit administrativ të trajnuar mbi përdorimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve**

Vlera e synuar e këtij treguesi për vitin 2023 është 5%. Duke qenë se Udhërrëfyesi për dixhitalizimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri është hartuar por ende nuk është miratuar, nuk është bërë asnjë progres në lidhje me trajnimin e stafit. Nuk ka qenë e mundur të matet ky tregues për periudhën raportuese.

Objektivi Specifik 4.2.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.2 parashikon 10 masa, prej të cilave **6 masa janë zbatuar plotësisht**, **1 masë janë zbatuar pjesërisht**, dhe **3 masa rezultojnë të pazbatuara**. 60% e masave janë zbatuar plotësisht.

OS 4.2: Përmirësimi i koordinimit, menaxhimit të performancës dhe sistemeve të komunikimit përmes metodologjisë IPSIS.	
4.2.1	<p><i>Funksionimi i plotë dhe marrja e masave për trajnime të vazhdueshme për sekretariatet teknike dhe grupet tematike në sektorin e drejtësisë në zbatim të mekanizmit GMIP-së. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/KM</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Sipas Urdhërit Nr.90 datë 01.08.2023 të Kryeministrit “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe riorganizimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar” mekanizmat ndërsektorial tanimë funksionojnë mbi bazën e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës(GNP).</p> <p>Përgjatë kësaj periudhe, kapacitetet e Sekretariatit Teknik dhe Grupeve Ndërinstitucionale të Punës janë rritur nëpërmjet trajnimeve të zhvilluara nga projekti JUSTAL.</p>
4.2.2	<p><i>Kryerja e analizës së thelluar të përputhshmërisë të kuadrit strategjik/ kapaciteteve institucionale të sektorit të drejtësisë me standardet IPSIS. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/KM</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p>
4.2.3	<p><i>Trajnimi i sektorit të politikave dhe planifikimit strategjik në zbatim të Planit Kombëtar të të dhënave sistematike (NSDP 2020-2017) dhe IPSIS. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Janë zhvilluar disa trajnime nga IPSIS në vitin 2021.</p>
4.2.4	<p><i>Kryerja e analizës së boshllëkut të statistikave të sektorit të Drejtësisë dhe propozimi i planit të përmirësimit në përputhje me NSDP. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Për periudhën raportuese nuk ka patur zhvillime.</p>
4.2.5	<p><i>Trajnime të kapaciteteve të sektorit të statistikave për rritjen e performancës së tyre. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/KM</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave në kuadër të ngritjes së kapaciteteve ka ndjekur sistematikisht kurset Online nga ASPA, për ato tema që janë pjesë e fushës së veprimtarisë së këtij sektori. Sektori ka marrë gjithashtu pjesë në një sërë trajnimesh dhe workshope të zhvilluar nga projekti JUSTAL.</p>
4.2.6	<p><i>Ndërmarrja e studimit të perceptimit të krimit dhe përdorimi si kontribut në programin e parandalimit dhe rishikimin e politikave dhe legjislacionit penal. (pz 2021-2025)</i></p>

	<p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Nuk ka informacion.</p>
4.2.7	<p><i>Kryerja e sondazheve të rregullta vjetore të perceptimit të aksesit në drejtësi, sondazhet e përdoruesve të gjykatave.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>KLGGJ raporton se në datë 17 nëntor 2023, në qytetin e Vlorës, Këshilli i Lartë Gjyqësor prezantoi sistemin e ri online për matjen e cilësisë të shërbimeve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nëpërmjet anketave të përdoruesve të gjykatës. Matja e kënaqësisë së përdoruesve të gjykatës, në lidhje me aspektet kyçe të shërbimit të drejtësisë, synon të rrisë përgjegjshmërinë dhe reagimin e administratës të gjykatës, si dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Më herët, në vitin 2022 ky sistem u lancua fillimisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për të cilin në periudhën e parë të vitit 2023, KLGGJ nxori dhe analizoi rezultatet e para të këtij pyetësori të zhvilluar online në këtë gjykatë. Rezultatet kryesore të pyetësorit të mbledhura gjatë vitit 2022 dhe analizuar gjatë vitit 2023, treguan vlerësim pozitiv në lidhje me aksesin në ambientet e gjykatës, kushte të mira të pritjes së palëve, akses të lehtë, të shpejtë, dhe më cilësi të lartë të informacionit nga ana e qytetarëve, etj. Rezultatet e këtij sondazhi janë raportuar edhe ne Raportin Vjetor të vitit 2022 të KLGGJ, i publikuar në vitin 2023.</p>
4.2.8	<p><i>Ndërmarrja e vlerësimit të pavarur të komunikimit dhe transparencës në sektorin e drejtësisë dhe zhvillimi i planit të përmirësimit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Përgjatë 2023 Ministria e Drejtësisë është mbështetur nga projekti JUSTAL për hartimin e strategjisë së komunikimit dhe konceptimin e planit të veprimit vjetor në fushën e drejtësisë, e cila u aprovua me urdhërin e Ministrit të Drejtësisë Nr. 723 datë 28.12.2023.</p> <p>Për më tej janë ndërmarrë një sërë iniciativash për të përmirësuar komunikimin dhe transparencën e veprimtarisë së Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë si përgatitja e një buletini informativ mujor duke filluar nga Marsi 2023, i cili është shpërndarë rregullisht në mënyrë elektronike si dhe është publikuar në faqen web të Ministrisë së Drejtësisë.</p> <p>Përmbledhja ekzekutive e raportit të monitorimit të SND-së për 2023 për herë të parë u konceptua në formën e një flyer, si dhe Ministria e Drejtësisë ka punuar sëbashku me JUSTAL për të prodhuar dy publikime, një me qëllim unifikimin e stilit të raportimit në fushën e drejtësisë dhe i dyti është një përditësim i manualit për hartimin e legjislacionit.</p> <p>Gjithashtu në kuadër të strategjisë së re për mbrojtjen e viktimave të krimit në 2023 është punuar për të konceptuar një plan komunikimi. Më 20 shkurt 2023 u organizua një aktivitet ndërgjegjësues për të informuar mbi fillimin e punës rreth kësaj strategjie, i cili vijoi me tryeza konsultative me eksperte dhe shoqërinë civile. Në tetor të 2023 Ministria e Drejtësisë dhe JUSTAL kanë bashkëpunuar për konceptimin e një jave ndërgjegjësuese për mbrojtjen e viktimave të krimit në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe shoqërinë civile.</p>
4.2.9	<p><i>Hartimi i planit të zhvillimit të kapaciteteve dhe mbështetja e institucioneve të sektorit në zhvillimin e kapaciteteve të tyre të komunikimit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p>

	<p>Me mbështetjen e JUSTAL, MD përfundoi aktivitetet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngritja e kapacitetit në komunikim (3 punëtori/<i>workshops</i> me përfaqësues të institucioneve në varësi të MD, mbi zhvillimin e strategjive dhe planeve të komunikimit) • Mbështetje për SHM në hartimin e një strategjie komunikimi për rekrutimin e magjistratëve të rinj për vitin 2023
4.2.10	<p><i>Ndërmarrja e sondazhit mbi kënaqësinë dhe perceptimin e cilësisë së komunikimit dhe transparencës në sektor.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Masa konsiderohet e pazbatuar për periudhën raportuese.</p>

Për OS 4.2 janë përcaktuar dy tregues performance:

➤ **% e kuadrit strategjik të sistemit të drejtësisë të populluar në sistemin IPSIS.**

Sikurse u theksua në periudhën e mëparshme raportuese, sistemi IPSIS nuk është aktualisht operativ.

➤ **% e përdoruesve të sistemit të trajnuar lidhur me standardet e performancës të sistemit IPSIS**

Vlera e synuar për vitin 2023 për këtë tregues është 100% por sistemi IPSIS nuk funksionon aktualisht.

Objektivi Specifik 4.3.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.3 parashikon 6 masa, prej të cilave **4 masa janë zbatuar plotësisht** dhe **2 masa janë zbatuar pjesërisht**. 66.6% e masave janë zbatuar plotësisht.

OS 4.3: Zhvillimi i kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe rritja e mbështetjes së saj për institucionet e saj të varësisë.	
4.3.1	<p><i>Kryerja e vlerësimit të nevojës për përmirësimin e kornizës ligjore dhe rregullatore të Ministrisë së Drejtësisë.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Gjatë vitit 2023 është kryer analiza e nevojës për përmirësimin e kornizës ligjore dhe rregullatore të Ministrisë së Drejtësisë dhe më pas është miratuar rregullorja e re e MD me urdhrin me nr. 746 date 29.12.2023 të Ministrit të Drejtësisë.</p>
4.3.2	<p><i>Hartimi dhe zbatimi i planit strategjik dhe të zhvillimit të kapaciteteve të përmbauesve gjyqësorë shtetërorë (trajnimi).</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar trajnime për përmbauesit shtetërorë.</p>
4.3.3	<p><i>Trajnime për përmirësimin e aftësive të menaxhimit të burimeve njerëzore.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Bazuar në Kalendarin Vjetor të Trajnimeve të organizuar nga ASPA, tetë specialistë të Sektorit të Burimeve Njerëzore morën pjesë në trajnimin "Menaxhimi i Burimeve Njerëzore".</p> <p>Për 6-mujorin e dytë të vitit 2023 bazuar në Kalendarin Vjetor të trajnimeve të organizuara nga ASPA, tre specialistë të Sektorit të Burimeve Njerëzore kanë marrë pjesë në Trajnimin "Menaxhimi i Burimeve Njerëzore".</p>
4.3.4	<p><i>Kryerja e analizës së situatën e kontrollit të brendshëm financiar në shërbimin e burgut, përfshirë kontrollin e brendshëm të MD-së për mbikëqyrjen e njësisë dhe përgatitja e një vlerësimi të detajuar të rrezikut në lidhje me administrimin financiar në burgje.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>DPB është audituar nga KLSH për efektivitetin financiar dhe performancën dhe bazuar në gjetjet janë hartuar planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Gjithashtu Sistemi i burgjeve inspektohet nga SHKBB dhe Auditi i brendshëm, periodikisht me tematikë të caktuar ose sipas rasteve të evidentuara. Lidhur me vlerësimin e burimeve të riskut në aspektin e menaxhimit financiar Drejtoria e Financës ka hartuar regjistrin e riskut.</p>
4.3.5	<p><i>Kryerja e analizës së rishikimit të kornizës aktuale organizative dhe ligjore për inspektimet e burgjeve në funksion të praktikave evropiane.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë/ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>DPB raporton se gjatë fillimit të vitit 2023 struktura përgjegjëse për monitorimin e burgjeve ka kryer</p>

	<p>inspektime tematike pranë IEVP-ve dhe DPB-së duke zbatuar legjislacionin në fuqi për inspektimet. Në përfundim të këtyre inspektimeve është përgatitur raporti përkatës sipas legjislacionit në fuqi për njohje dhe miratim nga Ministri i Drejtësisë. Gjatë gjysmës së dytë të vitit DPB raporton se ne strukturën organike të saj ka miratuar krijimin e Drejtorise së Inspektimit me 4+1 punonjes të cilet kanë si mision përsosor inspektimin për zbatimin e ligjshmerise dhe të respektimit të të drejtave të burgosurve.</p>
4.3.6	<p><i>Përgatitja e raporteve të inspektimit të përmbauesve/noterëve bazuar në metodologjitë e miratuara.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>NMe urdhrin nr. 129, datë 31.01.2023 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e programit vjetor të inspektimit të përmbauesve gjyqësorë privatë për vitin 2023”, është vendosur kryerja e jo më pak se 15 inspektimeve për përmbaues gjyqësor privat. Në zbatim të këtij urdhri, për periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë realizuar 14 inspektime të përgjithshme dhe 7 të posaçme. Inspektimet e përgjithshme janë në proces verifikimi dhe hartim raporti nga Struktura përgjegjëse.</p> <p>Disa nga masat e marra janë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 2 heqje licence • 5 pezullime licence <p>Në zbatim të Urdhrit nr. 86, datë 25.01.2023 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e programit vjetor të inspektimit të noterëve për vitin 2023”, është vendosur kryerja e inspektimit e jo më pak se 30 noterë. Në zbatim të këtij urdhri, për periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë kryer 35 inspektime të përgjithshme dhe 4 inspektime të posaçme për noterë.</p> <p>Disa nga masat e vendosura për noterët gjatë vitit 2023 janë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 7 masa për heqje përfundimtare të licencës; • 4 pezullime; • 7 masa paralajmërimi të shoqëruara me gjobë. <p>Problemet e konstatuara kryesisht gjatë kryerjes së inspektimeve për noterët hasen në përpilimin e akteve noteriale, si kontratat e shitjes së pasurive të paluajtshme, mosrealizimi i verifikimit të pasurisë nëse është e lirë përpara se të tjetërsohet, dëshmitë e trashëgimisë apo mungesat e raportimeve në ish-DPPPP kur është rasti. Gjatë kryerjes së inspektimeve pranë përmbauesve gjyqësor privat janë konstatuar parregullsi në kryerjen e procedurave të zhvillimit të ankandëve, mosevidentimi i të gjithë veprimeve përmbauesve, si dhe mungesa e dokumentacionit për marrjen dijeni nga palët në proces për të gjitha fazat e zhvillimit të procedurës përmbauesve.</p>

Për OS 4.3 janë përcaktuar tre tregues performance:

- **% e punonjësve të administratës së burimeve njerëzore të MD-së dhe institucioneve të varësisë të trajnuar lidhur me aftësitë menaxheriale dhe koordinuese.**

Ky tregues synon të masë cilësinë e punës së burimeve njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve në varësi të saj. Vlera e synuar e treguesit për vitin 2023 është 9%. Përderisa nuk ishte e mundur të merren të dhëna për llogaritjen e objektivit, vlen të përmendet se në periudhën raportuese, stafi i MD (nga drejtori të ndryshme) ka marrë pjesë në 61 *workshops*, seminare, takime pune, trajnime, me një pjesëmarrje mesatare prej 21 pjesëmarrësish.

➤ **% e punonjësve të MD-së të trajnuar në fushën e inspektimit**

Treguesi është krijuar në kuadër të forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore në fushën e inspektimit në MD. Vlera e synuar e treguesit për vitin 2023 është 11%, por për periudhën raportuese nuk ka asnjë punonjës të trajnuar në këtë fushë.

➤ **% e inspektimeve të kërkuara ligjërisht për noterët publikë të kryera nga MD**

Ky tregues synon matjen e cilësisë së punës së kryer nga Ministria e Drejtësisë. Vlera e synuar e treguesit të performancës për vitin 2023 është 25% e planifikimit nga institucioni.

Me Urdhër nr. 86, datë 25.01.2023 të Ministrit të Drejtësisë, për vitin 2023 janë planifikuar të kryhen 30 inspektime të përgjithshme për noterët. Për noterët janë kryer 35 inspektime te përgjithshme dhe 4 inspektime te posaçme, pra objektivi është arritur me sukses dhe është tejkaluar.

Objektivi Specifik 4.4.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.4 parashikon 8 masa, prej të cilave **8 masa janë zbatuar plotësisht**. 100% e masave janë zbatuar plotësisht.

OS 4.4: Përditësimi i kuadrit ligjor dhe kapaciteteve të MD-së dhe përmirësimet në fushën e bashkëpunimit ligjor ndërkombëtar dhe përgatitja e Shqipërisë për anëtarësimin në BE me anë të harmonizimit të legjislacionit shqiptar me <i>acquis-in</i> e BE dhe aktet e tjera të integritimit me BE dhe shtetet anëtare në fushën e drejtësisë.	
4.4.1	<p><i>Përgatitja, konsultimi dhe miratimi i paketës ligjore në lidhje me rishikimin e ligjit për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Zbatuar në vitin 2021.</p>
4.4.2	<p><i>Ofrimi i trajnimeve për zhvillimin e kapaciteteve me zbatimin e legjislacionit të ri.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Janë ofruar shërbime/trajnime në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve me legjislacionin e ri për 35 nëpunës civilë në fushat e procedurave administrative, civile dhe harmonizimin e legjislacionit.</p>
4.4.3	<p><i>Kryerja e vlerësimit të kapaciteteve institucionale të MD-së në lidhje me harmonizimin e legjislacionit me <i>acquis</i> BE dhe hartimi i planit të zhvillimit të kapaciteteve.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Në procesin e harmonizimit të legjislacionit me <i>acquis</i> të BE-së, Drejtoria e Integritimit dhe Negociatave ka rol koordinues dhe mbështetës. Ministria e Drejtësisë e kryer dhe ka asistuar</p>

	<p>korrigjimin e harmonizimit dhe <i>acquis</i> BE-së dhe të gjithë burimeve njerezore të disponueshme në procesin e harmonizimit.</p>
4.4.4	<p><i>Trajnime të nëpunësve të Ministrisë së Drejtësisë në fushën e harmonizimit të legjislacionit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Pjesëmarrja e të gjithë stafit të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion në trajnimin “Hartimi Legjislativ” i organizuar nga ASPA për periudhën qershor – korrik. JUSTAL ka zhvilluar dhe organizuar 2 trajnime mbi përafrimin e legjislacionit të EU për stafin e DPKHL dhe 10 trajnime mbi teknikën legjislative për rreth 30 pjesëmarrës mesatarisht nga stafi i Ministrisë së Drejtësisë. Pjesëmarrja e të gjithë stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit dhe të drejtorive të tjera të MD, në trajnimin "Hartimi Legjislativ" organizuar nga ASPA për periudhën "Qershor - Korrik" (gjithesëj 17 punonjes).</p>
4.4.5	<p><i>Përgatitja e një plani/harte me piketat dhe objektivat për procesin e negociimit.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Draft Udhërrëfyese është hartuar nga Ministria e Drejtësisë nga analiza e një procesi dhe një procesi konsultimi për të gjithë rekomandimin e partnerëve të BE-së. Procesi është mbështetur nga një seri trajnimesh, takimesh dhe diskutimesh. Në muajin dhjetor 2023 u miratua Udhërrëfyese për Shtetin e së Drejtës, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 736 datë 13.12.2023 "Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës". Ministria e Drejtësisë përgjatë kësaj periudhe ka punuar ngushtësisht në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për të finalizuar hartimin e pozicionit negociues për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike. Pozicionet negociuese të finalizuar janë përcjellë pranë Ministrisë të Shtetit dhe Kryenegociator.</p>
4.4.6	<p><i>Zhvillimi i kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë për të menaxhuar fondet IPA III.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Ministria e Drejtësisë me asistencën e JUSTAL ka organizuar një workshop të mbajtur më 7 shkurt 2023 me temë: “Forcimi i bashkëpunimit të Ministrisë së Drejtësisë me institucionet e drejtësisë, përgjegjëse për raportimin dhe zbatimin e projekteve në fushën e drejtësisë”. Gjithashtu gjatë periudhës raportuese, nëpunësit e Drejtorisë së Projekteve kanë marrë pjesë në trajnimin me temë: “Financimet dhe Programet e Bashkimit Evropian” të organizuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë për vitin 2023 ka plotësuar strukturën e saj me dy emërimet të reja.</p>
4.4.7	<p><i>Zhvillimi i kapaciteteve të institucioneve të varësisë të Ministrisë së Drejtësisë (sistemi penitenciar, shërbimi i provës, ndihmë ligjore) për të menaxhuar fondet e IPA III.</i> (pz 2021-2025)</p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Ministria e Drejtësisë me asistencën e JUSTAL ka organizuar një workshop të mbajtur më 7 shkurt 2023 nga JUSTAL me temë: “Forcimi i bashkëpunimit të Ministrisë së Drejtësisë me institucionet e drejtësisë, përgjegjëse për raportimin dhe zbatimin e projekteve në fushën e drejtësisë”. Në këtë workshop morën pjesë dhe përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e</p>

	Përgjithshme e Shërbimit të Provës dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas. Për 6-mujorin e dytë të 2023 nuk janë raportuar aktivitete të reja.
4.4.8	<p><i>Përgatitja e kapaciteteve të institucioneve të pavarura të drejtësisë (KLGJ, KLP, ILD, PP, SHM) për të përgatitur dhe menaxhuar fondet IPA III. (pz 2021-2025)</i></p> <p><u>Institucioni raportues:</u> Ministria e Drejtësisë</p> <p><u>Informacion mbi zbatimin e masës:</u></p> <p>Workshop i mbajtur më 7 shkurt 2023 nga JUSTAL me temë: “Forcimi i bashkëpunimit të Ministrisë së Drejtësisë me institucionet e drejtësisë përgjegjëse për raportimin dhe zbatimin e projekteve në fushën e drejtësisë”. Në këtë workshop morën pjesë edhe përfaqësues nga institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë si: KLGJ, KLP, ILD, PP, SHM. Për 6-mujorin e dytë nuk janë raportuar aktivitete të reja.</p>

Një (1) tregues performance lidhet me OS 4.4:

➤ **Kohëzgjatja aktuale mesatare (ditë ose muaj) të procedurave kyçe të kooperimit ndërkombetar krahasuar me kohëzgjatjen e synuar**

Vlera e synuar për vitin 2023 për këtë tregues është 3-6 muaj dhe është raportuar se është arritur plotësisht, në përputhje me ligjin nr. 10193 datë 3.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale” i ndryshuar 97/21 datë 7.7.2021.

III. RISKU DHE HAPAT NË VIJIM

Pasqyrë e përgjithshme

Ky kapitull synon të japë një pasqyrë të risqeve të identifikuara bazuar në nivelin e zbatimit të masave të renditura në Planin e Veprimit dhe në nivelin e përmbushjes së treguesve të Pasaportës së Treguesve, sipas gjetjeve në Kapitullin II. Analiza e riskut është kryer nga institucionet përgjegjëse ose, në mungesë të kësaj, nga stafi i MD-së, bazuar në të dhënat e mbledhura.

Në analizën e mëposhtme, vlerësimi i riskut përfshin: analizën e riskut, nivelin e riskut, faktorët e riskut dhe hapat e mëtejshëm të mundshëm për të zbutur risqet, për të zbatuar me sukses masat dhe për të arritur treguesit e synuar. Risqet mund të lidhen me faktorë të tillë si kapaciteti institucional, mjedisi rregullator dhe partneriteti dhe angazhimi nga institucionet e tjera.

Risqet mund të lindin, për shembull, në rastet e vonesës së zbatimit, duke iu referuar afatit të zbatimit të parashikuar nga Plani i Veprimit. Disa nga masat e paraqitura në sfond të bardhë (të pazbatueshme) do të konsiderohen si masa me risk, konkretisht ato që nuk mund të zbatohen nga institucioni(et) përgjegjës(e), por nga institucione të tjera, të cilat deri më tani kanë mbetur joaktive. Kjo çështje mund të kapërcehet gjatë procesit të hartimit të SND-së së re, i cili sapo ka nisur. Risqet shfaqen edhe në disa raste të zbatimit të pjesshëm të masave ndaj kërkohet një vëmendje e veçantë për të siguruar një zbatim të suksesshëm brenda afateve të përcaktuara.

Vlerësimi i riskut

Risqet e identifikuara në raportin vjetor të monitorimit për vitin 2023 janë shqyrtuar me kujdes dhe disa prej tyre konsiderohen ende të pa tejkaluara. Ato janë përfshirë në tabelën e mëposhtme me shënimin e qartë se nga cila periudhë ekziston/jnë, risku/risqet.

OS 1.1 “Vazhdimi i zbatimit dhe finalizimi i procesit të vlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në mënyrë efektive dhe efikase sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe ligjit.”

Risku	Paraqitet me risk vijueshmëria e të njëjtave standarte të procesit të verifikimit kalimtar të subjekteve, nga ana e institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (KLGJ, KLP); Në këtë aspekt, me mbarimin e afatit kushtetues të institucioneve të vetting-ut, sigurimi i vazhdimësisë në sistem i burimeve njerëzore, të KPK dhe KPA, të specializuara në procesin e vetting-ut të magistratëve, evidentohet gjithashtu si një risk potencial;
Niveli i Riskut	I lartë
Analiza	Ndërmarrja nga ana e institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (KLGJ, KLP) e masave të cilat sigurojnë vijueshmërinë e standarteve të procesit të verifikimit kalimtar të subjekteve, edhe pas përfundimit të organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, mbetet një sfidë e cila duhet adresuar në të ardhmen.

	Zhvillimi i kapaciteteve të KLGJ dhe KLP, procedurat e emërimit, promovimit dhe transferimit të magistratëve duhet të kalojnë nëpërmjet sistemit të kontroleve të integritetit përpara hyrjes në karrierën e magistraturës si dhe gjatë karrierës, si dhe kontrollit të pasurisë. Për të ndihmuar këtë proces, do të ishte e rekomadueshme mbajtja në sistem e burimeve njerëzore, të KPK dhe KPA të specializuara në kontrollin e pasurisë dhe të figures i cili ka qene pjese e procesit te vetting-ut të magistratëve.
Faktori i riskut	Vazhdimësia e kapaciteteteve institucionale
Masat për zvogëlimin e riskut	Ndërmarrja nga ana e institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (KLGJ, KLP) si edhe institucione të tjera (p.sh ILDKPI) e masave me natyrë të ndryshme (propozime për ndryshime ligjore, plotesimi i vakancave të institucioneve me këto profile) për të garantuar mbajtjen në sistem të burimeve njerëzore, të KPK dhe KPA, të specializuara në kontrollin e pasurisë dhe integritetit.

OS 1.2 “Përditësimi dhe përmirësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi bazuar në gjetjet nga analiza dhe monitorimi i zbatimit të reformës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, legjislacionin e përditësuar për kompetencat, transparencën, efikasitetin, dhe koordinimin”

Risku	Ka ende akte nënligjore që duhet të miratohen nga KLGJ dhe KLP bazuar në kërkesat e Ligjit për Statusin dhe Ligjit të Qeverisjes. Bazuar në numrin e lartë të akteve nënligjore të miratuara në fund të vitit 2023, rreziku moderohet nga i lartë, në i ulët për KLP, si dhe mbetet i njëjtë nga periudha e mëparshme raportuese, për KLGJ.
Niveli i Riskut	I ulët
Analiza	Rregullorja e Brendshme e KLGJ nuk është miratuar, ende. KLP ka pasur progres në miratimin e akteve nënligjore, por ka ende boshllëk nënligjor. Miratimi i këtyre akteve është bërë në një kohë të shkurtër, gjë që mund të ndikojë në cilësinë e akteve të draftuara.
Faktori i riskut	Kapacitetet institucionale
Masat për zvogëlimin e riskut	Kërkohet një planifikim më i mirë i procesit të draftimit dhe miratimit të akteve, në mënyrë që ky proces të marrë kohën e nevojshme dhe të mundësojë miratimin e akteve nënligjore me cilësi dhe në kohën e duhur. Cilësia e akteve nënligjore, e të gjitha organeve të drejtësisë, përfshirë këtu edhe gjykatat dhe institucionet e varësisë, mbetet një sfida e së ardhmës e cila ndikon drejtpërdrejt në mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë dhe është një parakusht për funksionimin me efikasitet të këtyre institucioneve.

O.S 2.4 “Përmirësimi i sistemit gjyqsor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqsor, duke përfshirë GJL-në dhe sigurimi i ofrimit të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme për qytetarët”

<p>Risku</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Tendence në rritje e kohës së nevojshme për administrimin e çështjeve, në Gjykatën e Lartë dhe në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, e cila sinjalizon një risk të lartë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të prapambetura. • Paraqitet me risk, gjithashtu, sigurimi i infrastrukturës në zbatim të hartës së re gjyqësore.
<p>Niveli i Riskut</p>	<p>I lartë</p>
<p>Analiza</p>	<p>Zgjidhja e çështjeve të prapambetura mbetet ende shqetësim. Referuar treguesit për zgjidhjen e çështjeve të prapambetura për Gjykatën e Lartë, konstatohet se, lidhur me administrimin e çështjeve civile dhe administrative ka një tendencë në rritje të kohës së nevojshme për administrimin e çështjeve. Treguesit e kohëzgjatjes mesatare të çështjeve në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, tregojnë gjithashtu, se ekziston ende rrezik për zgjidhjen e çështjeve të prapambetura. Këta tregues bëjnë të nevojshëm vijimin e masave për reduktimin e backlog-ut.</p> <p>Gjithashtu, si pasojë e implementimit të hartës së re gjyqësore, me ngritjen e 13 gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit të juridiksionit të përgjithshëm ka probleme me sigurimin e infrastrukturës, ka probleme me miratimin e shesheve të ndërtimit nga ana e bashkive për godinat e reja të gjykatave. Mungesa e një studimi të mirëfilltë fizibiliteti mbetet një shqetësim potencial në sigurimin e infrastrukturës ndërtimore</p>
<p>Faktori i riskut</p>	<p>Vakancat e krijuara nga procesi i vetting-ut, harta e re gjyqësore dhe krijimi i një Gjykate Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm</p>
<p>Masat për zvogëlimin e riskut</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i një strategjie të mirëfilltë dhe një plan veprimi me masa konkrete për reduktimin e backlog-ut; • Plotësimi i vakancave të magistratëve në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë të juridiksionit të përgjithshëm; • Kryerja e një studimi të mirëfilltë fizibiliteti për sigurimin e infrastrukturës ndërtimore për gjykatat.

O.S 3.1 “Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë përditësuar duke synuar një qasje të integruar të institucioneve të drejtësisë dhe një qasje restauruese të drejtësisë, ndërtuar mbi parandalimin, risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin duke zëvendësuar qasjen ndëshkuese ekzistuese”

Risku	Procesi i hartimit të Kodit të ri Penal që ka nisur në vitin 2020 ende nuk është finalizuar. Kjo masë u konsiderua me rrezikshmëri të lartë bazuar në Raportin Vjetor të monitorimit të vitit 2022. Gjatë vitit 2023 u zhvilluan disa aktivitete midis Grupit të Punës dhe partnerëve ndërkombëtarë që ulën ndjeshëm rrezikun. Sidoqoftë, referuar edhe treguesit për numrin e akteve të përafruara me <i>acquis</i> , i cili raportohet se nuk ka asnjë akt, për periudhën raportuese, realizimi i këtij objektivi mbetet ende në zonën e rrezikut.
Niveli i Riskut	I lartë
Analiza	Është duke funksionuar Grupi i Punës për hartimin e Kodit të ri Penal, i krijuar nga MD. Drafti i pjesës së përgjithshme të Kodit Penal u hartua dhe u shpërnda për komente. Me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë u identifikua Acquis përkatëse. Është në proces përpunimi i pjesës së posaçme të Kodit Penal.
Faktori i riskut	Kompleksiteti i lëndës kërkon përfshirjen e ekspertëve me përvojën dhe njohuritë e duhura për të mundësuar një analizë të besueshme të faktorëve kriminal dhe kriminalitetit në Shqipëri si dhe për të reflektuar përfundimet në kodin e ri.
Masat për zvogëlimin e riskut	<input type="checkbox"/> Kryerja e një analize mbi statusin e perafrimit në fusha të ndryshme, e shoqëruar me një plan veprimi konkret mbi transpozimin në legjislacionin shqiptar të akquis të BE-se. <input type="checkbox"/> Koordinimi i të gjithë palëve të interesuara në këtë proces

O.S 3.2 “Një sistem prokurorie efikas dhe proaktiv që funksionon sipas standardeve evropiane me qëllim hetimin dhe ndjekja efikase të korrupsionit dhe e krimin të organizuar”

Risku	<ul style="list-style-type: none"> • Plotësimi i vacancave në prokuroritë e rretheve, si pasojë e procesit të vetting-ut; • Plotësimi i vakancave në pozicionet e oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të administratës, të Byrosë Kombëtare të Hetimit; • Infrastruktura dhe dixhitalizimi i zyrave të prokurorive
Niveli i Riskut	I mesëm
Analiza	<p>Numri i prokurorëve pranë Prokurorive të Rretheve është ulur për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, që ende po vazhdon. Kështu, numri i çështjeve të pazgjidhura në prokurori është më i madh se sa mund të trajtojnë prokurorët në detyrë.</p> <p>Në BKH ka ende vende vakante në pozicionet e oficerëve të policisë gjyqësore dhe është e nevojshme plotësimi me burime njerëzore.</p>

	<p>Numri i çështjeve të prapambetura/backlog në prokurori vazhdon të mbetet problem dhe duhet të vijojnë të zbatohen masa për reduktimin e çështjeve të prapambetura.</p> <p>Dixhitalizimi i sistemit të prokurorisë po ecën me hapa shumë të ngadaltë, gjë që ndikon në procesin e hedhjes së të dhënave dhe vlerësimin e prokurorëve.</p>
Faktori i riskut	<ul style="list-style-type: none"> • Procesi i <i>vetting-ut</i> dhe zbatimi i hartës së re gjyqësore. • Burimet infrastrukturore dhe financiare.
Masat për zvogëlimin e riskut	<ul style="list-style-type: none"> • Bazuar në Hartën e Gjyqësore Prokuria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme ndërmarrin masa organizative për të përmirësuar performanën e zyrave të reja të prokurorive, duke garantuar (i) ndarjen rastësore të çështjeve; dhe (ii) plotësimin e vacancave të stafit administrative (paketë masash në nivel administrativ dhe menaxherial) • BKH garanton plotësimin e vende vakante në pozicionet e oficerëve të policisë gjyqësore si dhe burime njerëzore të mjaftueshme

O.S 3.5 “Zhvillimi i sistemit penitenciar bazuar në standartet evropiane, që siguron respekt të plotë për burimet njerëzore dhe përdor plane zhvillimi individualë”

Risku	Evidentohet një shkallë e lartë e mbipopullimit të burgjeve
Niveli i Riskut	I lartë
Analiza	Referuar treguesit të performancës për objektivin 3.5 “raporti i personave me numrin e shtretërve, si masë e mbipopullimit të burgjeve”, vlera e synuar për vitin 2023 është 82 %, e cila kërkon që 18% e shtretërve të jenë të lirë. Raportohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve se ky raport për vitin 2023 është 102.6 %.
Faktori i riskut	Politika penale
Masat për zvogëlimin e riskut	<input type="checkbox"/> Zbatimi i Master Planit të Burgjeve; <input type="checkbox"/> Ndërmarrja e masave në lidhje me politikën penale.

O.S 4.1 “Zhvillimi i plotë i sistemit të integruar të drejtësisë elektronike (e-drejtësia) me identifikues të unifikuar, i sistemeve të menaxhimit të çështjeve të përditësuara, regjistrimit elektronik të bazuar në internet për të treja fushat (penale, administrative, civile) dhe lidhjeve me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare”

Risku	Sistemi i integruar elektronik i drejtësisë nuk është krijuar ende. Ky rrezik është identifikuar edhe në Raportin Vjetor të Monitorimit për vitin 2022. Në periudhën raportuese ka disa zhvillime sa i takon
--------------	--

	miratimit të Udhëzuesit për Sistemin e Ri të Integruar të Cështjeve nga ana e KLGJ, si dhe zhvillimit të Udhërrëfyesit ndërinstitucional për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë, por këto hapa janë ende larg vënies në funksion të Sistemit të Integruar të Cështjeve në të gjithë sistemin e drejtësisë.
Niveli i Riskut	I lartë
Analiza	Stafi i Qendrës së IT-së ende nuk është plotësuar. Nevojitet përgatitje e nevojshme për ndërhyrjet e nevojshme në lidhje me përmirësimet infrastrukturore dhe logjistike. Udhërrëfyesi për sistemin e integruar të menaxhimit të rasteve nuk është miratuar gjatë periudhës raportuese.
Faktori i riskut	Burimet njerëzore, burimet financiare, mbështetja ndërkombëtare.
Masat për zvogëlimin e riskut	<input type="checkbox"/> Sigurimi i burimeve të nevojshme dhe mbështetjes së donatarovë; <input type="checkbox"/> Organizimi i procesit në mënyrë transparente; <input type="checkbox"/> Koordinimi e të gjitha grupet e interesit.

Hapat vijues

Hapat e mëtejshëm pas analizës së mësipërme ndahen në dy grupe:

- Hapat e mëtejshëm në lidhje me përditësimin e Objektivave Strategjike he hartimin e një SND të re 2024-2030 me Planin e Veprimit dhe Pasaportën përkatëse të treguesve ku do të hartohen disa masa dhe tregues të rinj në përputhje me raportin e shqyrtimit të BE-se (Screening Report).
- Rishikimi i masave dhe treguesve ekzistues do të bëhet nga MD dhe institucionet përgjegjëse në mënyrë që të formulohen në mënyrë të duhur përmbajtjet, afatet, nën-aktivitetet aty ku nevojitet dhe institucionet përgjegjëse.
- Hapat e ardhshëm në lidhje me zbatimin e të gjitha masave dhe treguesve të SND-së së re, me qëllim shmangien e risqeve të reja.